

INTERVISTA/ TË PATHËNAT E NJË SHKARKIMI

ELIZABETA, PROKURORJA 'MALOKE' QË U MUND NGA THASHETHEMI



NEWS BOMB.al

TË GJITHË DUAN BILETA

Armand Duka në një rrëfim ndryshe për finalen e "Conference League" në Tiranë, nga aplikimi disa vite më parë e deri më sot. Ndeshja e parë dhe e fundit e përmasave të tilla në Shqipëri

Si nisi konflikti me kryebashkiakun që e ka marrë Biletën e tij për ndeshjen, sikurse edhe Kryeministri. Rruga e gjatë për mandatin e 6-të. Nga fillesat e egra të biznesit, tek ulja në tryezën e të mëdhenjve të futbollit

AFRIM PEPOSHI

Në
brendës



TURIZMI

SI NISI NË 1900-ën
ME AVULLORE, SI BITISI
ME FSHATRA E VILA

PRESIDENTI I 7-të

PESË KRITERET PËR KREUN E
SHTETIT, HISTORIA 30-VJEÇARE

| Nga AFRIM KRASNIQI

DEAN ÇELAJ

NJË "GOLDEN-BOY" NGA
VLORA QË VLERËSOHET
NGA REVISTA "FORBES"

LUFTAR PAJA

10 MIJË HAPAT
E AKTORIT 81-VJEÇAR
QË FRYMËZON PA NDALUR



Redefine
Living.

**HAPËSIRA
MULTIFUNKSIONALE
MË E RE NË TIRANË,
QË T'I OFRON TË GJITHA!**



**CEL
CEL
EMAIL
EMAIL
WEB**



+ 355 69 20 73 531
+355 69 20 73 530
info@aksestirana.com
shitjet@matrixkonstruksion.com
www.aksestirana.com

STRES DHE FESTË, TË GJITHË DUHET T'IA DALIM!

Kemi hyrë në majin e aktivitetit më të madh sportiv që do të zhvillohet në Shqipëri. 'Conference League', një finale për kornizë që do të sjellë në Tiranë e në shkallët e stadiumit Air Albania me mijëra tifozë të huaj, të dy finalistëve, Romës dhe Fejnordit hollandez. Veç tyre, emra të njohur të futbollit botëror do të jenë në tribunë duke shijuar spektaklin. Në fushë, yjet e futbollit ndërkombëtar do të përballen në një ndeshje plot emocione.

Aty jemi edhe ne. Në sfidë me kohën për të sjellë një finale model. FSHF-ja gëlon përditë nga vullnetarët, ekspertët e policisë, të zjarrefikësive, mjekëve, pastrimit, e deri tek shkresat poshtë e lartë me institucionet e shtetit.

Në kongresin e 46-të të UEFA që u mbajt në Vjenë në fillim të këtij muaji, të gjithë kthenin sytë nga tavolina shqiptare: A do kemi bileta? Kërkesa kalonte diku me humor e diku me batuta, ndërsa presidenti i FSHF-së, Armand Duka, takohej me të gjithë dhe garantote se gjithçka do të shkonte mirë. Më shumë sesa çështje biletash, të gjithë kishin merakun e atyre mijëra tifozëve, (dhe jo vetëm) që do të vijnë në Tiranë duke filluar nga 20 maji, a ndoshta kanë ardhur dhe më herët.

Shqetësim mbetet aeroporti. Me dhjetëra çartera do të vijnë në Rinas këtyre ditëve dhe ky fluks do ti shtohet fluturimeve normale: Si do të vendosen e ku do të parkohen këta avionë? A ka kapacitet aeroporti i Rinasit? Si do të përpunohen gjithë ky fluks njerëzish, pasaportat, bagazhet? Si do të lëvizin këta mijëra njerëz nga Rinasi deri në Tiranë? A do të ketë bllokime rrugësh? A janë vendosur autobuzët e dedikuar për tifozët?

Të gjitha këto ishin pyetje që endeshin në kokat e zyrtarëve të UEFA me autorite-

tet shqiptare gjatë punimeve të kongresit, në mbledhje të gjata jashtë radhës gjatë qëndrimit në Vjenë.

Për Shqipërinë, është aktiviteti i parë, i përmasave të atilla. Presidenti i FSHF-së tregon në një rrëfim të gjatë se "do t'ia dalim". Në çdo moment është në komunikim të vazhdueshëm me kryeministrin dhe gjithë administratën shtetërore. Në fund të fundit, tani që finalja afrohet, të gjithë e kuptojnë sesa e rëndësishme është kjo ngjarje për imazhin e vendit.

Në fushën e futbollit do të jetë festë, por për të gjithë të tjerët jashtë saj, është stres. Deri kur avioni i fundit të lërë pistën e Rinasit. Shqipëria do të tregojë se di të përballojë aktivitete të tilla, anipse UEFA ka vendosur që pas finales së vendosur në Pragë të Çekisë "Eden Arena" në 2023 (20.800 vende), nuk do të pranohet të luhet asnjë finale tjetër në stadione me kapacitet më të vogël se 50 mijë vende. Kjo do të thotë, se Shqipërisë zor se

mund t'i vijë prapë në derë një finale si kjo. Parashikohen 130-150 milionë euro të vijnë në vend këtyre ditëve. Tifozët e Romës apo Fejnordit dhe shumë të tjerë veç tyre kanë kohë që kanë prenotuar hotelet apo shtëpitë për ditët e qëndrimit në vend.

Restorantet, klubet, dyqanet me shitje artizanale vendase, por edhe sektorë të tjerë të ekomisë gjatë këtyre ditëve, duhet të jenë në gadishmëri të plotë, të gatshëm për të përballuar fluksin dhe konsumin e madh.

Përveç mundësive të mira ekonomike, ndeshja e Conference League do të jetë kartolina më e bukur e këtij viti për vendin tonë, për imazhin, mikpritjen, miqësinë. Të gjithë bashkë do t'ia dalim.

**Gazetare, anëtare e KE të FSHF-së*



Nga ANILA BASHA*



TË GJITHË DUAN BILETA

ARMAND DUKA NË NJË RRËFIM NDRYSHË PËR FINALEN E CONFERENCE LEAGUE NË TIRANË, NGA APLIKIMI 4 VITE MË PARË E DERI MË SOT

Nga ANTA MUÇAKU


56

16 BERISHA, A MUND TË NGRIHET SËRISH SFINKSI

22 PRESIDENTI I RI, HISTORIA DHE SKENARËT

Nga AFRIM KRASNIQI


28 4 KRYEMINISTRA SHQIPTARË NË BALLKAN RASTËSI, APO SKENAR?




44

**SHQIPËRIA PA
ASNJË GRAM AR**
KUSH E GRABITI FLORIRIN?!

Nga ERALD KAPRI





ELIZABETA
PROKURORIA

Nga NIKOLETA KOVAÇI

08



66

LUFTAR PAJA

10 MIJË HAPAT E AKTORIT 81-VJEÇAR
QË FRYMËZON PA NDALUR

Nga SUADA DACI

30

DEAN ÇELAJ, NJË "GOLDEN-BOY"
NGA VLORA QË VLERËSOHET
NGA REVISTA "FORBES"

32

SHKËLQIMI DHE RËNIA
E FSHATRAVE TURISTIKE

Nga FATOS ÇOÇOLI

36

TURIZMI, TË HUAJT: NATYRË E
MREKULLUESHME, NJERËZ TË
KËQINJ E PËR TË TË RRJEPUR!

Nga ERGYS ALUSHI /VLORË

48

KLERIKË SI AGJENTË
E TË SPIUNUAR

Nga LUELA MYFTARI

76

FORMULA E MAJIT... NGJYRA

Nga SUADA DACI

80

QUIZ BOMB

Nga KADRI VOKOPOLA



TIRONA KAMPIONE

FESTA E MADHË E FAMILJES
BARDHEBLU NË 26 MAJ

Nga RETIN TOKA

72

NEWS BOMB.al

MAJ
2022



ABONOHU!

POSTA SHQIPTARE:

+355 68 50 80 753

Redaksia Newsbombal:

+355 69 67 32 020

abonime@newsbomb.al

ADRESA:

Rruga: "Emin Duraku",
Hyrja 1, Apartamenti 14, Tiranë

Mobile: +355 69 922 2201 | +355 69 922 2202

E-mail: info@newsbomb.al

Newsbomb SHPK
NIPT: L42417011Q



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ANILA BASHA

BASHKËPUNUAN

AFRIM KRASNIQI

FATOS ÇOÇOLI

ANTA MUÇAKU

LUELA MYFTARI

NIKOLETA KOVAÇI

ERGYS ALUSHI

RETIN TOKA

SUADA DACI

KADRI VOKOPOLA

GRAPHIC DESIGN

ALTIN ALIAJ



UNIVERS CITY

**KOMPLEKSI MË I MADH
REZIDENCIAL NË TIRANË**

sales@balfinrealestate.al | +355 69 80 14 999 | www.universcity.al



**TË PATHËNAT
E NJË SHKARKIMI**

Prej dekadash u njohëm me modelin Falkone, rrojtën me të dhe e qamë jo pak herë pamundësinë me e pas mes nesh, në një godinë hetimi, ku një ditë të dridhet para tij shteti dhe mafia, shteti mafie dhe mafia shtet! Që vrasësi të mos ndjehej i pakapshëm, hajduti i paidentifikueshëm, i korruptuari i qetë, gjithnjë na duhej një prokuror, mbase edhe për ta besuar se ai është dhe do të hetojë, do të shpëtojë një të pafajshëm dhe do të dënojë 10 të fajshëm... Në fakt rrallë na ndodhi që ta besonim se edhe ne mund ta kemi një prokuror. Edhe kur ishim të paditur, edhe kur nisëm të mësojmë, edhe kur erdhën të huajt, edhe kur erdhi reforma në drejtësi, shpresa e madhe se më në fund edhe ne do të bëhemi me institucione që nuk

lëkunden nga krimi dhe pushteti, ne sërish ishim të pabindur se në vendin tonë të mund të kishte një prokuror!

Por Elizabetha Imeraj qe një prokurore! Ajo u duk, u përball dhe pse jo edhe nuk u smbraps nga terrorizmi, krimi i organizuar, tenderat

milionësh, trafikantët e drogës, përfituesit e tërmetit që na mbolli vdekje. Po, ajo thirri në godinën e saj edhe Sali Berishën, Ilir Metën, Lulzim Bashën, hetoi rrugë e pazare në kurriz të shqiptarëve dhe të vendit. Ne e pamë sepse pamë të shkonin pas hekurave njerëz që rrëmbenin njerëz, kërcënonin biznesmenë e akademikë, vinin gjoba miliona euroshe dhe shpesh të krijonin idenë se ata ishin ligji, se në fakt për shumë kënd ata bënë ligjin! Elizabetha i mundi disa prej tyre, por 'humbi' në përballjen e krenarisë së saj profesionale. Ajo do na e tregojë vetë se çfarë vërtet ndodhi me shkarkimin e saj të bujshëm; paragjykimet, rrëngun, manipulimet, shpifjet dhe mbi të gjitha vënien përballë akuzave të paqenë sipas saj. Për NEWSBOMB.al ajo flet pa peta, pa drojë, me fakte dhe emra. Jep përgjigje thujtase për gjithçka, shpjegon me detaje atë që shumëkujt do t'i duket e pabesueshme se mund t'i ndodhi një prokurori që ligjin e ka arsye dhe bindje, motiv, forcë dhe besim se edhe Shqipëria e meriton një sistem drejtësie të drejtë dhe të patëmetë!

ELIZABETA

PROKURORJA 'MALOKE' që u mund nga THASHETHEMI

| Nga **NIKOLETA KOVAÇI**

Prej vitesh e kemi kërkuar një prokuror, një të vërtet, nga ata që nuk bëjnë kompromis, nga ata që s'i tremb fuqia e atij që vjedh, dhunon, abuzon e vret. Një prokuror që mos të ketë frikë nga të gjithë pushtetshmit e vendit, nga ata që s'kanë shkelur as për qejf në një godinë prokurorie, jo më të pyeten, të japin shpjegime dhe llogari.

Në 27 prill të këtij viti, pas një seriali të gjatë me shumë “ankth”, “pikëpyetje”, “intriga”, “anonime”, “përgjime”, personazhi kryesor humbet. Jemi mësuar të shohim filma, ku heronjtë fitojnë gjithmonë. Po këtë radhë, nuk bëhej fjalë për një film, por për një të vërtetë. Kryeprokurorja e Tiranës, Elisabeta Imeraj u vu nën shënjestrën e të gjithëve, ambasadorëve, anëtarëve të Vettingut, gazetarëve e analistëve. Herë e shanin politikanët në daljet publike, herë e lëvdonin. Tropojania ecte krenare sallave të vettingut ku me letra anonime dhe akuza përgjimesh “i bënë gropën”... profesionale. Në një intervistë të gjatë për revistën NEWSBOMB.AL ajo flet për procesin e montuar, që nga anëtarja me konflikt interesi dhe deri tek përfaqësuesi i ONM-së që 7 muaj pas largimit nga Shqipëria i dërgoi një email...E pas kësaj, filloi një betejë që u mbyll në fund të prillit. Tani, po përgatitet e po mbledh forcat për të vazhduar më tej...



Zonja Imeraj, çfarë ndodhi me ju gjatë procesit të Vetting-ut...?

Reforma në drejtësi, e miratuar në vitin 2017 u prit dhe u mirëprit nga shqiptarët në përgjithësi dhe nga ne, pjesa e thjeshtë e sistemit të drejtësisë në veçanti, si një shpresë. U prit si një e ardhme e cila po vinte natyrshëm. E them këtë, pasi është e rëndësishme, të sqarojmë çfarë është reforma në vetvete, dhe si po zbatohet ajo.

E kam filluar karrierën në sistemin e prokurorisë në vitin 2004 me mbarimin e shkollës së Magjistraturës. Më ka rastisur të provoj institucionin si prokurore e thjeshtë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër fillimisht e më pas si prokurore në Prokurorinë për Krime të Rënda, Tiranë. Vetëm pas ndryshimeve të mëdha dhe thelbësore që ndodhen në mënyrën e organizimit të prokurorisë, në vitin 2017, ku prokuroria kaloi nga një organ i centralizuar në një organ të decentralizuar m'u dha rasti dhe mundësia të provoj në rangun e karrierës profesionale, të qënurit drejtuese prokurorie, dhe pikërisht të prokurorisë më të madhe në vend, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. E pikërisht në këtë kohë, më rastisi të filloj procesin e rivlerësimit si Drejtuese e Prokurorisë dhe jo si një prokurore e thjeshtë.

Që të dimë së çfarë ndodhi me procesin e vettingut për Elizabeta Imeraj, duhet ta nisim nga kjo pjesë. E kam filluar procesin e rivlerësimit në vitin 2018, në tetor dhe është përmbyllur ky proces me datë 27 prill të vitit 2022, me shkarkimin tim nga detyra. Gjatë kësaj kohe më është bërë një proces vlerësimi nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për shkak të aplikimit për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në prezencë të partnerëve ndërkombëtarë, më ka renditur si të tretën fituese në listën prej 15 anëtarësh që do ishin pjesë e kësaj prokurorie. Pra puna ime në vite është vlerësuar pozitivisht nga 11 anëtarë të KLP-së. Por, përsëri më është

bërë procesi i vlerësimit pozitiv, nga KLP në mars të vitit 2021, me konkurimin dhe fitimin si Drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Jam vlerësuar pozitivisht nga të gjitha institucionet për të trija kriteret e rivlerësimit për 17 vite me radhë. Ndaç dhe në procesin e vettingut, me të njëjtat dokumente, nuk e prisja as gjithë këtë ngarkesë gjatë procesit, as shkarkimin nga detyra, as në rang të akteve që ka dosja, as në rang të punës që kam bërë në vite dhe as në rang të asaj çfarë Elizabeta Imeraj ka përfaqësuar si prokurore e Republikës së Shqipërisë përgjatë 17 viteve karrierë. Normalisht, nuk është momenti të tregohemi emocionalisht të dobët, dhe të merremi me këtë pjesë, por për hir të shpresës së shqiptarëve, shpresës së fëmijëve tanë dhe për të qenë të informuar duhet të analizojmë.

Çfarë konkretisht...?

Ka shumë njerëz të interesuar të dinë çfarë ndodhi, njerëz që nuk më njohin, që i takoj çdo ditë goftë edhe rastësisht. Por edhe ata që më njohin dhe pikërisht për hir të këtyre analizave dhe mbi të gjitha për hir të analizimit të situatave, duhet të dinë çfarë ndodhi.

Elizabeta Imeraj, u përball gjatë procesit të rivlerësimit me sulme, akuza, kërcënime, skema të sajara dhe rezultati është i qartë; e gjithë kjo u përkthye në shkarkim.

Nuk mundem të mos e theksoj, jo për të bërë rolin e viktimës, as për të thënë që është një fatkeqësi e madhe largimi im nga detyra e prokurores, as për ndonjë arsye tjetër, por në thelb është një përpjekje për të treguar se skemat, sajatat dhe goditja e njerëzve pa mbështetje nuk mundet të jenë, as formati i drejtësisë së re dhe as huazimi i këtij formati nga drejtësia e vjetër. Nuk mundem të barazoj gjithë procesin tim të vettingut me reformën në tërësi, por dhe do ishte e padrejtë, e pse jo dhe shumë e pamundur nga ana ime, të mos

evidentoj çfarë ka ndodhur në procesin tim. Ish-relatorja që mori në shqyrtim çështjen time e mbajti atë për një vit me radhë, në kushtet e konfliktit të interesit, e më pas u përjashtua për konflikt interesi.

Kjo është arsyeja që zanafilla e mbrapshtë e procesit tim të rivlerësimit të ndikonte në një rezultat si shkarkimi. Më pas, rrugës, u bashkuan disa gjëra; njerëz me pushtet dhe që kishin mundësi ndikimi dhe imponimi arritën të shfrytëzojnë këtë situatë duke përcjellë negativitet, ngarkesë dhe padrejtësi.

Si ndodhi kjo? Kush ishin këta njerëz?

U sajuan letra anonime, duke paraqitur një sërë pretendimesh të cilat, mbi të gjitha, realizuan goditjen e figurës sime si prokuror e Republikës së Shqipërisë. Në asnjë moment procesi im i vetingut nuk hyri në një rrjedhë normale. Siç e thashë, filloi në kushtet e një konflikti të rëndomtë interesi dhe vijoi me sulme në një intensitet të shtuar me dokumente të falsifikuara dhe denoncime anonime. U synua linçimi publik, nga një prokuror që hetonte me guxim, në një prokuror që merrej me përgjime dhe shantazhe. Kjo është e turpshme dhe unë s'mund të pajtohem kurrsesi. Në aktet e dosjes është një dokument pronësie, në emrin tim, i cili nuk është real, pra është i falsifikuar. Në aktet e dosjes janë 3 denoncime anonime, në aktet e dosjes ka episode të ndryshme që çënojnë procesin normal dhe të rregullt sipas ligjit.

Kam bërë kallzim penal për çdo denoncim anonim, kam kërkuar ndjekje penale për çdo portal që ka shpifur mbi organet e vetingut, kam marrë çdo informacion të nevojshëm nga çdo institucion, dhe gjithçka ka rënë në vesh të shurdhër.

Kjo është ajo që ka ndodhur në linja të përgjithshme në procesin tim të rivlerësimit. Grupe të caktuara interesi, kriminale, politike dhe ekonomike, shfrytëzuan interesat e vogla personale të njerëzve që duhet të zbatonin ligjin dhe ngritën tymnajën e përgjimeve, shantazheve apo gënjeshtreve duke përdorur denoncimet anonime. E besoni që kanë arritur deri në përndjekje me sajatat e tyre, duke bërë lidhje të paqena, duke adresuar shqetësime që s'kanë asnjë lidhje me mua. Pra, dhe në këtë rast, u gjet mënyra e depërtimit nga grupe interesi, kriminale, politike dhe ekonomike për të goditur një prokurorë që ka kryer detyrën e saj si e tillë, gjatë gjithë jetës. Me pak fjalë, procesi i vetingut kundrejt meje, nuk ishte si çdo proces tjetër, për këto arsye, nuk ishte i njëjtë si çdo proces i çdo magjistrati.

Cilat qenë pengesat që nuk u mbrojtët dot...?

Kur flasim për pengesa, duhet të analizojmë me detaje; çfarë domethënë, se publikut nuk i interesojnë teknicitetet, për të mos u bërë të lodhshëm, por në rangun ligjor do të nënvizojë disa detaje që lidhen ngushtësisht me pengesat. Procesi i rivlerësimit në përgjithësi filloi me një



Kam bërë kallzim penal për çdo denoncim anonim, kam kërkuar ndjekje penale për çdo portal që ka shpifur mbi organet e vetingut, kam marrë çdo informacion të nevojshëm nga çdo institucion, dhe gjithçka ka rënë në vesh të shurdhër

EJA EJA
NË PLAZH
ME PEJA

BIRRA
PEJA



BIRRA
PEJA

negativitet, për shkak konflikti interesi, dhe më pas kjo situatë e krijuar, u shfrytëzua nga grupe të caktuara për të ngritur një klimë negative kundër meje. Me denoncimin anonim të një qytetari që i vunë emrin Rrahim Shehu, ngritën një pretendim të paqenë, të pabazuar dhe absurd, pretendimin që një vëzhgues ndërkombëtar është përgjuar nga ana ime. Kaq mjaftoi dhe më vuri përballë përceptimit të gabuar të krijuar nga të huajt që ka diçka që nuk shkon, e më pas çdo pretendim, çdo fakt, çdo provë, çdo rrethanë e paraqitur prej meje të interpretohej negativisht. Ne juristët interpretojmë, madje dhe përdoret shpesh shprehja: Dy juristë kanë dhe tri mendje... Në këtë këndvështrim dora armiqësore arriti të hedhë karremin dhe alarmin se është përgjuar një ndërkombëtar dhe pas kësaj, asnjë lloj situatë tjetër nuk më dha mua mundësinë të mbrohem. Pas kësaj situatë, s'kishte më standart në trajtim të barabartë për mua dhe s'kishte më prova dhe fakte që duheshin marrë në konsideratë.

Kjo ishte dhe është pengesa madhore.

U mundova, për vite me radhë, të kolonizoj procesin me kërkesa, ankesa, paraqitje pretendimesh, pasqyrim provash dhe faktesh, në një proces normal dhe ligjor, por ishte e pamundur. Procesi tashmë ishte shëndërruar në një betejë të kotë, ku këmbëngulja ime për t'u dëgjuar, për të parashtruar dhe për të mbrojtur veten u interpretua si sjellje që nuk duhet bërë. Distancohem nga çdo lloj sulmi, dhunë verbale ose jo, fyerje, sharje, dhe çdo gjë tjetër të bërë nga kushdo, si dhe nga çdo lloj reagimi i organizuar ose jo, për detaje që lidhen me procesin tim të rivlersimit.

Kur thua fyerje, sharje... çfarë kini parasysh?

Pavarësisht se të të thërrasin Maloke në vitin 2022, nuk tingëllon mirë dhe të vendos në paragjykim, por ka organe ku unë kam shprehur pretendimet e mia për këtë situatë.

Sidoqoftë si qytetare, duke marrë sot për bazë dhe në rang statistikor, vihet re një shkarkim masiv i prokurorëve dhe gjyqtarëve me origjinë nga Tropoja. Ndaj pengesa kryesore e mosrealizmit të mbrojtjes, lidhet me një fakt; procesi nuk u zhvillua asnjëherë normalisht, në kushtet e një procesi të rregullt ligjor, bazuar në fakte dhe në prova. Po i rikthehem përsëri situatës së mësipërme; përgjimit të pretenduar të një vëzhguesi ndërkombëtar dhe po ju rendis pretendimin e paraqitur dhe mbrojtjen time, duke ju lënë juve dhe publikun të gjykojë.

Në letrën anonime të nënshkruar nga një person me emrin Rrahim Shehu, paraqitet si situatë se Elizabeta Imeraj ka përgjuar dhe vëzhguar vëzhguesit ndërkombëtar dhe anëtarë të KPK-së etj. Kjo letër anonime është administruar në organet e vetëgjitur më 24 gusht të vitit 2020, si dhe me datë 31 gusht të vitit 2020.

Dy juristë kanë dhe tri mendje... Në këtë këndvështrim dora armiqësore arriti të hedhë karremin dhe alarmin se është përgjuar një ndërkombëtar dhe pas kësaj, asnjë lloj situatë tjetër nuk më dha mua mundësinë të mbrohem. Pas kësaj situatë, s'kishte më standart në trajtim të barabartë për mua dhe s'kishte më prova dhe fakte që duheshin marrë në konsideratë

Në shtator të vitit 2020, 7 muaj pasi ishte larguar nga Shqipëria, ish-vëzhguesi ndërkombëtar Z. K. ka paraqitur një e-mail duke thenë: "Dy burime, që s'u them dot se kush janë më kanë referuar se subjekti, pra unë, e kisha përgjuar dhe vëzhguar..." Kaq ka mjaftuar dhe kolegu i tij ka paraqitur një gjetje, duke argumentuar se fjalët e Z. K, si dhe fjalët e qytetarit Rrahim Shehu bëjnë të besueshme që subjekti, pra unë, kam përgjuar dhe vëzhguesit. E ndodhur përballë kësaj situatë të çuditshme jam munduar të jem profesionale dhe të mbledh çdo lloj të dhënë nga ku bazohet kjo lloj historie. Në këto kushte kam paraqitur para organeve të vetëgjitur pretendimet e mia, duke arsyetuar deri dhe faktin se shqiptarët janë një popull shumë mikpritës dhe është e papranueshme as të përdoren pretendime të tilla. Nga çdo përgjigje e marrë nga policia, agjensitë e tjera ligjzbatuese, prokuroritë, rezultojnë se s'ka asnjë informacion apo indicie e lëre më provë të mirëfilltë që të mbështesë një pretendim të tillë. Sidoqoftë nuk kam ndaluar me kaq, pasi unë vetë personalisht iu kam kërkuar organeve të hetimit të hetojnë nëse: Ka një përgjim dhe nëse po, kush është autori?

Në këto kushte, kur s'ka asnjë fakt, apo rrethanë që më lidh me këtë ngjarje, besova e bindur që s'ka gjykatë në botë dhe as konsum në bisedë tavolinash që mundet të ngrejë pretendime të tilla. Në këtë aspekt, po bëj balancën e provave: nga njëra anë një pretendim mbi letra anonime, bazuar në thënie "më thashë e më the" dhe, nga ana tjetër, i gjithë dokumentacioni i institucioneve shqiptare që provon se një rezultat i tillë nuk ekziston.

E për pasojë, në këtë betejë fitoi thashethemi, i cili u kthye në institucion, duke krijuar disbalancë dhe duke fyer çdo institucion të shtetit shqiptar.

Edhe pse kolegjii nuk mori në analizë pretendime të tilla, këto pretendime ishin shkaqet kryesore të apelimit të vendimit, me qëllim shkarkimin tim. Prandaj, unë ju them me zë të lartë, që unë u mbrojtja, por paracaktimi që i ishte bërë vendimarrjes time me vendosi mua në kushte objektivisht të pamundura, për të fituar një betejë drejtësisht. Më vjen shumë mire për mbrojtjen që kolegët tanë ndërkombëtarë



i bëjnë njëri-tjetrit, por do ju lutesha siç edhe e bëra para Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të mos bëjmë viktima padrejtësisht. Pasi përceptimi është përceptim dhe provat janë prova!

Cilët janë hapat konkret që do të ndërmerremi më tej... ?

Në çdo situatë njeriu ka nevojë për reflektim. Fëmijët e mi kanë qenë mbështetësit e mi më të mëdhenj dhe bashkë me prindërit mbështetësit e mi të vetëm gjatë procesit të rivlerësimit. Me të qeshur, im bir bënte shaka duke u munduar të më largojë vëmendjen nga shkarkimi, e thoshte 'skuadra jonë e vogël humbi betejën, po jo luftën'. Skuadra ime e vogël dhe e vetme, ishin fëmijët e mi si mbështetës, ligji dhe provat si arma ime.

Thashethemi na munda kësaj radhe, - më tha ime bijë. Asaj i them me ndjenjë se në këtë situatë e keqja e shpërndarë kastile si thashethem jashtë institucioneve, si dhe gjetja e mundësisë për të depërtuar në institucione me këto thashetheme mundën skuadrën time të vogël, të përbërë nga dy fëmijët e mi, paçka se shpresonim pafund të tre, pasi armët tona ishin ligji dhe provat. Ndaj hapi konkret është shumë i rëndësishëm. Të mundohemi të ndërgjegjësojmë në çdo detaj shoqërinë, për t'i thënë stop padrejtësisë.

Duke iu referuar edhe rastit tuaj, por edhe përtej, çfarë është, në të vërtetë, në optikën tuaj, vetting-u?

Në optikën time, vetingu ishte shpresa e shqiptarëve

për një drejtësi të pavarur, të përbërë nga njerëz që nuk blihen, nuk shiten, nuk shantazhohen dhe as nuk bëhen pjesë e kafeneve ku bëhen sajesa dhe skema. Në rastin tim, vetingu ishte arma që grupet e interesit përdorën për të më vrarë... Reforma është e rëndësishme, por në emër të saj, nuk mundet të bëhen ekzekutime me viktima të pafajshme.

Cila është e ardhmja e sistemit të drejtësisë pas përfundimit të vettingut?!

Mbetet të presim dhe të shohim. Shpresa e shqiptarëve është e madhe, për ne, për fëmijët tanë, për të drejtat tona. Është e nevojshme që të fillojë një funksionim normal, ku qytetari të gjejë të drejtën e tij në kohën e duhur, ku pensionisti të realizojë të drejtën e pensionit sa është gjallë, ku vrasësi të kapet tani, dhe jo pasi kalon kohë dhe zhduken provat. E ardhmja e drejtësisë duhet të ndihet, të preket, të duket. Ne po rrisim fëmijët tanë këtu, dhe po i edukojmë me sensin e të mirës që fiton karshi të keqes, dhe siguria e tyre garantohet vetëm nga e ardhmja e sistemit të drejtësisë që mbi të gjitha duhet të jetë i drejtë.

Në reagimet tuaja publike keni thënë se gjithçka ndodhi për shkak të çështjeve që keni hetuar; konkretisht cilat dosje i mendoni si më të atakueshmet në punën tuaj?

Unë vijoj ta them, që Elizabeta Imeraj në Prokurori ka përfaqësuar prokuroren që ka guxim. Jam përballur me çështje që kanë çënuar interesa politike,



INTERVISTA

ekonomike dhe kriminale. Të gjitha këto përfaqësojnë grupe interesi, që kanë mundësi të flasin dhe të jenë të dëgjueshme, madje ndonjëherë bëhen edhe të imponueshme. Unë jo më kot e them, se skuadra ime janë vetëm 2 fëmijet e mi, dhe armët e mia janë vetëm ligji dhe provat. Elizabeta Imeraj, nuk ishte pjesë e grupeve të interesit, që u dëgjohej fjala nëpër tavolina, Elizabeta Imeraj nuk ishte pjesë e 'tavolinave të helmit', pasi Elizabeta Imeraj, ishte duke punuar në më të shumtën e kohës dhe duke rritur fëmijët në pjesën e mbetur të kohës.

Hetimet tuaja kanë çuar pas hekurave emra të njohur të politikës dhe të krimit, a ka frikë Elizabeta Imeraj... ?

Jam përballur me kërcënime shpesh herë në

fakt. E për këtë arsye shteti më ka akorduar mbrojtje të posaçme prej shumë vitesh. Sidoqoftë, kam besuar gjithmonë se mund të flegj rehat kur ke të drejtën me vete. Nuk ka vetëm vrasje me armë, ka dhe vrasje profesionale. Në fakt, aktualisht grupet e interesit arrijnë të vrasin profesionalisht prokuroren Elizabeta Imeraj. Përdorën si armë thashethemet dhe denoncimet anonime.

Pas gjithë kësaj që ndodhi, a je ndjerë ndonjë moment e penduar për çka keni bërë dhe dhënë në emër të drejtësisë?

Jo, asnjëherë. Unë e kam zgjedhur vetë të jem prokurorë, dhe është një detyrë që e kam bërë me vullnet dhe pasion. Jam munduar të jem korrekte, dhe shumë e guximshme për të hetuar. Jam impenjuar shumë karshi profesionit tim. Unë e dua të drejtën, e besoj drejtësinë, qoftë drejtësinë shoqërore që gjendet në filozofi, teologji dhe fe, ashtu dhe në drejtësinë procedurale që gjendet në sundimin dhe në zbatimin e ligjit. E për aq kohë sa marr frymë vazhdoj të them me zë të lartë që duhet të bëjmë drejtësi dhe të besojmë në drejtësi.


Nëse riktheheni, a do të ndryshojë ndonjë gjë në qasjet tuaja të angazhimit profesional?

E thashë dhe më sipër, jemi në fazë reflektimi me skuadrën time të vogël, që janë fëmijët. Ndoshta angazhimi karshi të drejtave të njeriut e sidomos për shtresat në nevojë, apo grupet sociale vulnerabël, duke marrë si shkak pikërisht situatën time dhe padrejtësinë e pësuar, duhet të më shërbejë për të reflektuar gjatë e për tu anazhuar aty ku ka më shumë nevojë shoqëria.


Dhe në fund, a keni menduar ndonjëherë: përse gjithë ky sulm?

Sepse jam prokurorja që kam guxuar, dhe një njeri që guxon nuk është i pranueshëm për asnjë. Jam sulmuar pasi është e vështirë që një femër të bëjë karrierë, është e papranueshme për kolegët që rrinë nëpër tavolina dhe të mbysin me thashetheme. Jam sulmuar se nuk bëhem pjesë e pazareve dhe as e skemave. Jam sulmuar sepse jam me të drejtën. Kushdo mundet të thotë, se Gjykata foli, ndaj duhet të pranojmë vendimin e saj, por të gjithë dimë historikun e procesit tim të vetingut, ku të tërë folën dhe thanë çfarë deshën. E dimë që foli Rrahimi, e dimë që foli Valentino, e dimë që folën të gjithë se i kemi dëgjuar. Tani është radha të më dëgjojë publiku, njeriu i thjeshtë që ka besim tek unë; nënë Hatixheja që shet afër shtëpisë time, plaku Mere që sjell qumështin, komshia përballë që troket në derë për çdo gjë, studentët e mi që më shohin me adhurim, dhe skuadra ime e vogël në numër por e madhe në forcë Alvin dhe Adea. Të gjithë bashkë jemi ne, njerëzit e thjeshtë, populli që shpreson te reforma dhe unë, zëri që s'pushoj së foluri për të drejtën nën moton: 'Me ju, Për ju, bashkë.'





TOPTANI



NË ZEMËR

TË TIRANËS!

B ERISHA

A MUND TË NGRIHET SËRISH SFINKSI

Më 22 maj, 31 vite pasi e themeloi dhe u zgjodh për herë të parë në krye, Sali Berisha rikthehet si drejtues i Partisë Demokratike. Çfarë do të thotë kjo për demokratët dhe skenën politike në vend? Revista Newsbomb sjell në këtë analizë shumë prej përgjigjeve që mundojnë sot opozitarët dhe vëzhguesit e jetës publike

Përfytyroni si ngjan sot një anëtar aktiv të Partisë Demokratike. Kokëulur dhe pa shpresë. Prej 9 vitesh përjeton një dramë të vazhdueshme politike e personale. Po mbushet një dekadë, asnjë betejë elektorale e fituar. I përgjigjet çdo kërkesë të partisë së tij, vjen në protesta e marshime. Sakrifikon. Është pa punë. Mobilizohet në votime, si komisioner, numërues ose vëzhgues. Merr fisin dhe shoqërinë, u kërkon të mbështesin PD.

Në shtëpi me gjasë i thonë; boll me këtë temë se nuk ja kemi parë hajrin.

Pas zgjedhjeve të 25 prillit të vitit të kaluar, ai është ndjerë i dërrmuar. Shansi tjetër për të festuar, për të menduar për projektet, ëndrrat e aspiratat, ose për të ushtruar pushtet është 3 vite larg nga sot.

Mundësi teorike sidoqoftë.

S'ka më nerva, nuk ka më pasion. Nuk do të shohë as lajme, as debate politike.

Në lokalin e lagjes përton të kërleshet me zjarr me fqinjin socialist, duk-



shëm i veshur më mirë dhe me kuletë më të rëndë.

Ky anëtar partie, është thirrur sërish më 22 maj të paraqitet për Partinë Demokratike.

Kësaj radhe, për të rikthyer në krye me votë, liderin historik, Sali Berisha, i cili prej vitit 1991, ka ikur 2 herë nga drejtimi, dhe në këtë fund pranvere të vitit 2022 kërkon të ngjisë dhe një herë shkallët që të çojnë tek zyra e kryedemokratit.

Në fakt i ka kaptuar ato, pasi votimi i 22 majit është formal. Sali Berisha do ta fitonte këtë garë me këdo, dhe patjetër edhe me Ihsen Elezin, nëse ai do të qendrojë deri në fund, si i vetmi kandidat që është regjistruar përballë tij.

RIKTHIMI MË I VËSHTIRË

Ky është padyshim rikthimi më i vështirë për doktorin. Jo vetëm se mosha biologjike nuk është një favor, edhe pse rrezaton prore energji e elegancë me kostumet e kravatat të kuruara mirë, por ngase ka disa rrethana shumë të forta, aspak në anën e tij.

Shumë erëra fryjnë kundër.

Më e egra, suferina e vërtetë, ajo e Departamentit amerikan të Shtetit, që është kthyer tashmë në një sfidë permanente. Ambasador-

ja Kim herë pas here kujton shpalljen e tij non-grata dhe sidomos motivin mbi të cilin është ngritur ai dekret. Një goditje që vjen thuajse çdo javë nga një anë ose tjetër.

Një pjesë e strukturave të PD, dhe mbështetës në bazë duket se nuk ngarendin më drejt tij, madje janë kritikë. Nuk është fjala për kryetarin në detyrë, Enkeleid Alibeaj, e rreth 20 deputetë që shkojnë në mbledhjet e thirrura prej tij.

Ka deputetë të tjerë më të heshtur që nuk janë në asnjërën palë, të parreshtuar nëse mund të cilësohen, dhe anëtarë të thjeshtë të PD që nuk janë dakort e nuk mbeten pasues të Berishës, ashtu si nga ana tjetër, janë shumë larg Lulzim Bashës. Këta spikasin si më të kthjellët, më racionalë, dhe si moment, është sak shenjë e emancipimit të kësaj force politike që në 31 vite nuk ka patur kurajon të kontestojë doktorin.

Ata nuk janë dakort me gjuhën e ashpër të liderit historik, me mënyrën se si u zhvilluan zgjedhjet me nxitim në degë e struktura, dhe se si po procedohet në vijim me Këshillin Kombëtar, apo me 22 majin.

Po aq të palëkundur, në të huajësimin ndaj Bashës, që e bëjnë përgjegjës për dështimet elektorale.



Zgjedhjet lokale po afrohen me vërtik, dhe në kushtet që do të jetë pa logon historike, pa godinën, pa subjektin e njohur ligjërisht, Berisha dhe demokratët që e mbështesin do ta kishin të siziftë betejën për pushtetin vendor

paraprake. Më tej, nga dita në ditë pritët çekiçi i trupës gjyquese.

Alibeaj ka apeluar vendimin e Gjykatës së Rrethit të Tiranës, që njohu kuvendin e thirrur nga Berisha me 11 dhjetor. Automatikisht, u legalizuan aktet e këtij Kuvendi, që do të thotë u ligjerua shkarkimi i Bashës dhe mbështetësve të tij më eminentë.

Ditën që foli kësisoj Gjykata e Tiranës, Sali Berisha dhe përkrahësit e tij u kthyen në seli dhe morën zyrat, prej nga ku u përzunë prej policisë së shtetit më 8 janar, pas asaj përplasje të dhunshme e të palavdishme në godinën dhe oborrin e selisë blu.

Vendimi i pritshëm i Apelit, për të cilin në Tiranë njëzëri besojnë se do të jetë kundër doktorit dhe pro-Bashës, do ta komplikojë shumë kursin e mëtejshëm të liderit historik, dhe të krejt demokratëve në fakt.

Askush nuk di të thotë me saktësi se si do të silltet Berisha dhe strukturat që ai tashmë ka ngritur e konstituuar, nëse Apeli do të kthejë çdo gjë mbrapsht.

Vendimi i Gjykatës është i detyrueshëm për t'u zbatuar dhe do të ishte çmenduri injorimi apo sfidimi i tij. Një skenar i tillë mund të

Por një pengesë jo e vogël mund të shfaqet nga dita në ditë për Sali Berishën.

KAOSI QË MUND TË SJELLË VENDIMI I GJYKATËS

Një mur i lartë për t'u kaluar mund të jetë për Sali Berishën verdikti i Gjykatës së Apelit, pas kërkesës që ka bërë Enjkeleid Alibeaj, që në thelb synon mosnjohjen e Kuvendit të 11 Dhjetorit, dhe si pasojë të gjithë vendimeve që dolën nga aty. Çka do të thotë se logoja, vula dhe selia, nuk janë më të Rithemelimit, por i ngelen kryetarit në detyrë, pasuesit të Lulzim Bashës.

Hapi i parë në këtë drejtim është hedhur, që ka qenë pranimi i ankimit në dhomën



POLITIKË



100%
Natural BIO





POLITIKË

rikthente sërish skalionet e përdorimit të forcës në seli, dhe policia e shtetit do të vihej në punë.

Rekursi ndaj një vendimi të tillë në Gjykatën e Lartë kuptohet se do të merrte shumë kohë. Dhe kohë nuk ka.

Zgjedhjet lokale po afrohen me vërtik, dhe në kushtet që do të jetë pa logon historike, pa godinën, pa subjektin e njohur ligjërish, Berisha dhe demokratët që e mbështesin do ta kishin të sizifitë betejën për pushtetin vendor.

Që nga përfaqësimi në KQZ, pasja e komisionerëve, e deri tek kostoja e madhe që do të sillte në publik, shkuarja sërish para qytetarëve me një simbol tjetër, jo me atë, 31 vjeçar, PD.

Shtëpia e lirisë rezultoi e suksesshme për



Rikthimi i Berishës ka sjellë entuziasmin e militantëve, megjithatë jo pak demokratë me këmbë në tokë e dinë se kjo nuk mjafton për të ardhur në pushtet. Zor se një pjesë e shoqërisë do t'i jepte edhe një herë shansin doktorit për t'i qeverisur



Berishën më 6 mars në zgjedhjet e pjesëshme, por gjithkush e di se rezultati do të ishte edhe më i mirë për të, nëse do të kishte shkuar me logon historike. Pasiqë, ka shumë demokratë, tradicionalë, që ndillen, joshen, dhe kanë lidhje



shpirtërore pikërisht me atë sigël. Një raport 3 dekadash tashmë.

KRYESIA DHE DREJTUESIT, PAS 22 MAJIT

Pas Kuvendit të fundit të thirrur nga Berisha u zgjodh Këshilli Kombëtar. Në nivelin e strukturave drejtuese, instancat kryesore kanë ngelur ende pa u formësuar. Që janë Kryetari i Partisë, i cili do të zgjidhet më 22 maj.

Më tej, kryesia, dhe sekretariati.

Ka jo pak garë, ambicie, dhe lëvizje mes demokratëve mbështetës të Berishës për këto pozicione. Përplasja edhe pse mbahet e heshtur dhe nën kontroll nga doktori dhe autoriteti i tij, nuk do të thotë aspak se nuk po ndodh.

Listën me emrat që do t'i shkojnë Këshillit Drejtues, për t'u votuar, do ta paraqesë Sali Berisha, në cilësinë e kryetarit, pas 22 majit.

Ka rivalitet të fortë. Shumë prej anëtarëve të Komisionit të Rithemelimit duan të jenë në

postet kyçe. Po ashtu, e fortë është konkurrenca për të qënë anëtar kryesie.

Në ambjentet e demokratëve flitet shumë për dy emra që mund të jenë nënkryetarët e rinj, Agron Shehaj dhe Luçiano Boçi.

Mbetet e mbushur me mister dhe ankth çështja e Sekretarit të Përgjithshëm, post që është në fakt më i lakmuari. Si favorit shihet Belind Këllici, por përmenden dhe emra surprizë si, një rikthim i mundshëm i Arben Imamit.

E ARDHME E MJEGULLT

Të gjitha këto zhvillime e bëjnë shumë të mjegullt të ardhmen e demokratëve. Nuk ka dyshime tashmë se Berisha do ta marrë nën kontroll forcën politike, në të cilën shfaqet për herë të tretë në këto 31 vite, si kryetar. E para ishte në vitin 1991, kur sapo u krijuar PD. U largua në vitin 92 si u zgjodh President, rierdhi në vitin 1997. Iku në vitin 2013, dhe më 22 maj, vjen sërish në krye.

Rikthimi i Berishës ka sjellë entuziasmin e militantëve, megjithatë jo pak demokratë me këmbë në tokë e dinë se kjo nuk mjafton për të ardhur në pushtet. Zor se një pjesë e shoqërisë do t'i jepte edhe një herë shansin doktorit për t'i qeverisur. Më anë tjetër, me Berishën përballë, Edi Rama do të kishte një bonus të madh. Do t'i zerohej pika e tij më e dobët, që është konsumi tejet i gjatë nga pushteti, dhe mosha biologjike që edhe për atë po ecën.


Por me liderin historik të PD në ring, Rama sërish nuk do të dukej më i vjetër as në politikë, as në thinja. Përkundrazi.

Vetëm një emër i ri, një i ri në çdo kuptim në PD do të krijonte shanse që forca politike që solli pluralizmin në vend, që ishte në pushtet dy herë, dhe drejtoi për 13 vite, të mund të rifitonte besimin e qytetarëve, e të shpëtonte na atrofizimi prej qëndrimit të gjatë në opozitë.

Ka zëra që pohojnë se ndoshta Berisha e di më mirë se gjithkush tjetër se sa e pamundur do të ishte të fitonte një palë zgjedhje politike, e me gjasë, para se ato të vijnë, ai t'i hapë rrugën dikujt tjetër, që këto kohë do të shërbejnë për ta rritur e konsoliduar. Por këto ngelen nanuritje optimiste, kur dëgjojmë shpesh e shpesh vetë doktorin që shprehet se ai do ta mundë Edi Ramën dhe do të jetë sërish kryeministri i vendit.



1992



SALI BERISHA

1997



REXHEP MEIDANI

2002



ALFRED MOISIU

PRESIDENTI I RI, HISTORIA DHE SKENARËT

Nga AFRIM KRASNIQI

Presidenti? Është kreu i shtetit dhe përfaqësues i unitetit kombëtar, por nuk zgjidhet nga qytetarët dhe as nuk nga “shteti” dhe “kombi”. Presidenti zgjidhet nga parlamenti me të njëjtin legjitimitet votash si kreu i Kuvendit, me 71 vota në dy raundet e fundit. Kushtetuta përcakton zgjedhje me 84 vota në tre raunde: ideja, asnjë parti nuk i ka 84 vota ndaj duhet kompromis politik për zgjedhjen e Presidentit. Kjo formulë kushtetuese funksionoi më 2002 dhe 2007, por më 2008 u ndryshua kushtetuta, duke evituar 84 votat dhe kushtin e konsensusit në dy raundet e fundit.

Presidenti ka mandat 5 vjeçar, pra +1 më shumë se legjislatura dhe kryeministri dhe në rastin e vitit 2022, +2 vjet më shumë sesa legjislatura dhe qeveria aktuale. Kjo është e rëndësishme për të kuptuar diferencën në mandate dhe përfaqësim dhe simbolikën se presidenti duhet të jetë i pa ndikuar nga agjendat politike të legjislaturës aktuale dhe qeverisë aktuale. A mund të ndodh kjo kur vetë parlamenti e zgjedh dhe qeveria ka shumicën vendimmarrëse? Për t’iu përgjigjur do të duhet të kujtojmë se Shqipëria është ende një demokraci hibride, një vend në tranzicioni, një model politik ende i brishtë dhe me elitë politike shumë larg nga modelet perëndimore pozitive. Në këtë kontekst, Shqipëria ofron zgjedhje “shqiptare” dhe zgjedhja e Presidentit vështirë të bëjë përjashtim nga praktikat zgjedhore që aplikojnë partitë brenda tyre, partitë në parlament dhe partia në qeveri.

DISA NGA TIPARET KRYESORE TË PROCESIT TË ZGJEDHJES SË PRESIDENTIT NË SHQIPËRI:

Zgjedhja e Presidentit është 100% proces parlamentar

Kushtetuta ka termin “zgjedhje presidenciale”, por de facto nuk ka zgjedhje presidenciale

Zgjedhja inicohet vetëm nga partitë me më shumë se 20 deputetë

Deputetët mund të propozojnë 14 kandidatë (7 në raundet 1x3) dhe 7 në (4x5)

Kur kandidati për President është deputet, ai/ajo mund të votojë për veten e tij

Zgjedhja mund të bëhet edhe me vetëm një kandidat në garë

Zgjedhja bëhet në 5 raunde, 3 raundet e para kërkojnë 84 vota

Zgjedhja legjitimohet edhe kur në 3 raunde në sallë ka më pak se 84 deputetë

Zgjedhja: në raundin 4 dhe 5 zgjedhja bëhet me vetëm 71 vota

Zgjedhja legjitimon raundet edhe kur nuk ka kandidatë në votim

Zgjedhja kushtëzon detyrimin që kandidati të jetë mbi 40 vjeç

Zgjedhja kushtëzon detyrimin që kandidati të jetë banor në RSH në 10 vitet e fundit

Zgjedhja e Presidentit nuk lejon kandidimin ose rikandidimin

Zgjedhja e Presidentit bëhet pa debat për kandidatët/kandidatin

Zgjedhja: kur dështon zgjedhja në raundin 5, Kuvendi shpërndahet / zgjedhje në 45 ditë

Presidenti që jep dorëheqje nuk ka të drejtë të rizgjidhet President

Presidenti e merr detyrën jo kur zgjidhet, por me 24 korrik 2022

Presidenti i zgjedhur mund të vijojë të jetë deputet/zyrtar deri më 24 korrik

Presidenti nuk mund të jetë anëtar i një partie politike

Presidenti nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike

Presidenti nuk mund të kryejë veprimtari tjetër private.

Institucioni i Presidentit nuk ka ligj organik për funksionimin e tij

Presidenti në RSH nuk ka ligj mbi statusin e tij zyrtar në detyrë dhe pas saj

2007



BAMIR TOPI

2012



BUJAR NISHANI

2017



ILIR META

2022



Në ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Presidentit ka pasur dhe ka debate, përfshirë edhe rastet e paqarta ligjore edhe në situata të mësipërme, raportet e institucionit me parlamentin dhe vendimmarrjet e Gjykatës Kushtetuese në këtë drejtim, apo edhe raportet e Presidentit me qeverinë dhe me mazhorancat politike të radhës. Debatet ekzistojnë jo vetëm se nenet dhe dispozitat ligjore janë të interpretueshme, por edhe sepse ushtrues të ndryshëm të funksionit të Presidentit i kanë përdorur dhe ushtruar kompetencat e tyre në standarde të ndryshme, duke krijuar modele presidentësh me dallime midis tyre dhe me vështirësi në krijimin e një modeli referues dhe funksional për së pakur 2-3 presidentë me mandate radhazi. Paqartësitë ndikojnë edhe nga mungesa e studimeve periodike “presidençiale”, ndërkohë që edhe institucionet e Presidentit dhe të Kuvendit, të Shkollës së Magjistraturës dhe fakultetet juridike apo të shkencave politike, gjithashtu nuk kanë botime shteruese profesionale, komantarë ligjesh, shpjegues praktike dhe termash apo qasje të detajuar informative mbi zgjedhjen, kompetencat, përgjegjësitë dhe historinë e institucionit.

HISTORIKU I PRESIDENTËVE 1990-2021

Prej vitit 1991 Shqipëria ka zgjedhur 8 presidentë (një president është rizgjedhur). Konkretisht, Presidentët e zgjedhur kanë qenë: Ramiz Alia (1991-1992), Sali Berisha (1992-1997), Sali Berisha (1997), Rexhep Meidani (1997-2002), Alfred Moisiu (2002-2007), Bamir Topi (2007-2012), Bujar Nishani (2012-2017) dhe Ilir Meta (2017-2022). Vetëm një President është rizgjedhur (Berisha 1997), por ai dhe Alia janë Presidentët që kanë dhënë dorëheqje në vitin e parë të mandatit.

Për shkak të mandatit të përcaktuar dhe datës së zgjedhjeve, pesë Presidentë (Meidani, Moisiu, Topi, Nishani e Meta) janë betuar në të njëjtën datë (24 korrik), i tillë do të jetë edhe presidenti i ri më 2022. Ndërkohë Alia, Berisha dhe Meta kanë qenë objekt hetimi parlamentar për pretendime për shkelje të ligjit / kushtetutës, por vetëm për Presidentin Meta ka pasur akt zyrtar të Kuvendit të RSH për shkarkimin e tij (2021).

Lidhur me propozimet dhe grupet mbështetëse rezultojnë se asnjë nga Presidentët nuk është votuar vetëm nga një parti politike, por ka pasur mbështetje edhe nga partitë e koalicionit dhe aktorë të tjerë politikë, në varësi nga kompozimi i Kuvendit dhe mazhorancës. Konkretisht,

- *Presidenti Alia (1991) është votuar nga PPSH, KV, Omonia;*
- *Presidenti Berisha (1992) është votuar nga PD, PSD, PR dhe PBDNJ;*
- *Presidenti Berisha (1997) është votuar nga PD, PR, PBK, PBDNJ, PLL, etj;*
- *Presidenti Meidani (1997) është votuar nga PS, PSD, PAD, DB, PUK, etj;*
- *Presidenti Moisiu (2002) është votuar nga PS, PD, PR, PDK, etj;*
- *Presidenti Topi (2007) është votuar nga PD, PR, PLL, PBK, PDK dhe 6 deputetë të PS)*
- *Presidenti Nishani (2012) është votuar nga PD, LSI, PR, etj;*
- *Presidenti Meta (2017) është votuar nga PS, LSI, PDIU.*

Pozita kushtetuese e Presidentit të Republikës ka ndryshuar disa herë gjatë viteve 1990-2020. Fillimisht me Dispozitat Kryesore Kushtetuese (1991-1998) Presidenti kishte kompetenca të gjera, përfshirë dy kompetenca thelbësore: e drejta të nxjerrë dekrete me fuqinë e ligjit, si dhe e drejta të organizojë dhe drejtojnë mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Të drejtën e parë e ka përdorur secili nga Presidentit e kësaj periudhe (Alia, Berisha, Meidani), por të drejtën e drejtimit të mbledhjeve të qeverisë e përdorën vetëm Alia dhe Berisha. Kompetencat e Presidentit ishin thelbësore edhe në drejtimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emërimin e zyrtarëve të lartë, rolin drejtues në politikën e jashtme dhe të mbrojtjes, si dhe të drejta ekzekutive në disa sektorë të tjerë specifikë. Pozitat kushtetuese të Presidentit Alia (1991) ndryshuan më 1992, kur Presidentit iu dha e drejta të jetë anëtar në parti politike, duke i lejuar Presidentit të jetë de facto edhe lider i partisë së tij politike.

Gjatë viteve 1990-2000 pothuajse të gjithë presidentët e vendeve ish komuniste, përfshirë ata të Ballkanit dhe Evropës Qendrore dhe Lindore kishin kompetenca të gjëra duke e bërë Presidentin figurën kryesore politike. Vende si Sllovenia, Serbia, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria, Rumania, Polonia, Çekia, Sllovakia, etj, aplikuan zgjedhjen direkte të Presidentit nga qytetarët, disa vende të tjera, përfshirë Shqipëria, Hungaria dhe më vonë Kosova zgjodhën variantin e zgjedhjes së presidentit nga Kuvendi.

Pas viteve 2000 pozitat e presidentëve u ndryshuan duke e kaluar pushtetin real tek kryeministrat, të cilët në shumicën e rasteve ishin edhe liderit e partisë fituese në zgjedhjet parlamentare. Në këtë periudhë datojnë kryeministrat me kompetenca të zgjeruara dhe figura dominuese, si në Shqipëri, Bullgari, Rumani, Kroaci, Slloveni, Turqi, Çeki, Sllovaki, etj. Në Shqipëri të gjithë kryeministrat pas viteve 2000 kanë qenë kryetarë partish dhe mazhorancash, pra figurat kryesore politike, ndërsa Presidentët kanë ardhur nga pozita dytësore në parti ose nga zgjedhje konsensuale.

Në Shqipëri Presidenti Meidani i ushtroi kompetencat e tij me dy paketa të ndryshme kushtetuese, me kompetenca të gjëra bazuar në DKK në periudhën 1997-1998 dhe me kompetenca më të kufizuara bazuar në Kushtetutën e re (1998-2002). Pas vitit 1998 kompetencat e Presidentit u reduktuan disa herë, për të arritur kulmin me ndryshimet kushtetuese të prillit 2008, ndryshime që dobësuan ndjeshëm pozitën kushtetuese dhe politike të institucionit të Presidentit.

Më 2002 Shqipëria pati rastin e parë kur palët politike, të detyruara nga komuniteti ndërkombëtar, vendosën të zgjedhin një president konsensual. Fillimisht PS propozoi ambasadorin Artur Kuko, i cili refuzoi ofertën dhe për pasojë, i kaloi e drejta e propozimit opozitës, kandidati i të cilës Alfred Moisiu mori edhe mbështetjen e mazhorancës. Ai e ushtroi mandatin e tij duke bashkëjetuar me dy mazhoranca të kundërta dhe dy kryeministrat që e kishin zgjedhur, Fatos Nano (2002-2005) dhe Sali Berisha (2005-2007). Të dy palët dhe kryeministrat ndërmorën sulme

denigruese ndaj presidentit. Megjithatë Moisiu mbetet jo vetëm presidenti i vetëm konsensual në Shqipërinë e tranzicionit, por edhe një nga Presidentët më të respektuar në memorien shtetërore dhe publike.

Presidentët Meidani dhe Topi ishin figurat e dyta më të rëndësishme në partitë e tyre politike, i pari i zgjedhur për shkak të nevojës së PS për një imazh të ri publik dhe i dyti duke iu imponuar mazhorancës së vet përmes mbështetjes së një fraksioni të rëndësishëm në PD. Presidenti Nishani është i vetmi i zgjedhur pa pasur pozita më të larta drejtuese sesa ministër dhe duke mos qenë figurë drejtuese politike, ndërkohë që Ilir Meta është i vetmi kryetar parlamenti i zgjedhur deputet në legjislaturën e drejtuar prej vetë atij. Për zgjedhjen e Presidentit më 2012 ishte e nevojshme mbështetja e një grupi deputetësh të PS (për të arritur kuorumin prej 84 deputetësh), kurse në rastet e tjera zgjedhja ishte formalitet.

Kandidatët për President? 1 apo 14? 20 deputetë të Kuvendit mund të propozojnë një kandidat për President në tri raundet e para dhe më pas në raundin e katërt. Kuvendi aktual statistikisht ka 140 deputetë, pra 7 x 20 mundësi për kandidatë, në dy raunde (1-2-3 dhe 4), si I tillë mund të propozojë 14 kandidatë për presidentë, nga të cilët 8 nga mazhoranca dhe 6 nga grupet e opozitës. Këto të fundit nuk janë së bashku, ndaj edhe mundësitë përgjysmohen, ndërkohë që mazhorancat asnjëherë nuk propozojnë më shumë se një kandidat. Praktikën e vitit 1997, 2002, 2007, 2012, 2017 kanë qënë të tilla që kanë pasur vetëm nga një kandidat të mazhorancave politike në zgjedhjen e Presidentit. Më 2007 u inucuan edhe dy kandidatë të tjerë, por kryesisht për qëlime taktike.

Raundet zgjedhore. Tabelat ilustruese e të dhënave dëshmojnë se ka ndryshuar detyrimi kushtetues për më shumë se një kandidat (1991), ka ndryshuar numri i raundeve (nga 1-2 më 1991-1997 në 1-5 në zgjedhjet pasuese), ka ndryshuar koncepti i raundeve si votim dhe si procedurë, si dhe të dhëna të tjera me rëndësi për integritetin e zgjedhjeve presidenciale.

Të dhëna	1991*	1992	1996	1997	2002	2007	2012	2017
Kandidatë	2	1	1	1	1	2	1	1
Raunde	1	1	1	1	1	4	4	4
Vota PRO	172	96	113	110	96	85	73	87

(*) - Parlamenti më 1991 kishte 250 deputete, 1997 kishte 155 deputetë, 1992, 1996, 2002, 2007, 2012 dhe 2017 kishte 140 deputetë.

CRAFT & NATURAL **PUKA BEER**

**BEGEJA 1900 .H.T.P
ALBANIA**



BEER NONA VET!

Birrë e prodhuar në mënyrë aritane,
me fermentim të jashtëm,
ujë bjeshke të Malësisë Pukë (me % të lartë Mg)

RASTE STUDIOMORE:

ZGJEDHJA E PRESIDENTIT MË 2012 DHE 2007

Më 2007 zgjedhja e Presidentit u bë e komplikuar, kryesisht për shkak se Kushtetuta kërkonte 84 vota në çdo raund dhe se mazhoranca kishte më pak vota në dispozicion.

2007	Kandidate	Nënshkrime	Prezent	Vota	Duheshin
Raundi I	Arian Zaimi*	Konsensus	94	-	84
Raundi II	Bamir Topi	29	82	79	84
	Fatos Nano	20	82	3	84
Raundi III	Bamir Topi	29	85	50	84
	Neritan Ceka	21	85	32	84
	Fatos Nano	20	85	3	84
Raundi IV	Bamir Topi	29	90	85	84
	Neritan Ceka	21	90	5	84

(*) - Kandidati Zaimi u përzgjedh nga bisedimet politike konsensuale, por ai nuk u institucionalizua si kandidat, për pasojë nuk mund të konsiderohet si kandidat zyrtar për President

Për të evituar krizën politike dhe kalimin në zgjedhjet e parakohshme mbeteshin dy zgjidhje, ose votimi i një kandidati të propozuar nga opozita ose sigurimi i disa mandateve shtesë nga grupi i opozitës. Mazhoranca e asaj periudhe zgjodhi variantin e dytë, duke siguruar një aleancë fluide me ish kryetarin e PS Fatos Nano, në shkëmbim të 6 mandateve parlamentare mbështetëse.

Më 2007 është rasti i vetëm kur ka pasur kandidatë seriozë në garë dhe ka pasur votime konkurruese. Tabela më poshtë e ilustron më në detaje rivalitetin në katër raunde midis kandidatëve zyrtarë Topi, Nano dhe Ceka. Me ndryshimet kushtetuese 2008, me një praktikë unike kushtetute thekson se “*votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat*”. Koncepti i votimit dhe koncepti i vlefshmërisë së votimit edhe pa votim, pra pa kandidatë, mbetet unikal dhe një zgjidhje e sforcuar e modelit shqiptar në pamundësi për të ndjekur një procedurë të rregullt votimi me kandidatë presidenciale.

2012	Kandidate	Nënshkrime	Prezent	Vota	Duheshin
Raundi I	Xh.Zaganjori*	0	0	0	84
Raundi II	Xh.Zaganjori*	0	0	0	84
Raundi III	Xh.Zaganjori*	0	130	0	84
Raundi IV	Bujar Nishani*	20	76	73	71

(*) - Kandidati Zaganjori u propozua nga PD, por nuk u mblodhën firma dhe për pasojë, nuk u bë kandidat zyrtar për President. Kandidati Nishani u zgjodh pasi kandidati Artan Hoxha, i mbështetur fillimisht me firma nga PD, dha dorëheqje.

Mbi bazën e këtij përcaktimi mund të vijohet tradita e vitit 2012, sipas të cilës, në tri raundet e para asnjë palë politike nuk propozon emra kandidatësh dhe kështu, evitohet mundësia e zgjedhjes me votë të cilësuar, duke kaluar direkt në zgjedhjen me 71 vota. Vetë formulimi se votimi vlen edhe kur nuk ka kandidatë nuk e përjashton mundësinë që të ketë zgjedhje dhe të procedohet me konceptin e raundeve zgjedhore, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor.

SPECIFIKAT E ZGJEDHJES SË PRESIDENTIT MË 2022

Në Shqipërinë e vitit 2022 zgjedhja e Presidentit merr një rëndësi specifike dhe krijon mundësinë për disa skenarë.


Partia Socialiste ka 77 vota në dispozicion, 74 nga grupi i saj parlamentar dhe 3 vota nga PSD, midis të cilëve bëjnë pjesë së paku 5 deputetë janë në listën e sanksioneve amerikane, si dhe disa të tjerë janë në proces shqyrtimi ose nën hetim në Shqipëri. Në gjashtë muajt e fundit PS është përballur me burgosjen e dy ministrave të rëndësishëm të saj, si dhe me arrestime të një deputeti dhe disa zyrtarëve të tjerë të rëndësishëm. Në këto rrethana, logjika e numrave i krijon mjedis të favorshëm PS-së për të zgjedhur çdo kandidat të preferuar prej saj për President, por specifikat dhe problematikat e qeverisjes së saj e nxitin atë të synojë të përfitojë nga momenti për ta bërë zgjedhjen e vet më “legjitime”, si produkt i konsultimeve publike.

PS ka ftuar opozitën në bisedime, por nuk ekziston një situatë e besueshme që mund të çojë në përsëritjen e skenarit konsensual të vitit 2002. PS nuk ka interes dhe asqasje strategjike për zgjedhje konsensuale, por përmes ofertës ajo merr pozitën e partisë konstruktive përballë një opozite të përçarë dhe të paqartë në pjesëmarrjen në proces. Paraprakisht PS ka ftuar deputetët e saj të votojnë nga 3 kandidatë, një praktikë që nuk pritet të sjellë rezultat, por që synon të krijojë “pluralizëm” në parti dhe ti bëjë deputetët të ndjehen të përfshirë në një proces, i cili realisht është atribut i vetëm kryetarit të partisë. PS ka lajmëruar një adresë e-maili me natyrë partiake dhe ka ftuar edhe shoqërinë civile në konsultime apo qytetarët të shprehin sugjerimet e tyre, dy nisma të shoë politik, më shumë të prirura për të krijuar imazhin e konsultimeve dhe të hapjes, sesa për të marrë realisht sugjerime për kandidatë nga jeta civile apo qytetare.

Në parlament ekzistojnë zyrtarisht katër grupe parlamentare, por dy prej tyre janë fiktive, me deputetë të dhuruar nga PD, ndërkohë që vetë grupi i PD-së është në konflikt mbi legjitimitetin përfaqësues dhe drejtimin. Përpjekja për ta trajtuar dialogun politik brenda grupeve parlamentare është praktikë e ndjekur edhe më parë, megjithatë si pala iniciuese (PS) ashtu edhe palët e tjera (opozita) janë të ndërgjegjshme se nuk pritet ndonjë rezultat konkret nga kjo nismë.

Opozitat në Shqipëri vetëm njëherë dhe vetëm pjesërisht kanë

CILI KA QENË PRESIDENTI MË I MIRË NË 30 VITET E FUNDIT?



iniciuar kandidatë për Presidentë, kryesisht në funksion të ndonjë skeme politike të momentit (2007), për të tentuar kalimin në balotazh të dy kandidatëve. Praktika e opozitës që voton kundër ose e bojkoton procesin (1991, 1992, 1996, 1997, 2007, 2012) nuk ka sjellë ndonjë përfitim politik nga opozita, përveçse dobësimin e institucionit të Presidentit dhe të Kuvendit. Më 2022 Opozita ka edhe një detyrim të ri për të qenë pjesë e procesit të zgjedhjes së presidentit (duke propozuar kandidatë ose duke votuar kundër kandidatëve të mazhorancës), për shkak se pjesa radikale e saj sapo miratoi një dokument zyrtar distancimi nga praktikat e bojkotit dhe dorëzimit të mandateve parlamentare.

Opsioni më i mirë për mazhorancën do të ishte një kandidat për President që vjen nga pjesa jopolitike e saj, që siguron edhe disa vota të opozitës, duke fituar njëherësh jo vetëm postin, por edhe legjitimitetin e një zgjedhjeje më të gjerë sesa fuqia e saj politike. Ajo mund ta fitojë garën, por edhe mund të përfitojë kredenciale politike shtesë përmes saj. Opsioni më i mirë për opozitën do të ishte përpjekja për konsensus, dhe në rast dështimi, iniciimi i një ose më shumë kandidatëve për Presidentë me CV dhe të dhëna më profesionale dhe më atraktive sesa kandidatët e mundshëm të mazhorancës. Ajo mund të humbë garën, por mund të fitojë kredenciale morale prej saj.

SKENARËT E MUNDSHËM NË ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT

I. **Shanset për një kandidat konsensual janë minimale.**

PS nuk ndodhet nën presionin e numrave, baza e PS kërkon një "socialist" në zyrën e kryetarit të shtetit, cilësi që nuk e kanë pasur prej vitit 1997-2002. Përpjekjet për konsensus dhe dialog politik mund të ushqejnë debatin politik të ditës dhe ligjërimin politik midis shtatë ditëve në tre raundet për Presidentin, duke tërhequr vëmendjen e opinionit dhe duke ndjekur një agjendë politike paralele me agjendën që do të duhej të ishte prioritarë për vendin dhe sfidat e tij.

II. **Shanset për një president me vota të majta janë maksimale.** PS mund ta zgjedhë Presidentin në raundin e katërt, duke evituar votimin final që rrezikon zgjedhjet e parakohshme, ndërkohë që tre raundet e konsensusit mund të mos prodhojnë kandidatë të pranueshëm për palët. PS ka 6 vota më shumë sesa

minimumi i nevojshëm për zgjedhjen e Presidentit dhe me siguri, çdo emër i propozuar nga kryeministri do të mund të zgjidhet pa asnjë pengesë. Me këtë zgjedhje vendi do të kishte President legjitim, mazhoranca do ta zgjeronte kontrollin e saj mbi institucione, por ende midis 48% të zgjedhësve që kontrollojnë të gjitha pushtetet dhe pjesës tjetër që ka votuar kundër ose ka refuzuar votimin, do të vijojë të thellohet akoma më shumë. Në rast krize një president i njëanshëm politik do ta kishte të pamundur të ushtronte funksionin e negociuesit dhe garantuesit të stabilitetit, dy cilësi thelbësore për Presidentin e Republikës.

III. **Zgjedhje përmes aleancës fluide midis mazhorancës dhe disa deputetëve të partive të tjera.**

Zgjedhje të tilla janë praktikuar edhe më parë dhe nuk përjashtohen as tani kur opozita është e ndarë në së paku 3-4 grupe të ndryshme dhe kur votimi është i fshehtë. Kjo formë zgjedhore do të kishte një produkt presidencial të kritikuar ashpër nga pala e dëmtuar politike, por shumë më legjitim sesa zgjedhja nga 71 votat e mazhorancës.

IV. **Zgjedhja e Presidentit si pjesë e paketës së një zgjidhje politike më të gjerë,** kur përfshihet zgjedhja e Avokatit të Popullit, zgjedhja e drejtuesve të tjerë në disa institucione kushtetuese dhe publike deri edhe tek emërimet e reja të ambasadorëve. Paketa mund të përfshinte reformën zgjedhore, reformën territoriale dhe elementë të tjerë me rëndësi në agjendën politike të palëve. Edhe nëse kjo zgjedhje mund të mos jetë konsensuale në fundin e saj, trajtimi si paketë vendimmarrjeje do të diktonte pranim më të madh të legjitimitetit zgjedhor të Presidentit dhe do të ishte shenjë maturie për dialogun politik dhe reformat kryesore në vend.

V. **E rëndësishme:** pavarësisht skenarëve, - zgjedhja konsensuale, me aleanca fluide apo me vetëm votat e mazhorancës mund të ketë impakt pozitiv dhe të minimizojë risqet politike nëse emri i votuar do të jetë individ me kredenciale publike, me cilësi të njohura të integritetit dhe aftësisë për ushtrimin e funksionit të kryetarit të shtetit. Pra, një zgjedhje racionale dhe cilësore do të mund të shuante debatet dhe kontestimet politike, - praktikë që e kanë ndjekur edhe vende të tjera me sistem parlamentar në rastet e mungesës së dakordësisë midis mazhorancave dhe opozitave politike.



ANALIZË



KRYEMINISTRA SHQIPTARË NË BALLKAN

Kur lundron në faqen e internetit dritan. Kme, në ballinë ndeshesh me një rubrikë: Dritanizimi. Klikon mbi të dhe je përpara një panorame të gjerë fotografish, shoqëruar me informacione të shkurtra. Këto info të servitura në variantin grafik të një “shotsi” të shpejtë alkooli, variojnë nga historia e shtypshkronjës së parë malazeze në shek. 15 e deri tek goli i famshëm me “dorën e Zotit” të Diego Armando Maradonës.

Nuk qëllon shpesh që në faqen e internetit të një politikani, të marrësh informacione sportive apo historike. Por, Dritan Abazović është një politikan atipik.

Që nga prilli 2022, ai drejton qeverinë malazeze, duke nxjerrë në opozitë dhe duke thyer hegjemoninë 30-vjeçare të Partisë Socialdemokrate të Milo Gjukanoviçit. Dritani drejton partinë me emrin “URA”, një gjetje interesante që duket se në shqip jep mesazhin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit. Në fakt, është thjesht akronimi i “United Reform Action”.

Si shumë parti të tjera të shekullit 21, “URA” lindi si një lëvizje social-qytetare në vitin 2015. Dy vite më pas, Dritan Abazović u bë kryetar i saj, pasi braktisi partinë “Positive Montenegro”.

Por, si ia doli një djalë shqiptar nga Ulqini, me një pamje “clean cut” dhe pa i mbushur ende të 40-tat, të marrë drejtimin e qeverisë malazeze? A ishte rezultat i akrobacive politike, rastësisë apo dikush e ndihmoi? Në zgjedhjet e fundit, URA mori 5.5% të votave. Atëherë, a është Dritan Abazović një aksident politik, apo pjesë e një projekti madhor për de-nacionalizimin e Ballkanit?

Përgjigja është diku në mes. Të vërtetat në Ballkan nuk janë bardhezi dhe asnjëherë të thjeshta.

Ja si e prezanton Dritani veten në faqen kryesore të faqes së tij personale në internet: “Pas nacionalizmit në Ballkan fshihen interesat financiare dhe korrupsioni. Ata që e firmosin atë, janë gardianët e këtyre interesave”.

Është shumë e qartë. Dritan Abazović nuk ka ardhur në krye të qeverisë malazeze si “shqiptar”. Ai u ngjit në majën e pushtetit, në një sfond delikat politik dhe në një terren të nxehtë etnik, pikërisht për të dhënë një mesazh të rëndësishëm. Koha e nacionalizmit, sovranizmit dhe shteteve-kombe ka përfunduar përgjithmonë.

Dritan Abazović u ndihmua të ngjitet në krye të qeverisë së një shteti ku 20% e banorëve

**RASTËSI
APO
SKENAR?**



deklarohen serbë, jo për të dhënë mesazhin se pas hegjemonisë serbe në Ballkan, ka ardhur koha e “hegjemonisë shqiptare”. Përkundrazi.

Ngjitja e tij synon të japë mesazhin se faktori ndërkombëtar e sheh Ballkanin si një “shtet” të vetëm të madh dhe sponsorizon e mbështet de-nacionalizimin e tij. Dhe de-nacionalizimi i Ballkanit mund të ndodhë jo thjesht kur minoritetet të gëzojnë të drejta, por kur përfaqësimi i tyre në nivelet më të larta, s’do të jetë më një tabu. Nuk do të përbëjë më lajm.

Do ishte naivitete të mendohej se Dritan Abazović u ngjit në krye të qeverisë malazeze si revansch “shqiptar” mbi sllavët. Ai përfaqëson aty, ‘njeriun e ri’ të politikës ballkanike, një produkt i shkollave dhe akademive të Perëndimit, ku “nacionalizmi” trajtohet si zgjebe dhe lavdërohet teoria e shoqërisë së hapur dhe zhbërja e kufijve territorialë.

Për të njëjtat arsye, shqiptari i vetëm në parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi “lejohet” të flasë hapur për të drejtat e preshevarëve, për shtypjen që shumica i bën pakicës në Serbi. Për të njëjtat arsye, komuniteti ndërkombëtar insiston që minoritetet të jenë gjithnjë faktor vendimmarrës në qeverinë e Kosovës. Për të njëjtat arsye, amerikanët e mbështesin në heshtje iniciativën e “Ballkanit të Hapur”. Megjithatë e dinë që është një projekt pa produkt, mesazhi që jepet tek dy popujt që janë vrarë ndër veti

së paku në 150 vitet e fundit, është pajtimi dhe bashkëjetesa. Dhe kjo nuk është pak.

Amerikanët shohin “big picture”. Paqja dhe stabiliteti dhe jo inatet e vjetra ballkanike janë në interesin e tyre kombëtar dhe global. Shqiptarëve kjo mund t’u dhembë, se plagët janë ende të freskëta. Por, jeta vazhdon.

Në këtë kuptim, “shqiptari Dritan” në krye të popullit malazez, është një fenomen që do të përsëritet në të ardhmen.

Sot mund të tingëllojë tabu, por s’do të jetë çudi që dekadat e ardhshme në krye të qeverisë së Shqipërisë, të jetë një përfaqësues i një minoriteti etnik. (Sepse përfaqësues të minoriteteve kulturore ka patur)

I njëjti fenomen mund të ndodhë në Kosovë. Sot, minoritetet etnike serbe, turke e boshnjake përfaqësohen me ligj në parlamentin e Kosovës. S’do ishte e pamendueshme që një ditë, në karrigen e Albin Kurtit të shihnim pikërisht një serb, një turk apo një boshnjak.

Ky fenomen mund të ndodhë në Shkup. Madje, që kryeministri i Maqedonisë së Veriut mund të jetë shqiptar, është shënim që i përket real-politikës. Për këtë, ekziston një marrëveshje e shkruar.

Me pak “fat”, në vitin 2024, mund të kemi 4 kryeministra shqiptarë në Ballkan.

E lidhur në gusht të vitit 2020, marrëveshja e Shkupit mes kreut të BDI, Ali Ahmetit dhe kreut të LSDM, Zoran Zaev sanksionon që në fund të mandatit qeverisës, kryeministri “tranzitor” i vendit do të jetë një shqiptar, për së paku 100 ditë.

Po u respektua marrëveshja, në vitin 2024 do të kemi për herë të parë një kryeministër shqiptar në Maqedoninë e Veriut. Më gjasë, vetë Ali Ahmetin.

Pra, nëse nuk do të ketë surpriza dhe kriza të rënda politike, pas dy vitesh në Ballkan do të ketë 4 kryeministra shqiptarë, Edi Rama, Albin Kurti, Dritan Abazović dhe Ali Ahmeti. Këta janë politikanë karriere që dinë të bashkëjetojnë dhe të bashkëpunojnë me politikanë të etnive të tjera. A do të bashkëpunojnë dot me njëri-tjetrin?

Shkëlqimi dhe ngritja në majën e pushtetit e Dritan Abazovićit. Si u bë ulqinaku kryeministër i Malit të Zi me vetëm 5.5% të votave? A do të kemi së shpejti një shqiptar në krye të qeverisë në Maqedoninë e Veriut? Dhe pikëpyetja e madhe, a janë këto koincidenca fatlume apo emërime të projektuara diku “lart”?

NOVACION

SHQIPËRIA E BARRIERAVE TË SUKSESIT!

DEAN ÇELAJ



Vlerësimi

“Forbes” në seksionin “SOCIAL IMPACT” vlerëson të rinjtë shqiptarë Dean Çelaj mes 30 njerëzve më të suksesshëm nën 30 vjeç. Ai është krijues i shumë projekteve teknologjike ndërkombëtare në bashkëpunim me Universitetin e Harvardit. Çelaj është duke ndjekur studimet për master në Universitetin e Harvardit! Aty është duke punuar në projekte të ndryshme në fushën e teknologjisë si bashkëpunëtor i platformave studimore me pedagogët e Universitetit!

Akademi.al

24.254 video mësimesh u prodhuan për të ndihmuar studentët të mësonin nga shtëpitë

Më shumë se 500.000 studentë përfituan nga mësimi online
1000 video u publikuan në platformë për fëmijët me çrregullime

44.435 klasa virtuale u organizuan nga mësuesit gjatë pandemisë Covid-19

Nxënës dhe mësues nga 1300 shkolla publike kanë përdorur platformën

91% e gjithë nxënësve në Shqipëri e kanë shkarkuar platformën Akademi.al

Pse largohen të rinjtë nga Shqipëria? S'i duam kur i kemi dhe i duam kur s'i kemi! Rasti i djaloshtit vlonjat 24 vjeçar Dean Çelaj, i përzgjedhur nga revista Forbes si më të suksesshmit nën 30 vjeç. Krijimi i platformës Akademi.al dhe rruga drejt suksesit

Ditët e fundit mund të keni dëgjuar shpesh nëpër media të ndryshme të shkruajnë dhe të flasin për Dean Çelaj. Djalë 24-vjeçar me origjinë nga Vlora, i rritur në Tiranë, i cili ka qënë kryefjala në të gjithë qarqet e profesionistëve në kryeqytet.

Prestigjiozia "Forbes" ka përzgjedhur Dean Çelaj si një nga personat me më shumë influence në botë, nën moshën 30 vjeç, të cilët janë duke bërë transformime sistematike dhe të qëndrueshme në fusha të ndryshme si arsimi, biznesi dhe më gjerë.

Por emri i Deanit nuk është i panjohur për ekosistemin e start up-ëve dhe komunitetin e edukimit në Shqipëri. Në Shtator 2019, Dean Çelaj themeloi platformën Akademi.al disa muaj pasi u kthye nga studimet e tij në një nga kolegjet më në zë në Londër, Angli, për të dhënë kontributin e tij për vendin dhe arsimin.

Pas disa muajsh në Mars të 2020, nën pandeminë globale Covid-19 shkollat kudo në botë përfshirë dhe ato në Shqipëri u mbyllën për të kthyer procesin mësimor tërësisht në një metodologji të re të mësimin online. Nisur nga nevoja e një platforme kombëtare për të mbështetur procesin e mësimdhënies online, Deani vuri në dispozicion të plotë të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë platformën Akademi.al së bashku me një përmbajtje të konsiderueshme video leksionesh, të cilat u përdorën përgjatë pandemisë Covid-19 e më tej, nga të gjithë nxënësit dhe mësuesit e sistemit para-universitar shqiptar. Ishte hera e parë që arsimi në Shqipëri, që në tërësinë e tij mbetet tej tradicional, u mbështet me një produkt inovator dhe dixhital tërësisht në gjuhën shqipe. Platforma u përdor nga 91% e nxënësve në të gjithë Shqipërinë, sipas studimit të bërë nga Komisioni Europian që në atë kohë, e shpalli Deanin një nga "Europianët që po bëjnë diferencën në botë".

Ndërsa situata muaj pas muaji i kthehej normalitetit, mendja e Deanit ishte si një depo plot me ide të reja. Idetë e tij të hedhura në letër u propozuan kudo, madje edhe në media, por me shpenzime publike për arsimin që nuk i kanë kaluar 3% që nga viti 2001, sa shpresë kishte Deani që të përkrahej me fonde nga qeveria shqiptare për të vendosur në zbatim idetë e tij? Asi nën mëngë

ishin dhe mbetën donatorët.

Megjithatë, një i ri ambicioz si Deani nuk mund t'i varte shpresat vetëm nga fondet e një numri aq të vogël donatorësh në Shqipëri. Shqipëria është vendi i burokracive dhe Deani kishte nevojë për një frymë tjetër.

Dhe mori vlerësime nga më të mirat nga pedagogë dhe profesionistë të fushës së teknologjisë në arsim. Me t'u zhvendosur në SHBA, si rezultat e një burse të plotë të fituar nga Universiteti i Harvardit që i ofrohet vetëm 1 studenti në vit, ai vendosi ta shfrytëzonte në maksimum frymën amerikane për t'i dhënë jetë ideve të tij. Prezantimi i platformës akademi.al në kontinentin e ri gjeti përkrahje, aq sa në më pak se 1 vit që nga zhvendosja e tij në Amerikë, Deani fitoi çmimin e Ndikimit Social të Harvard-it dhe u rendit nga revista prestigjioze "Forbes" si një nga

30 të rinjtë më të suksesshëm në botë dhe mori vlerësime nga më të mirat nga pedagogë dhe profesionistë të fushës së teknologjisë në arsim.

Histori suksesi të të rinjve shqiptarë në botë janë dëgjuar dhe patjetër që do dëgjohen edhe herë të tjera. Krenaria është një virtut i shqiptarëve dhe kush më mirë se ne di të krenohet për arritjet personale. Ne dimë të krenohemi madje edhe për suksesin e të tjerëve, mjafton që ky sukses të mos jetë arritur në Shqipëri. Ashtu si në rastin e Deanit. U desh një vlerësim nga Harvard dhe Forbes që puna dhe suksesi i këtij të riu të jehonte anëmbanë Shqipërisë dhe ne të krenoheshim me të. Është suksesi i këtyre të rinjve që migrojnë jashtë me të cilat mburret shteti ynë, por që bën shumë pak për ta.

Pavarësisht të gjithave, Deani do të vijojë kontributin e tij në Shqipëri me besimin se mbështetja dhe përkrahja do të vijnë me kohën. Ndërkohë, idetë e tij po gjejnë mbështetje në SHBA dhe së shpejti do të dëgjojmë për projekte dhe me siguri triumfe të reja.



DEAN ÇELAJ



Ndërtimet prej betoni dhe tip kutie në të ashtuquajturat fshatra turistike, të kthyer në rezidenca hermetike privatësh

SHKËLQIMI DHE RËNIA E FSHATRAVE TURISTIKE



METAMORFOZA E TRISHTË E INVESTIMEVE NGA LEJET PËR FSHATRA TURISTIKE, TË KTHYERA NË VILA HERMETIKE PËR PRIVATË

Nga FATOS ÇOÇOLI

Sapo doli lajmi se qeveria u ka dhënë statusin e investitorëve strategjikë, Artan Gaçes, ndërtues, bashkëshort i ministres së Jashtme Olta Xhaçka apo edhe Gazmend Pajës, humorist i portokallisë dhe djali i humoristit të njohur Luftar Paja, media dhe rrjetet sociale u push-tuan nga komentet sesi këta individë kishin përfituar statusin e investitorit strategjik në zona aq të dëshiruara, bregdet.

Të dy investitorët strategjikë, dhanë argumentet e tyre, madje nxorrën edhe hartat sesi do të zhvilloheshin zonat turistike, plot me vila të vogla dykatëshe që shohin përtej detit Jon. Përpara tyre, çdo zall bregdeti, u përket po ashtu këtyre fshatrave. Pak vend ka për komente, kur tabelat anë tyre të thonë “zonë e ruajtur me kamera”, apo “plazh privat”.

Ideja e investitorit strategjik që po zhvillon bregdetin shqiptar nuk është një ide e re. Zhvillimet e shumta urbane, pas viteve '90, sollën një kaos të jashtëzakonshëm në vend, ku plazhi i gjerë dhe i shtrirë i Durrësit, deri poshtë Kavajës, u mbush me ndërtime kaotike, pa formë e pa përmbajtje, me njerëz që zinin kuturu nganjë copë tokë në rërë, e aty fillimisht ndërtuan kioskat, që tani pas 30 vjetëve, janë shndërruar në hotele, pallate, vila.

Nuk ka asnjë qeveri që mund të jetë e gatshme të ndërhyjë në atë zonë, aq sa plazhi humbi gjithçka që kishte mbetur me fanatizëm me ato pishat e larta e të bukura dhe bregdetin mbushur me rërë e çadrat e vendosura në mënyrë të çrregullt nga ata që përfitonin kabina plazhi apo ishin turistë ditorë. Kaosi urban i

Gjatë dy dekadave të fundit, 99 përqind e dhjetëra lejeve për fshatra turistike u keqpërdorën për të shitur vila dhe apartamente, një pjesë duke pastruar para të korrupsionit dhe të trafikëve të paligjshme



plazheve ecte me shpejtësi dhe nga dita në ditë, shihje të tjera kërpuha që hapeshin si pas një shiu.

Nga vitet 2000, pati një formë tjetër zhvillimi, në ato që u quajtën “fshatra turistike” në zonën e Durrësit. Elita e vendit, ato që kishin buxhete financiare, prenotuan aty shtëpitë e tyre, rrethuar nga pishat, me dokumente që merreshin me vendime të KKRTSH-së së kohës, por pa pronësi mbi truallin, apo me pronësi 99 vjeçare. Pas kaq vitesh, askush nuk ua merr dot shtëpitë e plazhit aristokratëve të Shqipërisë, por kur e panë që plazhi i Durrësit u popullua shpejt, ata nisën një tjetër inkursion: drejt Gjirit të Lalzit, e më së shumti, drejt Jugut, Perlës turistike të Shqipërisë.

Brenda një dekade, u harruan brezalet e bukura të Lukovës dhe jo vetëm. U harruan rrugët gjarpëroshme me çakull, u shtrua asfalt për makinat luksoze që





TABELA 1. OBJEKTIVAT E STRATEGJIVE AFATGJATA PËR TURIZMIN

-	Ndërtimet në bregdetin e detit Adriatik të ishin të ulta
-	Ndërtimet në bregdetin e detit Jon të bëheshin në përputhje me relievin, të ishin të grupuara dhe të kryheshin pas brezit të gjelbër
-	Ndërtimet t'i përshtateshin arkitektures lokale, të mos ishin prej betoni dhe tip kutie
-	Të ruanin mjedisin
-	Të bëhej një planifikim strikt urbanistik.

duhet të hynin brenda shtëpive që elita e vendit, kishte marrë në bregdet. Vila, vila, vila...askush nuk mendoi ndonjëherë për ndonjë hotel, të kishte kapacitetin të mbledhte turistët që do të vinin në Shqipëri. Aty, mendohej të krijohet turizmi elitar. Por “koncepti i turizmit elitar”, u zhduk në drejtim të paditur.

* * *

Gjatë 30 viteve 1993-2022, janë përgatitur gjashtë strategji turizmi për vendin tonë. Disa

prej tyre edhe me kontributin e ekspertëve të Bankës Botërore, GIZ, etj. Të gjitha strategjitë kanë synuar zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë numër një të vendit dhe që të gjitha kanë dështuar!

Ajo që propozonin të gjitha këto strategji ishte që ndërtimet në bregdetin Adriatik të ishin të ulëta, ndërsa ato në Jon të bëheshin në përputhje me relievin, të grupuara dhe pas brezit të gjelbër.

Strategjitë i mëshonin shumë domosdoshmërisë që ndërtimet t'i përshtateshin arkitekturës lokale, pra të mos ishin prej betoni dhe tip kutie, por të ruanin mjedisin dhe të bëheshin kundrejt një planifikimi strikt urbanistik. U hodh edhe ideja e agjencive “one stop shop” (me një ndalesë) për investimet në turizëm.

Në fakt, ndodhi e kundërta. Asnjë nga drejtimet kryesore të strategjive, si konkurrenca e lirë, fokusi tek klienti-turist dhe pozicionimi në treg nuk u realizua. Të gjitha objektivat dhe orientimet e mësipërme u shpërfillën nga qeveritë, si të djathta dhe të majta, që u alternuan në pushtet gjatë viteve 2002-2022.

Shitja e tokës së dhënë nga lejet për fshatrat turistike, blerësve të vilave dhe apartamenteve, të cilat u kthyen në zona residencale, përmbylli dhe betonoi zbatimin e pasuksesshëm dhe kriminal të ligjit për turizmin.

**TABELA 2. PESË PIKAT E PËRBASHKËTA
TË PAZBATUARA TË STRATEGJIVE 1993, 2002,
2007, 2011, 2014 DHE 2018**

1. Mungesa e zbatimit të ligjit (në lidhje me ndërtimet dhe mjedisin).

2. Zhvillimi i paplanifikuar. Jo sipas modeleve të qarta. I paorganizuar në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. I pabazuar në hierarkinë strategji-masterplane-zona për zhvillim-plane investimi.

3. Mungesa e kontrollit mbi zhvillimet e mjedisit.

4. Mungesa e veprimit të institucioneve sa i përket krijimit të strukturave, politikave, standardeve, klimës së favorshme për biznes, menaxhim inteligjent i tregut, zhvillim produktesh dhe shërbimesh dhe i burimeve njerëzore.

5. Mungesa e bashkëpunimit mes sektorit publik, privat, qendror dhe lokal.



Apartamente-vila të privatizuara në një
gjoja fshat turistik në Gjirin e Lalëzit

**MODELI “GJIRI I LALËZIT”- PJELLË E SHPËRFYTYRUAR
E ABUZIMEVE ME LEJET PËR FSHATRA TURISTIKE**

Vërshimi i fshatrave turistike, të destinuara thjesht dhe vetëm për shitje, në vend të resorteve me kapacitete të mëdha akomodimi dhe të gatshme në çdo kohë për të dhënë me qera mjediset e tyre për turistët vendas ose për grupe të organizuara turistësh nga vendet perëndimore, lindore, etj., jo vetëm nuk i dha industrisë së turizmit atë vlerë të lartë dhe të shtuar që i ka dhënë në Greqinë fqinje, në Itali, Kroaci, Spanjë, etj., por bllokoi me qindra hektarë tokë në bregdet, peng të qindra familjeve të kamura pushtetarësh, politikanësh të

korruptuar, prokurorësh, gjykatësish, etj, duke mos lejuar përdorimin efektiv të tyre për mijëra dhe dhjetëra mijëra turistë gjatë gjithë vitit, në dobi të të ardhurave të shtuara për gjithë ekonominë e vendit dhe për komunitetin e fshatrave përreth.

Bregu i Jugut të vendit sot, perla e Rivierës Shqiptare, po zhvillohet me modelin e Gjirit të Lalëzit, një sipërfaqe prej qindra hektarësh, dikur në mes të një pylli të bukur, të pacënuar nga vala e ndërtimeve që zaptoi Durrësin fill pas viteve 1990-të, sot të zaptuar dhe të përcudnuar nga “kolonitë” hermetike të fshatrave turistike.

Në Gjiri i Lalëzit, por jo vetëm aty, praktikisht në të gjithë Shqipërinë, ku janë shpërndarë këto “fshatra turistike”, banesat shfrytëzohen nga pronarët privatë një ose dy muaj në vit, duke punësuar vetëm dy-tre punonjës sigurie për ruajtjen e tyre gjatë gjithë pjesës tjetër të vitit.

Ndërtimet e fshatrave turistike përgjatë gjithë bregut të Lalëzit kanë dëmtuar kurorën e pishave të gjelbra. Banorët e Ishmit nuk po shohin përfitime nga popullimi i bregut gjatë verës. Zona është kthyer hermetike, me vila luksoze, të cilave nuk u afroresh dot.

Të rrethuara me gardh mbrojtës dhe me roje të armatosura, përveçse thjesht kanë shtuar kuriozitetin për jetën matanë, nuk kanë sjellë asnjë përfitim për popullsinë e zonave përqark.

Fshatrat turistike të Lalëzit nuk kanë rritur dukshëm në zonë kërkesën për prodhime ushqimore të freskëta, as edhe e kanë nxitur bujqësinë dhe artizanatin përreth. As kërkesë të dukshme për punësim nuk ka pasur.

Megjithë këto dështime në sjelljen e efekteve pozitive për ekonominë në tërësi dhe për zhvillimin e zonave përreth fshatrave turistike në veçanti, ky model i dështuar dhe krejtësisht i shpërfytyruar i atij që në realitet duhet të jetë një fshat turistik, po përhapet me shpejtësi në Jugun e vendit, në Bregdetin e Jonit dhe po bën kërdinë në bllokimin dhe zënien e zonave më elitare për turizëm në Shqipëri.

Për fat të keq, zhvillimi i turizmit tek ne, sidomos me fillimin e Mijëvjeçarit të ri, nuk erdhi nga ndjekja e objektivave të zhvillimit afatgjatë, të marketimit agresiv të destinacioneve tona turistike dhe menaxhimit përmes përvojës konkurruese në rajon, duke



Apartamente-vila në Gjirin e Lalëzit

Fshatrat turistike të Lalëzit nuk kanë rritur dukshëm në zonë kërkesën për prodhime ushqimore të freskëta, as edhe e kanë nxitur bujqësinë dhe artizanatin përreth. As kërkesë të dukshme për punësim nuk ka pasur

përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe krijuar produkte me çmim të leverdisshëm dhe imazh pozitiv, por nga etja e pangopur për fitim e kompanive dhe sipërmarrësve pranë qeverive dhe nga nevoja urgjente për të pastruar para të korrupsionit dhe krimit të organizuar me blerje apartamentesh dhe vilash në bregdet.

Në këtë mënyrë, politikat e zhvillimit të turizmit hynë në një simbiozë të rrezikshme me korrupsionin galopant në nivel qeveritar dhe me interesat e krimit të organizuar për të pastruar paranë e trafikeve të paligjshme. Këtë e dëshmojnë aferat e denoncuara në media për dhënien në përdorim klientëve të qeverisë të tokave në Bregdetin e Jugut, në shkelje flagrante të të drejtave të ligjshme të fshatarëve të Bregut, si dhe të pasurive kombëtare me rëndësi strategjike, në mungesë të plotë të planeve të investimit dhe bashkëpunimit me pushtetin vendor.

RASTI EMBLEMATIK KAKOME

Qeveria shqiptare vendosi të japë me koncesion hapësirën prej 70 hektarësh në gjirin e Kakomesë në mesin e vitit 2012. Koncesioni u dha në bazë të një ligji të vitit 1993, i cili nuk njeht pronësinë private në tokat pranë bregut të detit. Në këtë histori u përfshi edhe shoqëria e njohur botërore e menaxhimit të resorteve luksoze turistike Club Mediteranee (Club Med), e cila deklaroi se merrte përsipër të realizonte për 15 vjet administrimin e fshatit turistik në Kakome. Fshati Kakome do kthehej në pjesë të rrjetit turistik mesdhetar të kësaj shoqërie.

Zhgënjimi i Club Med nga rezultati me investimin e marrë përsipër përbën një humbje

të jashtëzakonshme imazhi të vendit tonë, si vend turistik i sigurtë për investimet elitare në turizëm.

Përpara se të nisnin punimet për fshatin turistik, investuesi u përball me kundërshtimet e banorëve të fshatit Nivicë. Ata zhvilluan protesta të vazhdueshme, ndërtuan çadra dhe qëndruan 24 orë në 24 për të bllokuar punimet.

Sipas dokumenteve të paraqitura prej tyre, 126 familje të fshatit janë pronarë të 4,300 hektarëve kullota. Ndërsa pjesa më e madhe e kullotave janë toka pa vlerë të konsiderueshme financiare, gjiri i Kakomesë është pjesa më e rëndësishme e kësaj prone. Banorët e Nivicës u shpronësuan në vitin 1946 nga kullotat e tyre. Në një kohë ku problemet e pronësisë së tokës në vendin tonë janë ende në një mish-mash të pazgjidhur, kalvari i ndërtimit të fshatit turistik Kakome ende nuk dihet kur do të përfundojë.



Gjiri spektakolar i Kakomesë



të huajt:

Natyra e mrekullueshme, njerëz të këqinj e për të të rrjepur!

[illegible]

REPORTAZHË NGA KRAHINAT

Vlora

Qyteti i Flamurit
Qyteti i Banjave
Qyteti i Qetësisë

Tentativa e parë e promovimit të turizmit në vend, ishte ajo e qeverisë së dalë nga zgjedhjet parlamentare të 1921, ku Ministria e Punëve të

Por, sigurisht, at që k
vizitimi spektakle për v
e ka qënë kurrë të vjetër
murat, ose e ka qënë i infon
mirë nga ata, që kanë qen
këtë qytet.

11-11-11

...Ejlli këtu Vlorë, në
lart nga jehonat
në M...

... a pământului și a aerului
... și grama kiba...

urimare, în...

...le kettij viik, per l'u
...pergengesitum te
...lalevel ne...

...e parajita. Vlorë
mbetor pas...

...on is loostal se väinjalit, ajer
laetit, kane järe jannu e se lo-
noqrit. Piekunilaidi te pakkun
is pakkun, sta kane te dregu pür
laenderinn mäs is muth, pär mäs-
vään e mäsänä. Qs kane
shittat dno shilloges pür l'ei-
guuar. Shittat l'one mäs te ar-
dhar postit, dno qd r'et
kimes tipke mäs qd r'et
ni.

Arbeitskreis *ar-bayts'-kreys*

Merito je e siguri detyrat

...parte
rischi
ma...

... și în luna iulie, pe sa mare
... ar avea gustul, în timp ce

...e tineri...
...e tineri...
...e tineri...

Skala: vänd i höger
Nje liden

la, e alla festa

głos dyktando.

...die me
...die me
...die me

uchi i Włoch-

See to it you are a

ri ngra 10 km. Elaf-

Si per deia me fura
gurr one bini

a shellfish gradually

by J. Durrant

...the bathroom.

me e bakar

1999, 2000, 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 2025, 2026, 2027, 2028, 2029, 2030, 2031, 2032, 2033, 2034, 2035, 2036, 2037, 2038, 2039, 2040, 2041, 2042, 2043, 2044, 2045, 2046, 2047, 2048, 2049, 2050, 2051, 2052, 2053, 2054, 2055, 2056, 2057, 2058, 2059, 2060, 2061, 2062, 2063, 2064, 2065, 2066, 2067, 2068, 2069, 2070, 2071, 2072, 2073, 2074, 2075, 2076, 2077, 2078, 2079, 2080, 2081, 2082, 2083, 2084, 2085, 2086, 2087, 2088, 2089, 2090, 2091, 2092, 2093, 2094, 2095, 2096, 2097, 2098, 2099, 2100, 2101, 2102, 2103, 2104, 2105, 2106, 2107, 2108, 2109, 2110, 2111, 2112, 2113, 2114, 2115, 2116, 2117, 2118, 2119, 2120, 2121, 2122, 2123, 2124, 2125, 2126, 2127, 2128, 2129, 2130, 2131, 2132, 2133, 2134, 2135, 2136, 2137, 2138, 2139, 2140, 2141, 2142, 2143, 2144, 2145, 2146, 2147, 2148, 2149, 2150, 2151, 2152, 2153, 2154, 2155, 2156, 2157, 2158, 2159, 2160, 2161, 2162, 2163, 2164, 2165, 2166, 2167, 2168, 2169, 2170, 2171, 2172, 2173, 2174, 2175, 2176, 2177, 2178, 2179, 2180, 2181, 2182, 2183, 2184, 2185, 2186, 2187, 2188, 2189, 2190, 2191, 2192, 2193, 2194, 2195, 2196, 2197, 2198, 2199, 2200, 2201, 2202, 2203, 2204, 2205, 2206, 2207, 2208, 2209, 2210, 2211, 2212, 2213, 2214, 2215, 2216, 2217, 2218, 2219, 2220, 2221, 2222, 2223, 2224, 2225, 2226, 2227, 2228, 2229, 2230, 2231, 2232, 2233, 2234, 2235, 2236, 2237, 2238, 2239, 2240, 2241, 2242, 2243, 2244, 2245, 2246, 2247, 2248, 2249, 2250, 2251, 2252, 2253, 2254, 2255, 2256, 2257, 2258, 2259, 2260, 2261, 2262, 2263, 2264, 2265, 2266, 2267, 2268, 2269, 2270, 2271, 2272, 2273, 2274, 2275, 2276, 2277, 2278, 2279, 2280, 2281, 2282, 2283, 2284, 2285, 2286, 2287, 2288, 2289, 2290, 2291, 2292, 2293, 2294, 2295, 2296, 2297, 2298, 2299, 2300, 2301, 2302, 2303, 2304, 2305, 2306, 2307, 2308, 2309, 2310, 2311, 2312, 2313, 2314, 2315, 2316, 2317, 2318, 2319, 2320, 2321, 2322, 2323, 2324, 2325, 2326, 2327, 2328, 2329, 2330, 2331, 2332, 2333, 2334, 2335, 2336, 2337, 2338, 2339, 2340, 2341, 2342, 2343, 2344, 2345, 2346, 2347, 2348, 2349, 2350, 2351, 2352, 2353, 2354, 2355, 2356, 2357, 2358, 2359, 2360, 2361, 2362, 2363, 2364, 2365, 2366, 2367, 2368, 2369, 2370, 2371, 2372, 2373, 2374, 2375, 2376, 2377, 2378, 2379, 2380, 2381, 2382, 2383, 2384, 2385, 2386, 2387, 2388, 2389, 2390, 2391, 2392, 2393, 2394, 2395, 2396, 2397, 2398, 2399, 2400, 2401, 2402, 2403, 2404, 2405, 2406, 2407, 2408, 2409, 2410, 2411, 2412, 2413, 2414, 2415, 2416, 2417, 2418, 2419, 2420, 2421, 2422, 2423, 2424, 2425, 2426, 2427, 2428, 2429, 2430, 2431, 2432, 2433, 2434, 2435, 2436, 2437, 2438, 2439, 2440, 2441, 2442, 2443, 2444, 2445, 2446, 2447, 2448, 2449, 2450, 2451, 2452, 2453, 2454, 2455, 2456, 2457, 2458, 2459, 2460, 2461, 2462, 2463, 2464, 2465, 2466, 2467, 2468, 2469, 2470, 2471, 2472, 2473, 2474, 2475, 2476, 2477, 2478, 2479, 2480, 2481, 2482, 2483, 2484, 2485, 2486, 2487, 2488, 2489, 2490, 2491, 2492, 2493, 2494, 2495, 2496, 2497, 2498, 2499, 2500, 2501, 2502, 2503, 2504, 2505, 2506, 2507, 2508, 2509, 2510, 2511, 2512, 2513, 2514, 2515, 2516, 2517, 2518, 2519, 2520, 2521, 2522, 2523, 2524, 2525, 2526, 2527, 2528, 2529, 2530, 2531, 2532, 2533, 2534, 2535, 2536, 2537, 2538, 2539, 2540, 2541, 2542, 2543, 2544, 2545, 2546, 2547, 2548, 2549, 2550, 2551, 2552, 2553, 2554, 2555, 2556, 2557, 2558, 2559, 2560, 2561, 2562, 2563, 2564, 2565, 2566, 2567, 2568, 2569, 2570, 2571, 2572, 2573, 2574, 2575, 2576, 2577, 2578, 2579, 2580, 2581, 2582, 2583, 2584, 2585, 2586, 2587, 2588, 2589, 2590, 2591, 2592, 2593, 2594, 2595, 2596, 2597, 2598, 2599, 2600, 2601, 2602, 2603, 2604, 2605, 2606, 2607, 2608, 2609, 2610, 2611, 2612, 2613, 2614, 2615, 2616, 2617, 2618, 2619, 2620, 2621, 2622, 2623, 2624, 2625, 2626, 2627, 2628, 2629, 2630, 2631, 2632, 2633, 2634, 2635, 2636, 2637, 2638, 2639, 2640, 2641, 2642, 2643, 2644, 2645, 2646, 2647, 2648, 2649, 2650, 2651, 2652, 2653, 2654, 2655, 2656, 2657, 2658, 2659, 2660, 2661, 2662, 2663, 2664, 2665, 2666, 2667, 2668, 2669, 2670, 2671, 2672, 2673, 2674, 2675, 2676, 2677, 2678, 2679, 2680, 26

Brendshme ndërmorri një iniciativë për të fotografuar vendet më të bukura të vendit e për t'i botuar ato në një album, por iniciativa nuk u çua deri në fund. Megjithatë, iniciativa shërbeu si një pikënisje për të folur gjithnjë e më shumë në zyrat qeveritare e faqet e gazetave të kohës, për rëndësinë që duhet t'i jepej këtij sektori të ri në jetën ekonomike të Shqipërisë.

"Secili shqiptar pra sa do larg qendrave të banojë, lypet ta dijë se ai, i hueji, qi viziton katundin, lagjen e malin e tij, vjen për t'i sjellun një fitim e dobi e se prandaj duhet t'i shërbejë me andje dhe pa pretendue shpërblime të tepërta për shërbime qi mund t'i kërkojë apo sende qi dishiron të blejë".

Kjo ishte një nga thirrjet e para që u drejtohej shqiptarëve në gazetatat e viteve 20-të, duke shënuar hapat e para të filimit të propagandës për sensibilizimin e ardhjes së turistëve në Shqipëri.

PËRSHTYPJA E NJË AMERIKANI PËR TIRANËN!

"Emëri 'kryeqyteti çilimi' i Evropës që gjer njëditzaj e mbante Cetina e Malit të Zi, i bie tani Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë, ku regjentë, bejlerë, ministri, diplomat po përpigën të hedhin themelet e guvernës së shtetit ri, të funmdit që u pranua nga Liga e Kombeve"

Kështu i niste përshtypjet për Shqipërinë një amerikan, i cili i kishte botuar në një prej gazetave amerikane, në maj të vitit 1922.

Ai rrëfen se Tirana digjte vajgur për të ndriçuar shtëpitë. Komunikimi me botën e jashtme nuk ekzistonte me përjashtim të një rruge me qerre që e lidhte me Durrësin. Kishte një shesh të madhe tregu me të cilin mburrej, pesë xhami dhe së fundi një shtëpi të vjetër që e ktheu në hotel me emrin "Hotel International". Pallatet e Qeverisë janë të përhapura nëpër rrugët e ngushta të kryeqytetit, ku dyqanxhinjtë të ftojnë për të blerë mallrat e tyre, të ulur këmbëkryq. Ministrat hynin në zyrat e tyre me shumë solemnitë dhe rëndësi dhe shërbëtorët qëndrojnë në pozicion salutimi kur hyjnë e dalin ministrat. Diplomatët e huaj kanë vetëm një rezidencë legale në Tiranë. Ambasadori i Anglisë jeton në Durrës dhe vjen në Tiranë sa herë ia kërkon puna. Edhe Italia mban një rezidencë diplomatike në Durrës.

Në verën e vitit 1926 gazeta "Dielli" që botohej në Boston filloi t'i kushtonte një vend të veçantë edhe turizmit në Shqipëri, sepse mediat amerikane po shkruanin gjithnjë e më shumë se parashikohej që 500 mijë amerikanë të vizitonin Evropën atëvit.

Por a ekzistonin kushtet në Shqipëri për të

EVROPA PAS LIB

Pas Luftës së Parë Botërore turizmi po kthehej motor gjenerimi të ardhurash për vendet. Në Francë, turizmi sillte të ardhura prej 12 miliardë frangash, që ishte një e katërta e tregtisë së jashtme të këtij vendi. Budapesti, për të tërhequr turistët, ishte kthyer në një çerdhe të madhe për mijëra e mijëra zogj, që këndonin çdo anë. Venecia u mbush me pëllumba. Të gjithë kryeqytetet evropiane patën idetë e tyre për të mbledhur sa më shumë turistë. Në Shqipëri, qeveria ende nuk po tregonte interes për turizmin dhe në shumicën e rasteve tregohej indiferente kur bëhej fjalë për veprime që duheshin ndërmarrë në këtë drejtim.

pritur turistët e huaj? Natyra ishte e bukur, shumica e ditëve ishte plot diell, por mungonte infrastruktura. Në kryeqytet, Tiranë, kishte vetëm një teatër e dy-tre hotele, që ishin shumë pak për të pritur turistët.

Lajm i mirë atë vit ishte ndërtimi i rrugës Durrës – Korçë. *"Që sot e tutje tregëtari i Korçës mund të ngrihet në mëngjes dhe mbrëmjen e asaj dite të ndodhet në Itali. Udha që u-mbarua, përveç që lith qytetin më të madh të Toskërisë me detin lith edhe Shqipërin' e jugës me Shqipërin' e mesme dhe me Shqipërin' e sipërme. Se më përpara, që të vinte korçari në Shkodër, të thomi, duhej ose të vinte me kafshë ose të merte automobilin për në Përmet dhe në Vlorë dhe atje të zinte vaporin për në Shën-Gjin dhe Shkodre"*, shkruhet në editorialin e gazetës "Dielli" në 6 gusht 1926, me titullin "Udhët në Shqipëri".

Përpara këtyre përpjekjeve modeste mediatike, kishte turistë amerikanë që kishin shkruar për udhëtimet e tyre në Shqipëri. Kelly Moderell, shkruante në gazetën e Çikagos "Daily Nees" në janar 1926: *"Shqipëria është një vent kundërshtimesh të çuditëshme. Udhë të hekurta nuk ka, po ka një shërbim me aeroplan që s'bëhet m'i mirë. Udhë s'ka, po ka një sistem telegrafesh të mbaruar. Në shumë raste, ka një mungesë nderi dhe drejtësie në politik që është për të habitur, po m'anën tjetër, në çështje nderi personal ka një nga kodet më të komplikuar dhe më të ashpëra në botë. Një tjetër kundërshtim i çuditshëm është ky: një vent me tokë pjellore dhe me një popull të paktë sipas vendit, dhe të mësuar me një shkallë rojtje të unjtë, ka nevojë të futë ushqime që nga jashtë."*



SHËRBIM AJROR NGA TIRANA NË GJIROKASTËR

Në muajt shkurt-mars 1929, një avion i vogël fluturoi disa herë mbi qytetin e Gjirokastrës në kërkim të një sheshi për të gjetur aerodromin e parë. Kompania "Adria Aero-Lloyd" po shihte mundësinë të hapte linjat ajrore në Shqipëri dhe komandanti Giuseppe Bertocco shkoi në Gjirokastrë në takim me prefektin Zef Kadare. U zgjodh një vend në fushën e Drinit për të ngritur aerodromin e parë.

Itinerari do të ishte:

Tiranë-Vlorë-Gjirokastrë

Tiranë-Korçë-Gjirokastrë

Udhëtimi Vlorë-Gjirokastrë zgjaste 30 minuta, kurse ai Tiranë-Gjirokastrë, 40-45 minuta.

"Shqiptarët tregojnë shumë kurajo në të udhëtuar me aeroplan, gjë që nuk vërehet në disa popuj të tjerë të qytetëruar", shkruante në atë kohë Bertocco.

Ndërsa në Sarandë u zgjodh një fushë në fshatin Vriun për të ngritur aerodromin. Planeti e kompanisë ishin për të lidhur Sarandën me Italinë për të sjellë vizitorët e huaj.

VAPORËT E PARË ME AMERIKANË DHE ITALIANË NË VLORË

Në 1929, për ato pak media që kishte atëkohë, ishte ngjarje e madhe mbërritja në Vlorë e Vaporit "Calgoric" me 350 turistë amerikanë. Në prill të atij viti, korrespondenti i Durrësit i "Gazeta e Re" raportonte se amerikanët do të vizitonin Vlorën e Durrësin, dhe ky ishte numri më i lartë i turistëve, ardhur ndonjëherë në Shqipëri.

"Të huajt, të cilët kanë një pasion të veçantë për turismën, shumë rallë kanë vizituar Shqipërinë dhe arësyeja është pse këtu s'gjenen as komoditetet e duhura, as një popull që t'i kuptojë. Përgjithësisht tallen dhe e quajnë të marrë kur

shohin nonjë të huaj me këpucët me goxhda, me torbën më krahë dhe me një çomange në dorë që vjen prej vëndeve të largëta për të shëtitur në këmbë malet e një vëndi tjetër" ("Gazeta e Re" 23 prill 1929)

Në një tjetër udhëtim, pasdrekën e 19 marsit 1930, pra një vit më vonë vaporit të parë, në Skelë të Vlorës erdhi avullorja e madhe 16 mijë tonëshe e shoqërisë "Ëhite Star Lines". 375 amerikanët në avullore vizituan për 3 orë qytetin e Vlorës, edhe pse, që në muajin korrik 1929, konsulli shqiptar në Boston, George Prifti, i kishte kërkuar shoqërisë turistike "Raymon and Ëitcomb" t'i çonte turistët në Durrës e Tiranë.

Por ata preferuan vetëm Vlorën, madje kërkuar edhe foto për disa nga vendet që do të vizitoheshin në qytet.

375 turistët amerikanë që zbritën në Skelë po shiheshin me shumë kuriozitet nga vendasit. Qoftë për veshjet që kishin, çantat që mbanin, këpucët, apo aksesoret. Qëndruan vetëm pak orë në Vlorë dhe në orën 18.00 avullorja e madhe u largua drejt Kotorrit.

E meqë u hap historia e udhëtimeve me anije, në korrik 1930 në orën 07.00 të mëngjesit, në Skelë mbërriti vaporit "Barion" me dhjetëra turistë italianë. Vizita shkaktoi gjallëri të madhe në rrugët e qytetit, me italianët që ishin më të lirshëm. Ata bënë foto, blenë gjëra tradicionale lokale, madje, shumësyresh, u ngjitën deri në Llogara për të drekuar e u kthyen pasdite në qytet për t'u larguar me të njëjtën anije në orën 17.00, siç raporton media e kohës.

"NUK ISHTE MË TURP TË LAHESHE NË DETI!"

Zakonet konservatore filluan të humbisnin vit pas viti. Në korrik 1930, nuk ishte më turp për asnjë shqiptar dhe, as për një grua shqiptare, që të shkonte në plazh për të marrë rreze dielli e të lahej në det. Si mashkulli dhe gruaja, kishin filluar të kuptonin kotësinë e zakonit të vjetër, turpit për t'u larë e thekur në diell, dhe kërkonin në çdo mënyrë të gëzonin një jetë më të mirë, më njerëzore, më të qytetëruar.

Plazhi i Durrësit, i shtrirë në një gjatësi 7-8 kilometra, me rërë të hollë e të bollshme, konsiderohej prej atyre pak të huajve që e vizitonin, si një nga plazhet më të mira në rajon. Por vetëm plazhi dhe asgjë tjetër. Një i huaj që shkonte në plazh, nuk e gjente një vend për të fjetur. Tregtarët e qytetit të Durrësit, ishin mbledhur për të krijuar një shoqëri, me qëllim ngritjen e një hoteli të madh afër detit, me kushte të përshtashme për turistët.

"Plazha me pak mundime mund të qërohet prej gurrëve të rallë dhe prej plehrave: gjithashtu të detyrohet restoranti për të mbajtur gjellë të paqme se çmimet i ka mjaft të shtrënjta dhe të mos hedhë tërë qelbësirat e plehurat nënë kabinat, se ato nga e nxehta e madhe kalben dhe kundërmojnë" ("Shqipëria e Re" 10 korrik 1930)

QAFSHTAMA

UJI I SHËNETIT

SHKARKO APLIKACIONIN
QAFSHTAMA



DHE BËJ POROSI DIREKT



I VETMI UJË I MBUSHUR NË BURIM NË LARTËSINË 1350 METRA



AUSTRIAKËT DHE GJERMANËT PREFEROJNË ALPET

4 profesorë të nderuar austriakë të sesionit Akademik të Innsbruck-ut, Dr.Haid, Dr.Heinaheimer, Dr.Hoffmann dhe Prof.Dr.Schatz në verën e vitit 1930 erdhën në Shqipëri për të ngjitur malet shqiptare. Shënimet e tyre për vizitën në Alpe po priteshin me shumë interes nga gjermanë e austriakë për të hapur një tjetër linjë turizmi.

Dhe ata ngjiten Majën e Nermajës (2200 m), majën në Jugun e Jezercës (2580 m), Malin e Thatë (2610 m), Malin e Shtogut (2250 m) dhe Malin e Nishkut (2600 m).

Përshkrimin e plotë të udhëtimit e botuan në librin vjetor të shoqërisë alpiniste gjermano-austriake e themeluar qysh në 1774. Libri dilte 250 mijë kopje dhe shitej në gjithë Evropën.

Pati një korrespondencë të plotë nga Vjena në 9 janar 1931 pas botimit të këtyre shënimeve që në përgjithësi ishin shumë vlerësuese për alpet shqiptare. Në këtë moment, shtypi shqiptar filloi presionin për t'u përgatitur një ligj që të mbronte turizmin dhe tu siguronte turistëve një sërë lehtësirash.

Por nuk ishin vetëm të huajt që kërkonin kushte. Aq më tepër që të pakta ishin vendet në botë që kishin Bjeshkë si ato që kishte Malësia e Shqipërisë, si në Reç, Lohë, Rrjollë, Repisht, Llogara, Çajup, Voskopojë e gjetkë. Shqiptarët nuk e dinin këtë gjë asokohe, por të huajt e kishin shumë të qartë.

Shqiptarët dinin se duhet të prisnin turistët e t'u ofronin edhe ndonjë lehtësi. Në 21 korrik 1931 gazeta "Besa" boton lajmin se Paria e maleve Reç, Lohë, Rrjodhë zbritën në Shkodër dhe kërkuar nga qeveria që me punëtorë të detyrueshëm të hapeshin rrugët në drejtim të maleve. Ata i thanë drejtuesve se mund të përfitonin nga bukuria e madhështia e maleve të tyre nëse vizitoheshin nga të huajt.

Interesi po rritej, por infrastruktura ishte skandaloze. Mungonte zyra turistike, hotelet e përshtatshme. Në hotelet ekzistuese nuk kishte njerëzit e duhur, nga pastruesit e shërbyesit në dhoma tek kuzhinierët. Turistëve duhet t'u garantohej udhëtimi e jeta, por edhe për qarkullimin në rrugë nuk kishte rregullore, sepse, nuk kishte as shumë makina në fakt.

Në 12 shkurt 1931 filloi për iniciativën e parë ligjore për Turizmin, ku deputeti i Durrësit, Stavro Stavri kërkoi që qeveria të përfshinte në buxhet edhe politikën e zhvillimit të turizmit. Sipas deputetit, duhet të krijohet zyra për turizmin, zbulimi i disa vendeve

turistike që pëlqeshin nga të huajt, që nga vendet romantike deri tek ato historike ku zbulimet në Butrint, Apoloni, Kalaja e Beratit, Kruja, Rozafa etj, ishin interesante për të huajt.

Në buxhetin e vitit 1931 për herë të parë përfshihet edhe zëri i shpenzimeve dhe fondeve për Turizmin.

Në maj të vitit 1931, Qeveria vendosi që të krijojë një komision për të studiuar ligjet dhe rregulloret ndërkombëtare mbi turizmin, me qëllim që të fillonte realizimi i tyre dhe në Shqipëri. Të huajt që e kishin vizituar vendin kishin dalluar vlera të mëdha turistike, duke shprehur besimin se nëse Shqipëria do të njihej më mirë e më shumë dhe do të tërhiqte një numër të madh turistësh.

PROPAGANDA E TË HUAJVE PËR SHQIPËRINË

Në një revistë të përjavshme që botohej në Gjermani, në mars të vitit 1933, piktori dhe alpinisti i njohur Dr.Egmon Hofmann botoi instruksionet mbi Alpet shqiptare. Ai shkruan për bukurinë magjepëse të maleve shqiptare dhe i kushton vend të rëndësishëm mikpritjes që gjejnë turistët në Shqipëri.

"Mirëpritja të prek në mënyrë testamentare dhe prandaj mirëpritja shqiptare është bërë proverbiale", e mbyll artikullin Dr. Hofmann duke shtuar se nuk do të jetë e largët dita kur Mbretëria Shqiptare do të jetë një vend udhëtimi si Dalmavia dhe Greqia.

Gjeologu i njohur për kohën Dr.Erost Noëeck, po në mars 1933 mbajti një konferencë me interes për Shqipërinë, me temë: "Si gjeolog në Shqipëri".

"Po, ja, kjo është gjëja më tërheqëse në Shqipëri, që ia kalon edhe Greqisë, që në një kohë fare të shkurtër, arrijmë prej fushave të bukura e të këndshme, në të cilat çelët tërë shkëlqimi i lulëzimit të mesdetit, në ngatërresën më të madhe të shkëmbinjëve, në luginmat plot me ujë buçitës, në fillërimin më të madh të malit", ishte shprehja me të cilën mbylli dhe fjalën e tij gjeologu.

Të huajt që po vizitonin vendin,





jo vetëm ishin larguar me përshtypjet e tyre më të mira, por ishin angazhuar edhe në botime artikujsh, apo organizime konferencash në vendet nga vinin. Ata bënë thirrje që njerëzit në vendet e tyre të vizitonin Shqipërinë se do të mbeteshin të kënaqur nga bukuria e maleve, detit, por edhe gjetjeve arkeologjike. Të huajt që propagandonin bukuritë e vendit të vogël të Ballkanit, kishin treguar interes pranë Legatave shqiptare në shtet e tyre për krijimin e një Zyre turistike, e cila do të krijonte lidhje me organizata ndërkombëtare për çdo informatë apo ndihmë përsa i përket zhvillimit të turizmit.

PO KRYEQYTETI? JETA E NATËS E PLLAKAT E GRAMAFONIT

Në verën e vitit 1931 kishin filluar shenjat e para të jetës në Tiranë dhe në disa qytete të tjera të

vendit. Të rinjtë shqiptarë, ndryshe nga paraardhësit e tyre që shkonin në shtëpi pa rënë ende dielli, kishin filluar të qëndronin më shumë jashtë shtëpisë gjatë orëve të natës.

Po cila ishte jeta e natës?

Ata meshkuj që kishin filluar të bënin një jetë të tillë zgjidhnin një kafene, ku në orën 23.00 fillonte "vallja" dhe deri sa të vinte kjo orë, pinin raki me meze të ndryshme. Në orën e lajmëruar për fillimin e "valles", në lokal duken disa vajza kërcimtare, të cilat ishin të gatshme për dëfrim. Ato ishin të huaja dhe nuk kishin komplekse të vajzave shqiptare. Këtu nis dhe ajo që quhet "jeta e natës". Burrat në lokal porosisin për to shampanja dhe pas disa gotave i ftonin për vallëzim. Në agim të ditës së re, burrat ktheheshin në shtëpi të lodhur nga gjunjë e xhepi. Dikë e priste gruaja e dikë tjetër nëna. Natën tjetër, kërcimtarët shkonin në një lokal tjetër dhe përsëritej e njëjta histori.

Për të përmirësuar imazhin e vendit në sytë e turistëve, në verën e vitit 1931, disa prefektura nxorën udhëzime të posaçme ku ndalohej përdorimi i pllakave të gramafonit me muzikë turke.

Ky veprim për shumë qytetarë u konsiderua si i drejtë, në kushtet kur në shumicën e lokaleve të kohës, nëpër qytetet e vendit, dëgjoheshin shumë këngë turke. Ato duhet të zëvendësoheshin me muzikë evropiane. Ankesat për muzikën turke kishin ardhur nga të huajt që vizitonin vendin, duke krijuar një imazh të keq edhe për shkak traditës e pushtimit pesëshekullor nga Turqia.

Por, përsëri ishte e vështirë që shqiptarët të mësoheshin me një urdhër të tillë.

"Se është e pa mundur që, me një urdhër, ta bësh shqiptarin të heqi dorë prej valles me shami për të kërcyer tango vetëm me një urdhër; aq edhe ca më shumë është e pa mundur që ta bësh mbrenda në një javë t'i pëlqejë muzika oksidentale. Cili autoritet do të munda të ndërhyjë në dëfrimin e një private duk'e detyruar atë të dëgjojë Traviatën në vend të një kënge turke apo greke?", shkruhet në gazetën e kohës.

JO VETËM ANIJET, DHE JAHTET VIJNË NË SHQIPËRI

Po ecej shpejt me turistët që donin të vizitonin vendin, dhe shumë ngadalë me masat që duhet të ndërmerreshin nga autoritetet për të krijuar lehtësira për ta. Nuk po vinin turistë të thjeshtë, por edhe princër, zyrtarë, akademikë. Pasi kishin ardhur me anije, me avionë, Shqipëria po fillonte të vizitohej nga jahtet.

Në 8 shtator 1935, në gazetën "Besa" shkruhet se me jahtin grek "Kyma", zbritën në Durrës dy Princa Francezë dhe princesha De Potiguae, Konti e Kontesha Rongemont; pronari i revistës

Për të përmirësuar imazhin e vendit në sytë e turistëve, në verën e vitit 1931, disa prefektura nxorën udhëzime të posaçme ku ndalohej përdorimi i pllakave të gramafonit me muzikë turke

4 TË RINJ ANGLEZ PËR 32 DITË NË SHQIPËRI!

Në vjeshtën e vitit 1923, katër të rinj anglez vizituan disa zona të Shqipërisë për më shumë se 32 ditë. U nisën nga Shkodra më 27 shtator me dy kuaj dhe udhëtuan përmes viseve të Shoshit e të Shalës. Kaluan mandej Drinin për në Palcë, Mirditë, Peshkopi, Pogradec, Korçë, Berat dhe Elbasan. Udhëtimin e tyre e përshkruan në një letër drejtuar autoriteteve dhe gazetave të ndryshme në Britani. Ata shkruanin për kënaqësinë që provuan në vendet e vizituara dhe mikpritjen që gjetën. Udhëtimi i të rinjve anglezë u bëri përshtypje shqiptarëve që filluan të kuptojnë se vendet që i shihnin përditë e ku ishin rritur e nuk u bënin shumë përshtypje, ishin të bukura për të huajt.



franceze "Miror du Monde" zoti Dupuy me zonjën e tij, si dhe pronari i shoqërisë së automobilave "Renault" Zenka d'Alnois shoqëruar nga zonja e tij.

Ata kishin udhëtuar me yaht nga Franca drejt Greqisë, më pas në Shqipëri dhe do të vijonin udhëtimin Serbi, Venetik, prej ku do të ktheheshin me tren për në Paris. Ata shëtitën Durrësin e Tiranën, duke krijuar përshtypje të mira për vendet që panë.

Por, ky nuk ishte jahti i vetëm që kishte ardhur në Durrës.

Në datën 5 shtator kishte ardhur nga Vlora jahti francez "Franik", njerëzit e të cilit kanë shfaqur dëshirën për të vizituar Krujën.

Javën e parë të shtatorit e kishin vizituar Durrësin edhe jahtet "Fair Lady" dhe "Jean Mic", që të dy me turistë francezë.

Ndërkaq me vaporin "Dubrovnik", në datën 4 shtator, erdhën për të vizituar Shqipërinë edhe gazetari hollandez Louis Aletrino i gazetës "Nieuwe Rotterdamse Courant" si edhe Drejtori i Seksionit të Propagandës së Zyrës turistike të Çekosllovakisë.

Të gjithë këta të huaj, padyshim që do të flisnin e shkruanin për Shqipërinë, duke e bërë të njohur edhe për të tjerët. Me të mirat e të këqijat e një shteti në zhvillim e sipër.

Në gazetën "Besa" të 5 Nëntorit 1935 raportohet për një broshurë të vogël që u botua në Londër nga Edëin Cripëell, konsull nderi i Shqipërisë atje. "Ç'i jep Shqipëria turistit", ishte titulli i saj dhe fillon me një përshkrim mbi historinë romantike të Shqipërisë, për të vazhduar me zakonet e vendet e bukura, ku përmend shijen piktoreske të maleve të Veriut, ku turisti shëtitës gjen të gjitha ato që i duhen. Autori tregon se automobili mund të shkojë në çdo qytet të vendit, por shton se udhëtimi me tren nuk është aq i pëlqyeshëm, pasi nuk mund të shijosh bukuritë ashtu si i shijon me makinë. Broshura flet edhe për pasuritë arkeologjike që ndodhen në tokën shqiptare ku janë gjetur edhe gjenden përditë sende të vjetra që tregojnë lashtësinë e këtij vendi.

TURIZMI SHQIPTAR "Niset" PANAIREVE EVROPIANE

E kur anijet, avionët, jahtet zbuluan Shqipërinë; në momentin që profesorë, doktorë, shkrimtarë, gazetarë filluan të mbushnin vendet evropiane me përshtypjet e tyre për udhëtimet në Shqipëri, vjen momenti që të prezantohej zyrtarisht Shqipëria



nëpër panairë turistike evropiane.

Përpjekja e parë u bë në Panairin e Barit dhe Selanikut. Pas dy tentativave modeste, autoritetet guxuan për të shkuar në zemër të Evropës, në Francë, me një stendë të veçantë në Panairin e Parisit në shtator 1937. Busti i Mbretit Zog dhe busti i Skënderbeut; kostume karakteristike të popullsisë e krahinave të ndryshme të vendit; qilima tradicionale e rroba të qëndisura, ishin disa nga sendet e ekspozuara në këtë panair me famë të madhe ndërkombëtare për kohën.

"Duke dalë prej sallorit, përshkajmë seksionin e turizmit ku disa fotografi na tregojnë interesin e vërtetë turistik që paraqet Shqipëria e sotme. Vënde me një bukuri të kulluar e të egër, fortesa dhe pallate të lëna në gjendjen ku i solli koha dhe ndodhinat, kostume të mbathura edhe sot prej katundarëve të vëndit, gjahu i shumtë dhe i famshëm, ftojnë turistat të vizitojnë një vënd të kohës bizantine po njëkohësisht edhe një vënd të kohës moderne ku gjendet gjithë komforti i sotshëm". ("Gazeta e Korçës", tetor 1937)

Bashkë me gjithë këto, ajo zyrë turizmi krijuar që në fillim të viteve '30, po krijonte edhe bazën e të dhënave për turizmin. Në statistikën e Entit kombëtar të Turizmit të janarit 1938, shkruhet se në vitin 1937 numri i turistëve të huaj që kishin hyrë në Shqipëri ishte 7000. Një shifër e lartë për mundësitë që kishte vendi në atë kohë për të pritur turistët, pasi, duke filluar nga kryeqyteti e deri në fshatra të largëta, kishte mungesa për akomodimin e tyre. Tirana, në vend që të kishte 3-4 hotele me kushte të përshatshme, paraqitej në fillim të 1937 me hotel "International" me dhoma të ngushta. Ndërkohë që hoteli "Kontinental" që ishte luks për kohën, nuk ishte i përshtatshëm për turistët që kishin përlllogaritur gjithë shpenzimet, për shkak të shtrenjtësisë.

Por, veç mungesës së akomodimit, kishte ankesa për sjelljen e papërshtatshme të njerezve që punonin në to, në kontakt me turistët e huaj.

"Sjellja e hotelxhinjvet t'onë, mandej, duhet të zbutet pakëz nga shkalla e moskujdesjes për randësin' e njeriut që gjendet pranë: se asht një nga kanunet themelore të tillë tregëtirash që çdo klient të pritët mirë, të mbahet mirë dhe të bindet se prej tij i zoti i vëndit ka mbetun i kënaqun dhe anasjelltas."

Të tilla konstatime dhe këshilla i gjeje gjithnjë e më shpesh në gazetën e kohës, për vet realitetin që ekzistonte ndër hotelet modeste

shqiptare. Sjellja e vrazhdët dhe nxitimi për të përfituar më shumë nga një i huaj që i vjen në hotel, sesa nga një vendas, ishin dy nga problematikat të cilat krijonin vështirësi në menaxhimin e të huajve që vinin në Shqipëri e në disa raste lëviznin të pashoqëruar në qytete të ndryshme të vendit.

KRIKAT E GAZETAVE

Në mesin e viteve 30-të, gazetën shqiptare i shtuan artikujt në lidhje me turizmin në vend. Ato botonin jo vetëm lajme për turistë të ardhur në qytete të ndryshme të vendit, por edhe kritikonin problematikat e shfaqura dhe masat që duheshin marrë për të krijuar kushte sa më të përshtatshme për një turizëm sa më cilësor.

Në një nga numrat e muajit shkurt të vitit 1938, të gazetës "Drita", në një reportazh të përgatitur nga Vlora, me autor "Panxha" evidentoheshin edhe problematikat e turizmit të këtij qyteti bregdetar. Një nga shkaqet që Vlora po mbetej e pazbukuruar, kryesisht në zonën e Skelës e cila ishte afër detit, ishte mungesa e një plani për ndërtimet e reja në këtë zonë të qytetit. Në Vlorë do të ishte derdhur një numër i madh

njerëzish për banim në Skelë, nëse aty do të ishin ndërtuar godina të reja e të larta.

"Një rëndësi e posaçme duhet t'i jepet edhe plazhit të saj. Është një nga plazhet e mira që mund të bëhet. Të më lejohet t'ia quaj neglizhencë bashkisë mbetjen e atij plazhi të pa shfrytëzuar gjer sot. Bashkia duhet të caktojë fonde për ndërtimin e plazhit dhe për reklamimin që të tërheq turistë, derisa të mos i reklamojë nuk mund t'i jepet rëndësi prej një të huaji që nuk i ka takuar të njohë të vendosë për kalimin e muajve

Vlorën,

të nxehta", shkruhet në shtypin e kohës.

Inagurimi i Muzeut kombëtar, në vitin 1936, ishte një ngjarje e rëndësishme për historinë e kulturën shqiptare. Muzeumi u hap në skelë të vlorës e pikërisht në mesin e vitit 1936, qenë gjatë vitit 1913 seli e qeverisë së Vlorës, e krijuar pas shpalljes së Pavarësisë. Ngritja e muzeut në këtë vend sillte si domosdoshmëri edhe ndërtimin e një hoteli të përshtatshëm për të pritur turistët e huaj që do të ishin për të parë objektet e këtij muzeu, i cili ishte i pasur me gjetje të ndryshme arkeologjike.

"Hoteli në fjalë, pot ë jet' ashtu si ç'duhet, e bën shumë të mundur që turistët të tërhiqen ma lehtëzi mbasi në këtë mënyrë do të jenë ma të sigurtë për komoditetin e tyre të cilin e mbajnë për gjë kryesore e kështu mund t'i siguronet Vlorës një t'ardhur ndofta edhe shumë të mirë" (gazeta "Arbëria" nëntor 1936)



SHQIPËRIA PA ASNJË gramar

KUSH E GRABITI FLORIRIN?!

| Nga ERALD KAPRI

Zyrtarisht, Shqipëria është vendi më i varfër në Europë në depozitat e arit në Bankën e Shqipërisë. Posedimi i arit është një prestigj për kombet si dhe një mundësi për të treguar pasurinë dhe për të rritur rezervën valutore. Ndërsa Shqipëria ka një rezervë valutore prej 4 miliardë eurosh, në flori është pothuaj minimale. Sot, Banka e Shqipërisë deklaroi se ka vetëm 2.5 ton rezervë valutore në ar. Nga të cilat, rreth 2.338 kilogram i Shqipërisë ose 2.33 ton ar ndodhet në Londër prej 80 vitesh. Me pak fjalë, Shqipëria që ka pasur tonelata në ar, sot ka vetëm thërrime. Ku u zhduk ari shqiptar?


Një fakt i njohur është se Shqipëria ka qenë një vend i pasur në ar. Para luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri kanë qarkulluar lirshëm qindra ton ar si formë pagese dhe ruajtje pasurie si forma më e besuar e shqiptarëve.

Në vitet 20, një inspektim i Lidhjes së Kombeve, zbuloi se në Shqipërinë e varfër qarkullonin disa dhjetëra lloj monedhash ari si formë pagese dhe besohej se në Shqipëri ndodhej një sasi prej 320 tonësh ar në duart e popullsisë. Ky inspektim e bënte të favorshëm krijimin e një banke kombëtare e cila do të garantonte një monedhë kombëtare në



standardin e arit.

Në vitin 1925, u arrit krijimi i Bankës Kombëtare Shqiptare me kapital të përbashkët shqiptaro-italian, ku shqiptarët kishin afërsisht 49 % të kuotave dhe italianët 51 %, duke u lënë atyre manaxhimin e përgjithshëm të bankës. Me këtë rast, u krijua monedha shqiptare Lek e cila garantohej në ar. Ende sot, shqiptarët kanë memorizuar se si në vitet para luftës, leku ishte më i fortë se ari, si një mënyrë për mbledhjen e tij. Gjithsesi, Banka e Shqipërisë nuk arriti të krijojë ndonjë rezervë të konsiderueshme në ar por arriti të krijojë likuiditet dhe një



situatë ekonomike të favorshme për tregti.

Pushtimi i Shqipërisë nga Italia, largoi Mbretin Zog nga Shqipëria. Ai mori me vete një sasi të vogël ari që njëhej si llogaria mbretërore me rreth 180 kilogram flori, ose me një vlerë prej 1.5 milionë eurosh me të sotmet. Ndonëse në Bankën e Shtetit kishte mbi 2 ton ar, Zogu e kishte të pamundur ta merrte edhe sikur të donte, për shkak të rregullave dhe më e rëndësishmja, ari shqiptar ruhej në Romë.

Madje, një llogari bankare prej 1 mijë monedhash ari e Mbretëreshës Geraldinë, nuk u arrit të merrej, pikërisht për shkak të procedurave. Me pak fjalë, kur Zogu u largua nga Shqipëria i la vendit një depozitë bankare prej 2.5 ton ar.

Por kjo sasi ari në Romë, ka një histori të veçantë mbijetese. Ai është grabitur disa herë nga vende të ndryshme, është pretenduar nga disa vende të tjera, por më në fund u arrit të rimerrret nga Shqipëria. Më interesante është fakti që ky ar është nuk ka mbërritur ende në Shqipëri por ndodhet në një depozitë sigurie në Bankën Kombëtare të Anglisë.

Pas kapitullimit të Italisë në vitin 1943, gjermanët e morën arin shqiptar që ndodhej në Romë dhe e zhvendosën në Berlin. Dokumentet e zbuluara së fundmi në arkivin britanik, tregojnë se bëhej fjalë për 45 arka metalike që brenda kishin vetëm monedha të arta, kryesisht napolona ari. Gjermanët gjetën saktësisht 2 338.75 kg ar. Dokumentet kanë zbuluar se ari shqiptar është transportuar në fshehtësi të plotë nga një grup i besuar oficerësh SS me në krye majorin gjerman Herbert Kappler, i shoqëruar nga diplomari gjerman në Romë Joseph Ortmann. Transporti u bë me kamionë dhe u depozituan në Reichsbank.

Qeveria shqiptare me në krye regjencën e Mehdi Frashërit i kërkuan llogari gjermanëve për marrjen e arit dhe në 6 prill 1944, u nënshkrua një protokoll sekret ku u garantua se ari të mbetej i Shqipërisë por të ruhej nga gjermanët. Një tjetër fakt i njohur është që gjermanët morën një sasi prej 20.000 copë napolona ari në Tiranë kur u larguan në nëntor 1944, një peshë prej 116.118 kg ar, dhe për këtë sasi nuk pati asnjëherë një marrëveshje dypalëshe.

Fati e deshi që gjermanët të lajmëronin britanikët më së pari, pasi Berlini u pushtua nga sovjetikët, për këtë pasuri në ar dhe me një operacion tjetër sekret, në vitin 1945, ari

shqiptar u transportua me avion në Londër, nga ku ruhet ende sot.

Por ishin shumë vende që kishin pretendime ndaj pasurive të grabitura nga gjermanët dhe që ishin konfiskuar tashmë nga britanikët. Për këtë çështje, u ngrit një Komision Trepalësh nga forcat aleate dhe me amerikanët, për të bërë ndarjen e këtyre pasurive të grabitura.

Por ari shqiptar u bllokua nga britanikët në vitin 1946, pas incidentit në Kanalin e Korfuzit ku dy luftanije britanike ranë në mina. Britanikët arritën të fitojnë gjyqin ndërkombëtar dhe pretendonin dëmshpërblim prej 800 mijë paundësh në atë kohë. Arin shqiptar e vlerësoi në masën prej 600 mijë paundësh, dhe në kushtet kur Shqipëria nuk pranonte përgjegjësinë e incidentit, britanikët nuk e lëshuan arin.

Por mbi arin shqiptar prej 2.3 tonësh, pati pretendim Italia e cila kërkonte gjysmën e tij. Do ishte falë këmbënguljes së amerikanëve, që ari shqiptar të mos prekej, deri pas shëmbjes së komunizmit. Më pas, në vitin 1993, qeveria shqiptare dhe ajo britanike rinisën negociatat dhe pasi Shqipëria pranoi përgjegjësinë e saj, Britanikët lëshuan arin shqiptar.

Por prej asaj dite, kjo sasi prej 2.338.75 kg ar ruhet ende në Bankën e Anglisë, ndonëse në pronësi të Shtetit Shqiptar. Arsyeja është e thjeshtë; transporti i tij kërkon një shumë të madhe duke përfshirë edhe sigurimin e udhëtimit, ç'ka është një shumë e konsiderueshme. Për këtë arsye, është lënë të ruhet në Bankën e Anglisë, duke krijuar më shumë siguri për

arin shqiptar duke marrë parasysh që ai pak ar që ndodhej në vendin tonë u grabit në Krrabë në fundin e viteve 90.

Por, fakti më ironik është se Shqipëria ka vetëm këtë pasuri në ar, ndërkohë që dokumentet e shumta tregojnë se ari ka qenë me tepriçë në Shqipëri.

Pas ardhjes së komunizmit, dhjetëra ton ar iu konfiskuan me dhunë familjeve të pasura shqiptare. Deri në vitin 1946 nuk ka të dhëna të sakta se sa ar u grabit nga komunistët, por më pas në dokumentet e ministrisë së Brendshme bëhet e ditur se janë 43.816.682 monedha të arta të grabitura nga komunistët që përbëjnë në total mbi 280 ton ar.


Në kohën e sotme, kjo sasi i kalon vlerën e 15 miliardë eurove. Por më interesant është fakti që komunistët kanë futur në llogari të shtetit shqiptar vetëm 3 ton ar, dhe për pjesën tjetër nuk ka asnjë hetim se ku shtoi dhe se si u shpenzua nga shteti komunist.

Një tjetër fakt i njohur është se në llogaritë e shtetit komunist janë shpenzuar mbi 7 ton ar për blerje të ndryshme. Po ashtu, një sasi e konsiderueshme ari është humbur në kurs këmbimi nga komunistët.

Gjatë viteve të diktaturës, një sasi ari është nxjerrë edhe nga miniera e Rubikut.

Por në përfundim të komunizmit, Shqipëria ishte e zhveshur nga pasuria në ar. Në gjithë k e t o vite tranzicion, nuk u krijuar pasuri në ar për rezervën valutore. Kështu, Shqipëria ka të njëjtën pasuri në ar që la Mbreti Zog 80 vite më parë dhe asnjë gram më tepër.

Në gjithë këto vite, askush nuk hetoi apo kërkoi shpjegim se ku u zhduk ari shqiptar në kohën e diktaturës ndërkohë familjet e grabitura nga pasuria në ar presin ende kompensim.





MIELLI ASSOS



MIELLI I PARË SHQIPTAR BIO





Feja e Shqiptarit është Shqiptaria. Është një nga thëniet më krenare që trumbetojmë shpesh. Këto festa të pranverës që kaluam treguan sërish këtë. Ne festuam të gjithë bashkë, por fijet me agjenturat e huaja apo me politikën kanë qenë për një kohë të gjatë prezente edhe në rrugën e klerit në vendin tonë



KLERIKË SI AGJENTË E TË SPIUNUAR

| Nga LUELA MYFTARI

Skandalet e kishave janë bërë filma, radikalizmi që vret po ashtu mbush revistat, gazetat, median online. Ana e errët e klerit gjithmonë ka qenë joshëse për të kuptuar këtë lloj pushteti që nuk mjafton ndonjëherë të jetë vetëm shpirtëror. Rrallë në Shqipëri ndodh që të kemi të bëjmë me të tilla vepra, sepse ne jemi vendi ku klerikët ecin si një pushtet i vetëm krah për krah në Paris, për t'i treguar botës që në emër të jetës jemi të gjithë bashkë; ku burri mysliman feston Krishlindjen me të shoqen ortodokse e ku fëmijët gatuajnë kurbanin për të uruar gjyshen. Ne jemi vendi ku sot turistët

vendosin të zgjedhin turin e bashkëjetesës fetare, në vendet ku kisha dhe xhamia qëndrojnë përballë e ku këmbana i lë vendin jehonës së zërit që vjen nga xhamia përballë. Sepse ne jemi vendi ku një statujë e madhe e Shën Terezës qëndron pranë xhamisë në Shkodër dhe ku të huajt bëjnë foto me qetësinë dhe tolerancën që reflekton ky vend. Por, nuk ka qenë gjithnjë kështu dhe këtë mendoja teksa lexoja "Raportet e shtetit shqiptar dhe klerit", një histori politike të shkruar nga Denald Prifti. Në këtë

libër rrëfohen disa nga lidhjet politike të klerëve me pushtetarët e vendit, por edhe me agjunkturën e huaj, procesi i asgjësimit të fesë gjatë komunizmit, por edhe dëshmi interesante që Dr. Denald Prifti i ka mbledhur për këtë botim. Pyetja e parë që më josh mua është lidhja e mbiemrit të tij me temën. Sepse Prifti jo vetëm që vjen nga një familje ku besimi mbyllet me derën e shtëpisë, por edhe nga një familje të persekutuarish në emër të besimit.

A ke pasur ndonjëherë frikë se gjatë këtij studimi do përfshiheshe emocionalisht, do mbaje anësi duke qenë se rrënjët familjare të dërgojnë diku do të të përfshinin të tjerët në debate?

Pavarësisht nga përfshirja emocionale, historiani

ka detyrë të përballet me faktet dhe t'i pasqyrojë ato paanësisht. Jam përpjekur të bëj këtë, pra pa u përfshirë nga historia ime familjare. Por ndërkohë, në Shqipëri është ende tabu të flasësh për këto tematika, duke kujtuar se me diskutimin e tyre ne mund të prishemi me aleatët apo çënojmë komunitetet fetare, duke ditur se një pjesë e madhe e klerikëve të rënë gjatë viteve të komunizmit, por edhe atyre të arrestuar janë shpallur martirë dhe përlavdëruar nga shteti shqiptar dhe nga organizma të ndryshëm.

Ke mbi 1000 materiale të shënuara si bibliografi. Sa kohë të ka marrë ky punim?

Ky botim është studimi im i Doktoraturës në fushën e historisë dhe besoj ashtu sikurse shpresoj se është një vlerë e shtuar në lëmin e kësaj fushe duke e renditur këtë botim të vetmin studim që prek të katër komunitetet fetare shqiptare, por edhe i parë në një optikë totalisht të re, atë të marrëdhënieve të shtetit karshi komuniteteve fetare në vitet 1944-1967. Ky studim është fryti i një pune kërkimore prej 8 vitesh, ku besoj se informacioni i pasur dhe referencat përkatëse, besoj se është një vlerë më shumë si për studiuesit e fushës, por edhe lexuesit dhe politikën. Të ndërmarrësh një hap për të kryer një studim të mirë shkencor kërkohet një buxhet i mirë. Bëhet edhe më e vështirë sidomos kur nuk je pjesë e një instituti apo departamenti ku ke hapësira dhe marrëveshje akademike, por edhe njohje që mund të gëzosh.

Vazhdon të kesh ende kërshtëri për këtë temë?

Po, edhe studimi im është i paplotë pasi ende sot nuk disponojmë shtypin e emigracionit shqiptar në egzil, por edhe dokumente të cilat lidhen me punën e agjenturës të kryer në territorin shqiptar nga shtete si Franca, Serbia, Italia, Vatikani, Greqia, Britania e SHBA, duke ditur që këto shtete kanë pasur

EMRAT SIPAS BESIMIT FETAR

Është një traditë ndoshta unike tipike shqiptare fakti që vite më parë, por dhe aktualisht, kur një çifti nuk i jetojnë fëmijët, atëherë fëmijët që ju lindin më pas ju vënë një emër të besimit tjetër nga janë vetë. Për shembull të krishterët i vënë emër mysliman, apo myslimanët i vënë fëmijës një emër të besimit të krishterë. Për arsien e fëmijëve, familjet shqiptare edhe martesat i bënin mes personave me besime të ndryshme fetare. Sot, nuk është e pazakontë në Shqipëri që anëtarë të së njëjtës familje të kenë besime të ndryshme dhe të kremtojnë së bashku festat e tyre.

marrëdhënie klandestiniteti të zhvilluara në vendin tonë. Nga kjo analizë nuk duhen përjashtuar edhe shtetet e lindjes, të cilat edhe ato kanë zhvilluar, si shtetet perëndimore, marrëdhënie klandestiniteti këtu.

Sot do të na zbulosh disa nga ngjarjet më intriguese besoj dhe dua ta nisim që nga fijet e klerit me të huajt, me agjenturën e ngjarje që kanë ende mister brenda.

Po, kryesisht klerikët katolikë janë akuzuar se i kanë shërbyer fashizmit Italian. Ky nuk është një qëndrim fort korrekt pasi nuk mund të përgjithësojmë gjithë klerin nën një qëndrim të vetëm edhe pse në deponime apo në shtypin e kohës një pjesë prej tyre pushtimin fashist e kanë pritur me ovacione.

KUR KLERI MERREJ ME AGJENTURËN

Gjatë 200 viteve të fundit, toleranca fetare është pozicionuar në një mjedis të komplikuar kulturor dhe politik, të formuar, ndër të tjerash, nga rrënimi i Perandorisë Osmane dhe lindja e nacionalizmit shqiptar, pra Rilindja, e më pas vjen krijimi i shtetit laik shqiptar dhe procesi i asgjësimit të fesë nga komunizmi. Sot, edhe ndryshimet apo zhvendosjet e sjella nga





SA OBJEKTE PRISHI ENVER HOXHA?

Raporti informativ jep me shifra dhe detajon gjithë aksionin për shkatërrimin e objekteve fetare në Shqipëri dhe luftën e hapur kundër besimeve fetare. Ky numër arrin gjithsej në 2169, nga të cilat 740 xhami, 608 kisha ortodokse e manastire, 157 katolike, 530 teqe dhe tyrbe, të gjitha të shkatërruara gjatë aksionit të sundimit diktatorial të Enver Hoxhës.



proceset e modernizimit me siguri kanë fijet e veta, shpesh të padukshme të lidhjes së klerit shqiptar me Papatin, me Ortodoksinë greke apo me Turqinë e Erdoganit. Por, këto lidhje të sotmet do t'i tregojë më vonë historia dhe arkivat që do të disponojmë. Sot, dua të pyes Dr. Denald Priftin për lidhjen e klerit në Shqipëri me botën jashtë, e sigurisht një nga pyetjet më interesante është edhe lidhja me agjenturën e huaj.

Lufta ka ndikuar ngado, ndikon edhe sot. Fashizmi e nazizmi kanë dashur të ndikojnë padiskutim edhe te kleri në vendin tonë? Na zbulon ndonjë ngjarje apo dokumentim të asaj kohe?

Dom Lazër Shantoja shkruan se “Për ata që nuk janë fashista, konopi është i lirë”. Po, nëse kemi kryesisht klerikët katolikë janë akuzuar se i kanë shërbyer fashizmit Italian dua të tregoj se edhe figura të komunitetit mysliman iu përqaasën po kaq shpejt ideologjisë fashiste. Kryetari i myslimanëve shqiptarë Shapati u deklarua në favor të Italisë më 19 prill 1939, ku ndër të tjera deklaronte se: “në cilësinë time si kryetar i Bashkësisë Myslimane Shqipëtare jam i gëzuar që mund të pohoj se të gjithë muhamedanët shqiptarë e kanë pritur me entuziazëm të madh çlirimin e Atdheut, që u arrit për meritën e Italisë fashiste. Ne e dimë se kudo që valon tringjyrëshi Italian, myslimanët jetojnë të lirë e të mbrojtur në kultin e tyre me privilegje e të drejta të barabarta me ato të vëllezërve të tyre italianë. Prandaj vërtetojmë gjithë besnikërinë tonë ndaj mbretit të ri të Shqipërisë Viktor Emanueli III, ashtu si edhe mirënjohjen tonë për Duçen, shpëtimtar i vendit tonë”. Në qarkoren e datës 18.11.1939, kryetari i Komitetit Mysliman, Shapati theksonte se programi i fashizmit është i njëjtë me programin që ndjek islamizma. E ndërkohë që anëtarë të këtyre dy komuniteteve propagandonin fashizmin më 28 nëntor 1941 kryegjyshi Salih Niazi Dedej i komunitetit bektashi u vra bashkë me dervishin Aziz Levani dhe vdekja e tyre është mister edhe sot.

Ka pasur edhe nga ata klerë që nuk kanë mbështetur Luftën Nacional Çlirimtare?

Në revistën “Hylli i Dritës”, shkruet se: “Ushtarët e Romës shkllasin në tokën e Ilirëve për me u ngjitë dorën, për me i pagëzue në emër të miqësisë shekullore, vllazen, shqiptarët kanë hi nënë hije të një flamuri të ri, kanë hi nënë mprojtje të një mbreti me zemër”. Në gazetën “Tomori”, Dom Lazër Shantoja deklaronte: “Këtu nuk ka dhe nuk ka me pasë tjetër përveç një Shqipni fashiste. Asht tradhtar ai që në një kohë të tillë përhap lajme kushtrimore. Duhet dijtë se kush nuk lufton për një Shqypni fashiste, andron e pret Shqipni të tjera, ai ban sot veprën e Judes”. At Bernardin Palaj, në gusht të vitit 1941 shkruan se “Kush nuk shkruhet milic, ay është kundër fesë sonë, është bolshevik” (“Koha e re”).

Në këto kushte, ka pasur edhe klerë që kanë bashkëpunuar me agjenturën e huaj, besoj...

Patër Anton Arapi akuzohet për lidhjet me Gjermaninë dhe Italinë. Është një dokument tërësisht interesant, i cili tregon se pas kapitullimit italian



PJESË E  KASTRATI GROUP

ALBSIG MED



PËRFITONI:

20% – 35%

ulje në analiza & vizita mjekësore

10%

ulje në ndërhyrje kirurgjikale

Vlefshmëria 1 Vit

MË SKANO



 +355 (0) 42254770 / 764
 info@albsig.al
 www.albsig.al



më 2 qershor 1944, i ngarkuari i Rejhsfjhrerit në Shqipëri, i dërgon një shkresë Patër Anton Harapit, ku ndër të tjera i shkruan: “Prej disa muajsh më kanë ardhur informacione nga anë të ndryshme që oficerët italianë të çarmatosur nga Vermahti, të cilët i përkisnin regjimit të Badolios, fshihen nga Jezuitët. Duke marrë parasysh marrëdhëniet personale të miqësisë dhe për të shmangur diskriminimin e klerit në Shqipërinë e Veriut, kam udhëzuar Shërbimet sekrete të mos ndërmarrin asgjë, pavarësisht këtyre momenteve të dyshimta”. Këtë e gjen në Arkivin e Shtetit në fondin personal të At Anton Harapit. Po prapë nga ky hirark kemi edhe një shkresë, të pa kontestueshme nga studiuesit pasi është një dokument gjerman. Në Seminarin Jezuit në Shkodër janë zbuluar një sasi armësh të fshehura dhe hieraki gjerman i shkruan Patër Anton Harapit: “Para disa ditësh, mora informacion që në një manastir Jezuitësh në Shkodër ndodhet një depo e madhe armësh. Informacioni erdhi nga një Shqiptar, i cili kishte marrë pjesë në vendosjen e armëve aty. Xhandarmëria u urdhërua për kontrollin e ndërtesës në fjalë. Jezuitët fillimisht u përpoqën të justifikohen se kryetari i urdhrit nuk ishte aty. Dhe më në fund, thanë se çelësin e dhomës nuk e kishin, për të penguar kontrollin. Mbas hapjes së dhomës, u konstatua që në një arkë u gjendën 90 pushkë Italiane, gjithashtu 22 granata dore Italiane dhe disa kallëp dinamiti. Kjo sjellje e Jezuitëve shkaktoi një lëndim të madh të neutralitetit Shqiptar të respektuar nga Jezuitët. Megjithatë, për shkak të konsideratës të kishës katolike, nuk u mor asnjë masë ndaj Jezuitëve. Do të isha mirënjohës, nëse në këtë rast do t’ju paraqisni Legatës Papnore dhe Arqipeshkvisë së Shkodrës dhe do t’ju lutesha të mos i jepni mbështetje elementëve ilegalë. Në rast

të kundërt, për të mbrojtur interesat Gjermane, do të detyrohem të përdor forcën, të cilën në marrëdhëniet me elementë fetarë të vendit, unë dua ta shmang”. Pikëpyetje të tilla enigmatike n’a shoqërojnë edhe sot.

Këto pikëpyetje ju çojnë edhe tek figurat e përfolura që u dënuan si bashkëpunëtorë nga komunizmi e që mund të jenë tërësisht të pafajshëm?

Mendoj se pas rënies së komunizmit në Shqipëri, figurat e përfolura të dënuar si bashkëpunëtorë të anglo-amerikanëve apo të dënuar në një proces gjyqësor jo të rregullt, duhet të rihapnin procesin e rigjykitimit të figurës së tyre.

KUR KLERI SPIUNOHEJ, TORTUROHEJ E PUSHKATOHEJ

Ishte fillim viti, janar 2015.

Katër klerikë të rëndësishëm të feve kryesore në Shqipëri – Myslimanë, Katolikë, Ortodoksë dhe Bektashi ecën krah për krah me njëri-tjetrin gjatë marshimit përkujtimor pas sulmeve në revistën satirike Charlie Hebdo. Shqipëria po tregonte një histori që një vit më parë edhe Papa Françesku e kishte trumbetuar. Zgjedhi Shqipërinë për udhëtimin e tij të parë European jashtë Italisë, në shtator të vitit 2014. Ai e përshkroi tolerancën fetare në Shqipëri si “thesar” që duhej mbrojtur dhe mbajti meshën e së dielës para 300 mijë njerëzve, shumë prej të cilëve myslimanë. Edhe unë isha atë ditë në shesh, një myslimane që e raportoi këtë ngjarje historike si një krenari shqiptonjash. Sot, pas leximit të disa fakteve e dëshmimeve të reja, kuptoj se kjo tolerancë fetare nuk mbërrin pa shkak në vendin tonë. Fakti që komunizmi ndërpreu disa marrëdhënie zyrtare me klerin dhe fakti që përdori sloganin e njohur të Rilindjes Shqiptare: “Feja e shqiptarit është shqiptaria” (Vaso Pasha, 1880), më bëri të mendoj se pikërisht në këtë kontekst mund të vërehet



“mungesa e informacionit për fetë si faktori i raportuar më shpesh për tolerancën fetare në Shqipëri”, po aq sa edhe fuqia e shtetit për të ndaluar vizitat në kisha e xhamia, ndërsa në shtëpitë e shqiptarëve braktisja e ZOTIT as që merrej parasysh. Sepse fijet shpirtërore s’mund t’i shkëpuste pushteti, as me spiunët, as me relacionet, as me urdhrat dhe as me dënimet e klerikëve, që erdhën më pas.

Po si nisi lufta e komunizmit shqiptar kundër besimit?

Këtë marrëfëmijë përmes fjalëve të Ipeshkëv Zef Simonin te “Persekutimi i Kishës në Shqipëri”, botuar në 2014-ën vetë Denald Prifti: “Përfshirja ideologjike e klerikëve me ideologjinë nazi-fashiste apo mohimin e komunizmit do të sillte një përplasje të hapur që fill pas lufte. Ajo do të zhvillohej në tre faza, kryesisht karshi klerit katolik: E para fillon menjëherë pas çlirimit, në vitin 1945 e vazhdon deri në vitin 1950. Gjatë kësaj faze kemi burgosje dhe pushkatime, pas torturave çnjerëzore, të zhdukjes së vlerave shpirtërore e kulturore katolike. Faza e dytë, që



XHAMIA, KISHA DHE SINAGOGA, PAK METRA NGË NJËRA-TJETRA

Abu Dhabi ka zbuluar planet për ndërtimin e një kompleksi fetar ku në pak metra distancë do të ndërtohen një xhami, një kishë dhe një sinagogë. Dizajni për atë që është quajtur “Shtëpia e Familjes Abrahamike” tregon se si të tre ndërtesat janë vendosur përballë njëra-tjetres, në një kopsht të gjelbëruar në ishullin Saadiyat në kryeqytetin e Emirateve të Bashkuara Arabe. Plani është që kompleksi të ketë përfunduar brenda vitit 2022 dhe në të të organizohen samite ndërkombëtare përveç se shërbesat e përditshme fetare.

fillon nga viti 1951 e deri në 1960, “asht ajo që po e quajmë një lloj pakësimi të ashpërsimit të luftës kundër fesë, mbas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë. Dhe faza e tretë fillon në kohën mbas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, kur do të ngjajnë mbyllja e kishave dhe e të gjitha institucioneve fetare në Shqipëri”.

Në studimin tuaj, Denald Prifti gjej edhe përfshirjen e arsimit në këtë luftë, mësues në qytete të mëdha e fshatra që spiunojnë, raportojnë, qortojnë qoftë edhe për disa karamelle të shpërndara nga kisha e zonës? Ndan ndonjë nga këto ngjarje?

Ka raste ku fëmijët janë rrahur rëndë prej mësuesish vetëm sepse kanë shkuar në kishë. Tregohet se arsimtarët u kanë kërkuar nënshkrimin prindërve se nuk do t’i çojnë në kisha fëmijët e tyre. Në një mbledhje të prindërve në sallën e leximit “Milot” ku edhe pjesëmarrja ishte e detyrueshme e kërcënoheshin me gjobë u fol edhe për prindërit që duhet të rrahin fëmijët nëse ikin në kisha. Por, këto janë normale pasi në vend kishte nisur propaganda kundër besimeve fetare që kur komunizmi kishte rrënjët në popull. Krijimi i grupeve të të rinjve, të udhëhequr nga mësues, të cilët propagandonin kudo kundër bestytënive dhe mbeturinave të së kaluarës, për përfshirjen e të rinjve, po sidomos të të rejave në aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive, pasi shumë prej këtyre bestytënive kishin origjinë fetare ishin krejt normale për atë kohë. Organizimi i rretheve të pionierëve dhe të rinjve ateistë ku detyra kryesore e të cilëve ishte lufta kundër fesë apo krijimi i bibliotekave kudo, nëpër shkolla, qytete, lagje e fshatra, ishte propaganda revolucionare e materialiste.

Cilat histori të kanë bërë më shumë përshtypje gjatë kësaj periudhe? Histori në dukje minore, pra jo politike, që vinin nga radhët e shtresës punëtore, por që merrnin pastaj përmasa të mëdha?

Do të veçoja implikimin e shkollës “Naim Frashëri” të qytetit të Durrësit. Të rinjtë, pas fjalimit të sekretarit të parë të partisë, shokut Enver Hoxha vunë në zbatim fjalët e tij duke hedhur në jetë sloganë si “tashmë kishte ardhur koha kur priftërinjtë dhe hoxhallarët duhet ta fitojnë vetë bukën e gojës dhe jo të shfrytëzojnë djersën e fshatarësisë” të shtyrë edhe nga imitimi i “vlerave” të revolucionit kinez, ku rinia do të merrte në dorë fatet e vendit kundër kundërshtarve ideologjikë. Në datë 21 janar të 1967, shkolla “Naim Frashëri” u gdhie veshur me një material të pasur propagandistik, që shënonte fillimin e luftës kundër ideologjisë fetare e zakoneve prapanike. Më pas, të rinjtë krijuan një shtab të luftës kundër zakoneve

prapanike, duke krijuar tre komisione studimore, i pari, me zbulimin e literaturës ateiste dhe përvetësimin e tyre, i dyti, komisioni i citateve dhe i treti komision studimi mbi çështjet klerikale (Zëri i Rinise, 8 shkurt 1967). Këto ide u kaluan edhe në nivel rrethi. U kritikua Komiteti Ekzekutiv i Rrethit për shpenzimet e panevojshme për objektet e kultit si rasti i xhamisë në qendër të Durrësit ndërtuar gjatë kohës së fashizmit. U kritikuan edhe shokët e partisë që lejuan që heroin e popullit Adem Reka të varrosej në varreza me rite fetare (myslimane). Të gjendur para kësaj fryme antiklerikale nxënësit e shkollës “Naim Frashëri” filluan të demonstrojnë të parët klerin, madje deri në dhunim të objekteve të kultit.

Shqipëria komuniste ka pasur lidhje me Ish Jugosllavinë e me Bashkimin Sovjetik. Ka pasur dëbime të murgeshave, zëvendësime, histori interesante, dëshmi padiskutim...

Didier Rance shkruan në “Hanno voluto uccidere Dio. La persecuzione contro la chiesa cattolica in Albania 1944-1991: “Manastiret e tyre [murgeshave] u mbyllën. U detyruan të braktisnin banesat e tyre dhe u shpërndanë. Ato që refuzuan u futën nëpër kampe ose u shëtiten lakuriq nëpër rrugët e qyteteve, pasi ishin torturuar”. Nuk di sa e besueshme mund të jetë kjo pasi nuk mbështetet në fakte, por rrëfime.

Duket sikur komuniteti mysliman ishte më pak i përfshirë në konflikte gjatë kohës së komunizmit. Madje shumë interesante m'u duk reagimi i kryetarit Hafiz Musa Haxhi Aliut në 1951 që kur ai flet në një intervistë për energjinë atomike dhe Rusinë e asaj kohe...

Po, është interesante të lexosh në gazetën “Bashkimi” në 18.10.1951. Ai theksonte: “Sigurimi i paqes është më i afërt dhe më i sigurt se kurrë, sepse për të punon Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i Madh”.

A keni hasur ngjarje që humbasin vërtetësinë historike dhe kalojnë në kufirin e trillit?

Një prej ngjarjeve që më ka bërë habi si studiues



ka qenë ajo e nxjerrjes së armëve nga kisha dhe ku duket prifti Donat Kurti. Po ju tregoj një fotografi interesante të kohës, ku sipas digiturës, ajo është dhoma e priftit, ku është një mur i çarë dhe ku qenë fshehur disa armë. Duke pasur parasysh procedurën praktike që ndiqet për të ndërtuar një mur, ngrihet pyetja: A ka mundësi që sigurimi të ketë shkuar në dhomën e fjetjes së priftit, të ketë çarë murin, të ketë fshehur armët dhe pastaj ta ketë murosuar përsëri, pa u vënë re nga asnjë shërbyes i Kishës? Pasi muri ka nevojë për llaç e tulla, që do kohë të thahet dhe bie menjëherë në sy e nuk thahet për një ditë, sepse “armët u zbuluan një ditë pasi i kishte vendosur sigurimi”. Si është e vërteta e kësaj historie?

Po një ngjarje që do të donit t'i dedikoheshit për t'ia zbuluar sekretet?

Do përmend telegrafikisht rastin e priftërinjve Dom Pjetër Çuni dhe Dom Aleksandër Sirdani. Jepen tre variante të ekzekutimit të tyre. I pari variant figuron në arkivat e Ministrisë së Rendit ku gjendet vetëm ky shënim: “Kur fillojnë arrestimet, torturat e vrasjet edhe në Malësinë e Madhe, së bashku me Dom Pjetër Çunin arrestohet edhe Aleksandër Sirdani në korrik 1948. Ashtu, i lidhur shëtitet nëpër rrugët e Koplikut deri sa pushkatohet. Ekzekutuar më 31 korrik 1948”. Variant i dytë i historisë është ai nga Pjetër Pepa në veprën “Tragedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri” ku shkruhet: “vdes gjatë torturave të korrentit e ndalimit të zemrës, ku më pas e varrosin në gropën e gjirizit, siç deponojnë dëshmitarët”. At Anton Luli më vonë do të jepte një tjetër version “e mbysin për së gjalli në gropën e nevojtores së policisë, duke e zhytur me cfurk, së bashku me Dom Pjetër Çunin”. Diku tjetër: “Arrestohet Dom Pjetër Çuni, torturohet keqas e, së bashku me Dom Aleksandër Sirdanin, hidhen në një gropë të EC për së gjalli, ku zhyten në sytë e popullit, duke mos pranuar të mohojnë fenë”. Po për Dom Aleksandër Sirdanin, një autor tjetër Cesare Giraudi shkruan: “Para do ditësh kishte dekë prej torturave edhe famullitari i Bogës, Dom Aleksandër Sirdani. Trupin e tij e patën hjedhë në gropën e madhe të gjirizit. Të gjitha këto gjana ndodhën në muejt e fundit të vjetit 1948”. Variantet nuk përputhen. Në këtë rast, ngrihet pyetja: cila është e vërteta për fatin e këtyre dy priftërinjve?



500 + ZINC+ **D3** *DIRECT*

PËRTHITHJE MAKSIMALE

Rrit imunitetin

Lufton viruset

Zn

D3

C


- **funksionimin normal të sistemit imunitar**
- **mbrojtjen e qelizave nga stresi oksidativ**

Bustina të tretshme

Merret pa ujë

Shtesë ushqimore





ARMANDO DUKA

PRESIDENTI QË I DHA SHQIPËRISË “CONFERENCE LEAGUE”

| Nga ANTA MUÇAKU

Presidenti i FSHF-së gjen një orë kohë në këto ditë të ethshme ku telefoni bie pa pushim për të folur për Newsbomb.al. Do të duhej të flisnim vetëm për ndeshjen e 25 majit, ku gjithë bota i ka sytë në Tiranë, por vetvetiu, biseda mbërrin edhe tek konflikti që ka pasur katër muajt e parë të vitit me kryebashkiakun Erjon Veliaj. Armand Duka thotë se edhe sot e kësaj

dite nuk e ka kuptuar atë përplasje të ashpër. Thjesht, kjo ndërhyrje mori shumë kohë dhe energji, që duhet të ishin shpenzuar për finalen e madhe që do të luhet në Tiranë

10 VITE PËR TË SJELLË CONFERENCE LEAGUE NË TIRANË

Telefoni i Armando Dukës nuk pushon së rëni. E marrin nga çdo cep i botës për të siguruar një biletë për në finalen e madhe të Conference League. Mundohet të shpjegojë se

“Ne ishim në kohën e duhur, në vendin e duhur. Duhet thjesht të jesh i shkathët, të kuptosh kur është momenti i duhur. Ne shkuam në momentin e duhur. Do mbahet mend gjatë...”

nuk ka asgjë në dorë, por njerëzit e kanë të vështirë të besojnë se ai që bëri të mundur që më 25 maj në stadiumin “Air Albania” të shkruhet historia, të mos ketë mundësi të gjejë një biletë.

Janë 150 mijë kërkesa për të parë ndeshjen mes Romës dhe Feyenoord-it, por stadiumi ka kapacitet vetëm për 20 mijë vende.

Me siguri kjo është hera e parë dhe e fundit që një finale e tillë luhet në Shqipëri.

Armand Duka tregon se ky ka qenë një objektiv i kahershëm, 10 vite më parë, atëherë kur nisi dhe projekti për ndërtimin e stadiumit.

“Në fillim menduam të kishim një finale të Superkupës dhe kemi aplikuar ende pa u bërë stadiumi. Nuk n’a u miratua. Aplikua më sërisht për finale superkupe. Conference League asokohe ishte ende projekt dhe meqë për

Superkupën po luftonin dhe shtete të tjera, ne u tërhoqëm e pranua të ishim në garë për Conference League. Meqë “Conference League” është një finale reale, kompeticion më i rëndësishëm sesa superkupa, (që është më shumë një ndeshje prestigji), atëherë aplikua për këtë kompeticion”.

Ky është maksimumi që një vend i vogël si i yni, me kapacitete të pamjaftueshme për të mbajtur qindra mijëra tifozë nga anë e kënd bota, të mund të arrijnë.

Për Armand Dukën, e vetmja gjë që i vë një pikëpyetje finales është kapaciteti i stadiumit, sepse çdo gjë tjetër, konstaton ai, me pak mirëmenaxhim, Shqipëria mund t’i bëjë.

Por ndryshe nga sa tregon Duka, është e qartë që një ndeshje e kësaj rëndësie, nuk vjen kaq rastësisht në Tiranë, ndaj e pyes se kë ka takuar dhe ku ka lobuar që kjo të ndodhte.

“Padyshim që i kam takuar të gjithë. E para, lobimi fillon me përgatitjen serioze të dokumentacionit dhe dosjes. Se në fund të fundit, nuk merr Shqipërinë dhe e çon në tavolinë... Por do të duhet të aplikosh me dokumentacion. Është një punë tejet voluminoze (dosje

prej mijëra fletësh) që ne e kemi bërë mirë në bashkëpunim me institucione të ndryshme, ministrinë e Brendshme, Aeroportin, Bashkinë dhe gjithë të tjerët. Pasi e kompletua siç duhet, e prezantuam mirë, kërkuam mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s dhe të Presidentit, gjithashtu”.

Ecejaket nga Tirana drejt vendeve të ndryshme, shfrytëzoheshin veç të tjerave për këtë aplikim. Për vite me radhë. Duka i takoi të gjithë, një nga një, për t’u mbushur mendjen se Shqipëria mund të ishte një organizatore e denjë, me synimin e vetëm që kjo ngjarje të hynte në histori. Sepse sado të luhet ky kompeticion më vonë, qoftë edhe pas 20 vitesh, do të thuhet që, për herë të parë u luajt në Tiranë.

“E kam parë si një projekt shumë të mirë që ndihmon vendin, për imazhin, por realisht nuk mendoja që do ishte një interesim kaq shumë i madh”.

Ai thotë se thellë-thellë nuk e ka pritur që do përballej me këtë çmenduri kërkesash për bileta. Sot, kudo flitet për Shqipërinë, Tiranën dhe futbollin shqiptar, por diskutimet janë nga më të ndryshmet.

Shumëkush thotë se pse duhej që tifozët nga e gjithë bota të vinin në Tiranë kur ka vende shumë më të zhvilluara, me infrastrukturë të mira, me stadione më të mëdha.

E për këdo që mendon kështu, Duka e ka përgjigjen:

“Sepse futboli nuk luhet vetëm në Gjermani dhe Francë; apo Portugali dhe Itali, por dhe në Shqipëri, Mal të Zi, Bosnje, apo Serbi. Ne të gjithë kemi të drejtë të organizojmë diçka kur plotësojmë kriteret, ne të gjithë kemi të drejtë të zhvillojmë futbollin në vendet tona”.

E megjithatë, është e vështirë të besosh se kjo është thjesht një çështje barazie. Vendimi që finalja europiane të luhej në Tiranë, qartazi ka përpjekje edhe më të mëdha nga pas, trokitje të njëpasnjëshme në dyert e ndërkombëtarëve





Bileta, bileta, bileta...Armand Duka, këtë fjalë e dëgjon prej javësh tashmë. Pakkush e di se Shqipëria ka vetëm 5% të tyre. Janë rreth 1 mijë bileta nga 20 mijë vende që mban stadium gjithsej. 4 mijë të tjera i kanë marrë respektivisht klubet e Romës dhe Fejnordit

të futbollit, por Duka zgjedh të jetë modest në këtë rast dhe të mos japë shumë detaje.

“Ne ishim në kohën e duhur, në vendin e duhur. Duhet thjesht të jesh i shkathët, të kup-tosh kur është momenti i duhur. Ne shkuam në momentin e duhur. Do mbahet mend gjatë...”

Nuk është aspak e lehtë të mbledhësh mijëra njerëz brenda një nate në një Tiranë kaq të

vogël. Sepse kur vjen puna te futboli, pavarësisht kombësive, pavarësisht kulturës e formimit, në fund, të gjithë janë tifozë.

Kreu i Federatës nuk e fsheh frikën që ka për ndonjë incident të mundshëm apo ndonjë akt huliganizmi nga tifozët, por uron shumë të mos ndodhë asgjë. Për këtë u ka dalë garant edhe institucioneve ndërkombëtare të futbollit, por edhe medieve të huaja që i kërkojnë vazhdimisht intervista.

Stadiumi nuk mund të ketë vetëm tifozë shqiptarë, aq kohë sa kjo është një finale europiane, por kjo nuk i ndal

ata të kërkojnë bileta.

150 MIJË KËRKESA, PËR 20 MIJË VENDE

Bileta, bileta, bileta...Armand Duka, këtë fjalë e dëgjon prej javësh tashmë. Pakkush e di se Shqipëria ka vetëm 5% të tyre. Janë rreth 1 mijë bileta nga 20 mijë vende që mban stadium gjithsej. 4 mijë të tjera i kanë marrë

 **CREDINS** bank

VISA



Karta Planetit



respektivisht klubet e Romës dhe Fejnordit.

Në tribunë nuk ka asnjë biletë për Shqipërinë. Ato janë protokollare dhe u përkasin partnerëve të UEFA-s, sponsorave, bashkëpunëtorëve, broadcasteve. Madje, tribuna nuk i plotëson të gjitha vendet që kërkon një protokoll i nivelit evropian.

Një pjesë tjetër e biletave kanë dalë në shitje të lirë dhe për këtë pjesë, Duka rrëfen se ka goxha kontestime, sidomos nga Holanda. Ankohen se shqiptarët kanë marrë shumë. Por në fakt, thotë ai, shqiptarët kanë marrë shumë, sepse “kanë qenë më të zotë”. Në momentin e duhur kanë qenë para kompjuterit për të bërë aplikimet sipas procedurës.

Megjithatë, unë e pyes për atë 5%-shin. Kush i ka marrë ato 5% të biletave tona?

Më thotë se u janë shpërndarë sipas kriterëve të gjithë anëtarëve të FSHF-së, administratës, bashkëpunëtorëve të Federatës, ish-futbollistëve dhe futbollistëve të ekipit kombëtar dhe sponsorave. “Kështu janë shpërndarë, pak a shumë”, e mbyll këtë pjesë. Aty tek

“pak a shumë” vetiu më shkon mendja tek politikanët “VIP”. Ndaj e pyes nëse edhe ata e kanë një biletë.

“Po. Kryeministria, Bashkia e Tiranës, Policia... por jo në mënyrë individuale”, kujdeset të theksojë Duka.

Pra, dhe Erion Veliaj e ka një biletë...

“Patjetër. Është bashkë-organizator. Sepse ka pjesën e vet në këtë event, me organizimin në Tiranë!”

ARMAND DUKA RRËFEN PËRPLASJEN ME ERION VELIAJ

Duket si një moment paqeje mes kreut të FSHF-së dhe kryetarit të Bashkisë, por me gjasë, nuk pritet të zgjasë shumë. Sepse kryebashkiaku ka deklaruar se do të merret me Dukën pas finales.

Po çfarë kërkon Erion Veliaj nga Armand Duka?

“Nuk e di. Nuk më ka thënë ndonjëherë se çfarë kërkon”, më përgjigjet shkurt.

“Ai kërkon që ju të ikni nga FSHF”, i them.





“Po dhe unë mund të kërkoj që Erioni të ikë nga Bashkia, por janë votuesit që vendosin që Erioni duhet të jetë në bashki. Është komuniteti i futbollit që vendos nëse unë duhet të jem këtu, ose jo. Nuk është çështje dëshirash, kjo. Ne të dy, kemi ndryshim të madh. Unë respektoj institucionet që duhet të zgjedhin Erionin, kurse Erionin e kam dëgjuar që thotë: ‘nuk lejojmë ne në Tiranë të zgjidhet ky’!

Dhe aty Armand Duka, nisë të flasë shumë gjatë.

“Po dhe unë mund të kërkoj që Erioni të ikë nga Bashkia, por janë votuesit që vendosin që Erioni duhet të jetë në bashki. Është komuniteti i futbollit që vendos nëse unë duhet të jem këtu, ose jo. Nuk është çështje dëshirash, kjo. Ne të dy, kemi ndryshim të madh. Unë respektoj institucionet që duhet të zgjedhin Erionin, kurse Erionin e kam dëgjuar që thotë: ‘nuk lejojmë ne në Tiranë të zgjidhet ky’!

Të bëjmë një paralalizëm: është njëlloj sikur të deklarojë kryetari i bashkisë së Gjenevës: Zgjedhjet në OKB do t'i komandoj unë, sepse selia e OKB, është në Gjenevë. Por nuk ka asnjë lidhje me të. E njëjta gjë edhe me selinë e FSHF-së. Mund të mos ishte në Tiranë, mund të ishte në Durrës. Nesër mund mblidhet Asambleja dhe të vendosi që selia të jetë në Vlorë. Kështu që, nuk ka asnjë të drejtë. Pastaj, sa e ndjen secili veten të fortë në këtë sistem “demokratik”, kjo nuk varet nga ne”.

Është e qartë që përplasja mes Armand Dukës dhe Erion Veliajt është e fortë, sa është vështirë t'a ndash nëse është institucionale, apo personale.

Duka nuk pranon të jetë përplasur me Veliajn. Thotë se është ai që e ka sulmuar.

“Përplasja është kur ndodh mes dy palëve. Unë kam qenë në punën time. Kanë qenë sulmet e Erionit, duke e ndjerë veten të fortë si kryetar i Bashkisë, si njeriu më me potencë që mund të komandojë edhe gjykatat, edhe prokuroritë dhe gangsterët; i cili më ka sulmuar mua, jo sepse ka diçka personale, siç e ka shprehur vetë, por sepse nuk do që unë të jem President i Federatës. Meqë selia jonë është në Tiranë, do dhe Federatën. E ka thënë, ju e keni dëgjuar: FSHF-ja, është i vetmi ishull që nuk e kemi dhe do ta marrim!”

Armand Duka pat menduar në ndonjë moment edhe tërheqjen nga gara për të shmangur konfliktet. Në fund vendosi të mos e bëjë, sepse në momentin kur u shpallën zgjedhjet, anëtarët e FSHF-së, por edhe organizma ndërkombëtare si FIFA apo UEFA, kishin shprehur mbështetjen e tyre.

“Tërheqja do ishte tradhti ndaj të gjithëve dhe lënie në baltë të institucionit. Edhe

pse më ka kaluar nëpër mend, nuk ka qenë në mazhorancën e mendimit që të jap dorëheqjen, apo mos kandidoj!”

Ardhja e Presidentit të UEFA-s në Tiranë ishte një pikë e madhe kthese për të gjitha zhvillimet. E megjithatë, Duka kujdeset të theksojë se Aleksandër Ceferin nuk erdhi për të, por për të mbrojtur parimet dhe pavarësinë e UEFA-s, ku Federata e Futbollit është anëtare.

Ai nuk e di arsyen e vërtetë të konfliktit me Veliajn. Thotë se kishte dëgjuar zëra se do i kundërvihet në zgjedhje dhe për këtë e ka pyetur vetë kryebashkiakun.

“E kam pyetur deri në janar dhe më ka thënë: në asnjë mënyrë! Ç’punë kam unë me FSHF-në?! Ju jeni të pavarur! Më pas ju e dini sesi vazhdoi historia”.

Atëherë çfarë ndodhi që në pak ditë gjërat ndryshuan? I ka kërkuar dikush tjetër të ndërhyjë?

“Nuk di ta them. Jo, nuk besoj... Unë mendoj ka qenë një dëshirë e tij. E ka në AND-në e vet”.



**DUKA PËR RAPORTET ME EDI RAMËN:
MË UROI DIREKT PAS FITORES**

Këtu e pyes drejtpërdrejt nëse mendon se ka qenë një dëshirë e Erion Veliajt apo e kryeministrit Rama, por sërish ai thotë se nuk e beson të jetë kjo e fundit.

Këmbëngul më tej për raportet që ka me

Kryeministrin dhe më thotë se i ka shumë korrëkte. Por kujdeset të theksojë që e ka fjalën për raportet institucionale. Atëhere, e pyes nëse ka raporte miqësore dhe kur ka qenë hera e fundit që ka folur me të.

“Dje (dt 15.05.2022), për organizimin e finales. Kryeministri është shumë i interesuar për

Kryeministri është shumë i interesuar për organizimin, shumë i përfshirë realisht për çdo problem që ne kemi. Se problemet janë komplekse, që nga siguria, logjistika, akomodimi... është shumë i gatshëm për të kontribuar dhe për t'i zgjidhur. Dhe në fakt ka qenë shumë rezultativ në këtë kontribut”!

organizimin, shumë i përfshirë realisht për çdo problem që ne kemi. Se problemet janë komplekse, që nga siguria, logjistika, akomodimi... është shumë i gatshëm për të kontribuar dhe për t'i zgjidhur. Dhe në fakt ka qenë shumë rezultativ në këtë kontribut”!

Më tregon se Rama e ka uruar edhe për fitoren, direkt pas zgjedhjeve.

Por edhe pse u ndalëm gjatë tek konflikti i fundit me Veliajn, në 20 vite në krye të FSHF-së, Armand Duka ka patur vazhdimisht beteja me politikën. Ai është i vetëdijshëm se tendenca e politikës për të kontrolluar gjithçka, nuk është tendencë shqiptare. Veçse,

kur politika ndërhyr edhe tek drejtësia, gjërat ngatërrohen edhe më shumë.

“Të gjithë e panë se në prag zgjedhjeve të Federatës së Futbollit, për FSHF-në bëheshin 5 gjyqe brenda ditës, ndërkohë që një shqiptar pret me vite për një vendim gjykatë. Federata e Futbollit është një shoqatë që duhet të funksionojë e pavarur, por e njeh shtetin. Shteti është ai që i jep emrin kesaj shoqate në Federatë. Dhe shteti, nëse sheh që kjo shoqatë nuk zbaton ligjet, nuk bën mirë detyrat, apo nuk ka një strategji, ka të drejtën ligjore t'i heqë emrin.

Këto janë veprimet ligjore. Në vendet me demokraci të pakonsoliduara, si ne, ndodhin këto fenomene, por s'jemi të vetmit në Evropë”.

Presidenti i FSHF-së mendon se çdo gjë në fund të fundit përkthehet në votë. Ai që ka pushtetin, mendon se mund të ketë dy vota më shumë dhe nga futbollit, ndaj kërkon ta dominojë edhe këtë të fundit.

“Nuk është tendencë e influencave ekonomike. Buxheti i Federatës së Futbollit, nuk është as sa një e njëqinda e buxhetit të bashkisë së Tiranës. Por është tendencë e kontrollit për produkte politike, në çdo kohë. Edhe Sali Berisha ka tentuar të

njëjtën gjë. Duhet një vendim: ose të bëhesh palë me pushtetin, ose tenton maksimalisht të ruash autonominë e institucionit, e kjo të çon në konflikt të vazhdueshëm. Politika e ka këtë lloj tendence. Qasja ime ka qenë drejt ruajtjes së pavarësisë sportive të institucionit. Kjo ka sjellë pakënaqësinë e politikës në përgjithësi: Sali Berishës, Edi Ramës, Bujar Leskajt e tani në fund, të Erion Veliajt...”

U ndalëm gjatë tek kjo betejë me politikën, por ndoshta edhe për faktin që Duka thote se ky ka qenë momenti më i vështirë në rrugëtimin e tij. E cilëson një luftë të paprincipitë, një sulm nga të gjitha anët. Aq sa do të kishte hequr dorë.

“Po të isha në momentet që s'do kisha nisur garën, do thoja: vazhdoni, bëni ç'të doni!”

Por Duka është aty, si njeriu përgjegjës për çdo fitore apo humbje të futbollit tonë, për çdo lojtar që afrohet apo largohet nga kombëtarja.

Thonë se duhet të paguash për t'u bërë pjesë e kombëtares shqiptare. Për Armand Dukën, kjo është një lloj propagande baltosësese, sepse paraja dhe kombëtarja nuk mund të rrinë bashkë. Të luash për kombëtaren, para së gjithash, do të thotë të sakrifikosh.

“Nuk mund të më gjesësh një rast, jo sot që jam unë President, por në gjithë historinë e futbollit shqiptar, që një futbollist e ka merituar të luajë në kombëtare dhe nuk ka arritur. Jo sepse ne jemi shumë të ndershmë, por sepse Shqipëria është një vend i vogël dhe nuk ka kaq shumë futbollistë. Të shpresojmë të kemi, por më thuaj një futbollist që ka ngelur jashtë e paska hyrë një tjetër që paska pasur lekë?! Përkundrazi, në Shqipëri nuk ka luajtur asnjë që ka pasur lekë. Futbolli është i tillë, kërkon shpirtin e sakrificës dhe njerëzit që janë me lekë (ka raste të tilla plot në realitetin shqiptar), nuk bëhen dot futbollistë”.



**SUKSESET, ÇFARË E SHTYN
MË TEJ PRESIDENTIN E FSHF-SË**

Kur Armando Duka u zgjodh President për herë të parë, FSHF-ja, ishte një institucion që nuk e aspironte askush. Ai thotë se pranoi propozimin e klubeve të futbollit me mendimin që kjo ishte një gjë honorifike, që do i harxhonte vetëm një ditë pune në muaj, por që nuk rezultoi e tillë. Ose varet se ku do të shkosh, çka të çon në punë të ditëpasditëshme, e orë pas orësh. Armand Duka me krenari tregon se nuk është penduar, përse kohë shihet se futbollit shqiptar ka arritur në një tjetër nivel.

Për herë të parë, Kombëtarja Shqiptare e Futbollit u kualifikua në Europeanin e vitit 2016, por a do kemi më shanse t'i provojmë ato emocione sërish? Presidenti i FSHF-së është optimist.

"Realisht, kjo është kombëtarja më e mirë që kemi pasur, ndonjëherë, pa i hequr asnjë meritë kujtdo që ka luajtur qoftë edhe një minutë me fanellën e Shqipërisë. Me ndonjë modifikim të vogël, bëhet e përkryer. I kemi të gjitha shanset të jemi pjesë e Euro 2024 në Gjermani. Unë uroj që vërtet ta arrijmë, por ndodh edhe që skuadra që kanë bërë histori në Botërore, të mundën në fushë në lojë sportive, siç ndodhi me ndeshjen Itali – Maqedoni e Veriut".

Ka disa arritje që i kanë lënë gjurmë dhe kualifikimi në Euro 2016, është një prej tyre.

"Kur ne deklaronim se e kishim objektiv, njerëzit thonin: 'ju talleni me ne'. Aq e pabesueshme dukej. Por ne në fakt shkuam".

Ndërtimi i stadiumit në Tiranë është një tjetër arritje.

"Nuk e them në mënyrë figurative këtë, por vërtet kur shkoj në stadium, e sodis dhe them: A është i yni ky? Më duket si ëndërr. Dhe tani organizimi i finales së 'Conference League'. E kemi kthyer Shqipërinë në qendrën e opinionit, jo vetëm sportiv".

Shumë pyesin se pse ky njeri duhet të qëndrojë kaq gjatë në Krye të Federatës së Futbollit Shqiptar. Armand Duka e ka një përgjigje:

"Koha kalon dhe njeriu sfidon kohën, por edhe veten e vet, në fund të fundit. Kjo Federatë nuk është çështje interesash ekonomike. Unë kam 20 vite këtu dhe nuk kam marrë as rrogë, as dieta. Shoferin e makinën i kam vetë, nga biznesi privat. Buxheti i Federatës në muaj, është aq sa buxheti i një prej kompanive të mia. Por është sfidë, me emocione të jashtëzakonshme".

**DUKA SI BIZNESMEN: DIKUR NGARKOJA
E SHKARKOJA EDHE KAMIONË**

Sot është 59 vjeç. Gjysmën e jetës ia ka

**Sot, shumësyresh e shohin si
"Don Duka", por këtë të drejtë ia
njej vetëm Alban Berishës, tifozit
të zjarrtë të Tironës, sepse ai,
ndryshe nga të tjerë që me "Don"
nënkuptojnë pushtetin e tij, e
thërret kështu me dashamirësi dhe
mirënjohje për atë çfarë Armando
Duka i ka dhënë futbollit shqiptar**

dedikuar futbollit, edhe pse fillesat i ka patur në biznes.

"Kam mbaruar ekonomikun. Jam emëruar në Burrel në Parkun e Mallrave. Në '90 jam transferuar në Durrës në parkun e eksportit, pastaj kam ndërmarrë një iniciativë private, kam vazhduar më vonë me biznesin".

Kështu si e tregon duket një histori tipike biznesmenësh të lindur. Një jetë pa shumë mundime. Por në fakt, as ai nuk i ka shpëtuar viteve kaotike post-regjimit dhe as vitit të mbrapshtë të 97-ës, kur kërcisnin armët dhe bandat ishin ngado.

"Sot kisha ambasadorin hollandez dhe po kujtonim ndeshjen me Fejnordin në 91-shin. Ai ka qenë një vit shumë varfër dhe iniciativa private s'ishte një gjë luksi. Nuk ishte fare e lehtë. Ishte shumë e vështirë, sakrifikuete. Unë i kam bërë të gjitha llojet e punëve. Kam ngarkuar dhe shkarkuar vetë makina e kamiona, kam mbajtur vetë dëngjet e rrobave që bleja nëpër Turqi apo Greqi. Kam bërë shoferin nëpër rrugët e Shqipërisë që në atë kohë ishin shumë të pasigurta. Pastaj lufta, '97, duhet të mbronim ato që kishim ndërtuar në një situatë të pakuptimtë. Ka qenë shume e vështirë. Nuk ka qenë biznesi si sot!"

Armand Duka është nga Shijaku, është rritur nga dy prindër mësues që i kanë treguar se rruga më e sigurtë drejt pavarësisë, është puna.

Sot, shumësyresh e shohin si "Don Duka", por këtë të drejtë ia njej vetëm Alban Berishës, tifozit të zjarrtë të Tironës, sepse ai, ndryshe nga të tjerë që me "Don" nënkuptojnë pushtetin e tij, e thërret kështu me dashamirësi dhe mirënjohje për atë çfarë Armando Duka i ka dhënë futbollit shqiptar. Armand Duka e thotë vetë këtë kur përmend emrin e tifozit të zjarrë, Berisha, madje, qesh dhe me këtë konstatim të tillë.





10

MIJË HAPAT E LUFTAR PAJËS

| Nga SUADA DACI

Këtë herë kemi udhëtuar drejt Vlorës për të dëgjuar me shumë vëmendje rrëfimin e një aktori që ka bërë histori në artin shqiptar. Sa mbaron prilli, Luftar Paja së bashku me bashkëshorten, Qamilen, lënë zhurmën e kryeqytetit dhe stacionohen në Orikum. Në këtë qytezë të vogël jeton prej më shumë se 15 vitesh, sepse injektojnë vitaminat falas që u ofron natyra.

Aktorin e takojmë rreth orës 10:20 buzë detit duke gjerbur kafën e mëngjesit me një nga banorët e zones. Na priste në një paradite rrëfimesh që i ndryshoi pakëz rutinën. Është 81 vjeç dhe bën çdo ditë 10 mijë hapa në ditë (duke qenë shenjë e shigjetarit dihej që do të ishte kaq energjik). Është terapia më e mirë që një njeri i moshës së tij, do të donte në këtë moment të jetës.

“Orikumi është një qytezë që për mua i ka të gjitha, klimë malore, bregdetare, fushore. Në kohën e pandemisë, nuk ika që këtu dimër- behar; sivjet kisha 7 muaj që kisha ikur në Tiranë. Kur u ktheva pashë që njerëzit më flisnin me dashuri. Ky vend ka njerëz shumë dashamirës, e kur bëhesh banor, të flasin të mëdhenj e të vegjël”, tregon Luftari.

E në fakt, këtë bisedë tonën nuk e shoqërojnë vetëm valët e detit, por edhe banorët e zonës që e përshëndesin vazhdimisht Luftar Pajën me shumë dashamirësi.

“Si e kaluat pandeminë?” E pyes unë.

“Respektova të gjitha rregullat shëndetësore, bëra tre vaksinat si dhe të gripit dhe jam i qetë s’kam asnjë lloj shqetësimi. Plus është edhe klima që të favorizon. Natyra këtu është vitaminë më vete”.

ARTISTI QË FRYMËZON PA NDALUR



NJË JETË NË SKENË

Ishte viti 1952 kur Luftar Paja u përball për herë të parë me emocionet e skenës. Asokohe ishte 8 vjeç (në klasën e dytë të fillores). “Prezantimi i parë ishte në Pallatin e Pionerëve në Patos. Interpretova në një dramë sovjetike ku kisha rolin e një nxënësi që quhej Juri Ku. Më pas, në vitin 1957 mora pjesë në një festival në Fier dhe si shpërblim më dhanë një stilograf 700 lekësh”, tregon me nostalgji Luftar Paja që duket se e ka dashur që në fillimet e karrierës profesionin e tij. “Më ka pëlqyer gjithnjë aktrimi. Talentin e kam të trashëguar edhe nga mamaja edhe nga babai, të dy kanë pasur shumë humor. Babai bënte humor me bejte, ndërsa nëna ka pasur një humor çehovian dhe ishte shumë spontane”.

Por cilën periudhë konsideron Paja si kulmin e karrierës së tij?

“Unë i përkas asaj plejade të artistëve të fundit të shekullit 20-të, kulmi i krijimtarisë janë vitet ‘70-80. Kam patur fatin që të kem edhe një kolektiv të shkëlqyer artistik. Regjisorët kanë ndikuar shumë në kualifikimin tim dhe të miqve të mi. Pëllumb Kulla, Pirro Mani, e të tjerë, janë më cilësorët me të cilët kam punuar”, tregon ai.

“Artisti i Popullit”, Luftar Paja i ka dhuruar dhjetëra role skenës së teatrit, ka pasur shumë vlerësime në estradë, apo dhe në kinemanë shqiptare.

“Unë e nisa mbi baza amatore. Kisha aftësira imituese shumë të mira dhe ndonëse vija nga një fshat i Mallakastrës, e dashuroja humorin e veriut. Zanafilla ime ishin rapsoditë e Hazis Ndreut. Përveç estradës dhe teatrit të Fierit, unë një periudhë 10 vjeçare, e kalova në Teatrin Kombëtar. Punova atje nga viti 1993 deri në 2003-in, me një kolektiv të shkëlqyer: Roland Trebicka, Yllka Mujo, Pavlina Mani, Luiza Xhuvani, Vasjan Lami, Vangjel Toçe, etj. Kam një veçori nga aktorët e humorit pasi unë kam luajtur në teatër me të madhin Suljeman Pitarka në dramën “Pjata prej druri”. Ajo është një dramë e një dramaturgu amerikan në vitet ‘50 dhe ne e përshtatëm për vendin tonë. Të luaje me Sulejman Pitarkën ishte përgjegjësi dhe kënaqësi e veçantë.

Kur flet për kollozin e skenës shqiptare, Sulejman Pitarka, Paja ka një tjetër shkëlqim në sy, andaj instiktivisht më lind pyetja se si ka qenë takimi i parë me të...

“Në vitin 1976 në Dardhë të Korçës ku do xhironim filmin “Streha e re”. Sula kishte rolin e një fshatari, “Xha Ganon”. Duke e njohur bagazhin e tij, ju afrova dhe i thashë: ‘Profesor, unë e kam për herë të parë filmin ndaj dua ndihmën tënde sidomos para sheshxhimit’. Ai më mbajti afër më tha: ‘Ik në garderobë, merr rrobat e rolit dhe mbaj veshur ditë-natë që të përshtatesh me to’. Dhe unë kam ndjetur 6 muaj me rroba leshi në Dardhë”.



E mandej, kujton me nostalgji emra të tjerë të kinematografisë shqiptare. Sandër Prosin e konsideron një artist të madh. “Ata kanë qenë jo vetëm partnerët, por edhe mësuesit e mi. Kam luajtuar me Kadri Roshin, Ilia Shytin, Drita Pelingun, Ndrek Lucan, Margarita Xhepën, Pavlina Manin, Violeta Manushin” thotë Luftar Paja.

Megjithatë sukses i padiskutuar në karrierën e tij mbetet komedia, “Ëndërr për një karrige”...

“Është një kino-komedi. Ftesa më erdhi nga Femi Oshafi dhe Muharrem Fejzo, të dy kanë bërë filmin “Kapedani”. Kisha kënaqësinë gjithashtu të luaj një rol episodik tek “Gjigandi” i Viktor Gjيكës, me Dhimitër Anagnostin e shumë të tjerë.

ROLET EPISODIKE

“Kurrë nuk pata komplekse, pasi për mua s’ka role të mëdha e të vogla. Ka artistë të mëd-

henj dhe artistë të vegjël, tek rolet e mëdha apo të vogla. Mundet që me një rol të godasësh te spektatori dhe ai ta mbajë mend gjatë. Kinostudioja ka bërë një punë të paparë, jeta artistike gumëzhinte dhe me të gjitha peripecitë, bëheshin 14 filma në vit, filma që ndiqen edhe sot e kësaj dite.

ESTRADA E FIERIT...

Na ishin njëherë gjashtë vëllezër e një motër. Ata ishin aktorët Luftar Paja, Nestor Pogaçe, Fuat Boçi, Todi Llupi, Arqile Lipe, Sotir Stefa dhe Xhuljeta Kulla.

“Unë kam shumë role me Xhuljetën dhe Hasan Bregun. Më kujtohet një moment me Hasan Bregun dhe regjisorin tonë Koço Papalopulli. Pas çdo shfaqje, Koço n’a bënte vërejtje, ose komplimenta secilit prej aktorëve. Kur i erdhi rradha Hasanit, ai i tha: ‘Ti Hasan



je profesionist, por në skenë, po luan si një amator’. Hasani ia ktheu menjëherë: Po pse nuk më le të luaj si në Patos? (Unë dhe Hasani vinim nga Estrada e Patosit) ‘Në rregull, - i tha regjisori, - luaj si në Patos’. Të nesërmen pas shfaqjes, regjisorin n’a mblodhi prapë dhe kur i erdhi radha Hasanit, i thotë: ‘Hasan të lashë të luaje si në Patos dhe ti e menderose si në Patos’.

Por nga ndryshonte Estrada e Fierit, nga estradat e qyteteve të tjera?!

“Ka pasur 15 estrada profesioniste dhe 10 teatro profesionistë, secili me veçantinë e tij. Tano Banushi, babai i humorit, Paulin Prekaj, Zyliha Miloti etj, ishin nga Estrada e Shkodrës dhe kishin marrë përsipër të kultivonin humorin e Veriut. Durrësi kishte personazhet

“Akuzojnë djalin tim për biznesmen strategjik kur në ekonominë e tregut, ka të drejtë edhe artisti të marrë pjesë në biznes, është e drejta e tij. Portalet, për mua, e devijojnë realitetin shqiptar. Ç’të drejtë ke ti që më merr nëpër gojë? Ke fakte? Më hidh në gjyq, apo akuzoje në bazë të ligjeve”

e tij të talentuar që i udhëhiqte Gjergj Vlashi. Në Shqipërinë e Mesme, Estrada e Fierit kishte marrë përsipër koloritin myzeqar. Estrada e Sarandës dallonte nga të tjerët, kishte në qendër të vëmendjes parodinë me dy Thomatë, Milai dhe Gjoni (njëri regjisor dhe tjetri përgjegjës muzike). Ata ndërtonin spektakël me skeçe parodi. Edhe Vlora kishte koloritin e saj, Gaq Vishi, Leka Kruta, Myqerem Ferra që i pasuan parodistët e Vlorës, që kanë mbajtur gjallë humorin vlonjat’.

HUMORI SOT

Nëse vite më parë estradat e humorit bënin programin e Vitit të Ri, sot në ekranet shqiptare kemi tre programe humor që prodhojnë për publikun skeçe çdo javë. Por si e sheh Luftar Paja humorin e ditëve të sotme, ku një nga protagonistët kryesorë është edhe djali i tij Gazmend Paja.

“Nuk dua të ofendoj krijimtarinë e sotme dhe të ngre krijimtarinë e asaj kohe. Unë vërej se në shumë raste, nuk i bëhet analizë personazheve sepse çdo personazh duhet të ketë patjetër biografinë e tij. Personazhi duhet të vijë tek spektatori, me të mirat dhe të këqijat e tij.

Por cilin personazh i pëlqen të birit?

“Ashtu siç jam kritik për veten, jam dhe për Gazin. Unë e ndjek çdo të diel dhe në fund të çdo puntate i them: ‘këtu e ke neglizhuar, këtu e ke marrë seriozisht’. Gazi është aktor organik aspak i shtirur, aktori i shtirur s’është kurrë jetëgjatë.

Po aktorë të tjerë të preferuar a ka Luftar Paja?!

“Në ‘Portokalli’ bën një punë serioze për të përmirësuar figurat, Rezart Veleshja. Ka artistë që kanë nur skenik dhe i tillë është Marhin Orhanasi, edhe Xhoda është interesant. Nga ‘Klanifornia’ më pëlqen Alban Bogdo. Është aktor me bazament të fortë. Albano është nga ata aktorë që e demonstron talentin e tij pa pike, pa presje. Skena ka të mirat, por edhe të këqijat e saj, pasi të konsumon shumë. Agron Llakaj mbetet një aktor me bazament të fortë, do të më falin të tjerët por nuk kam mundësi t’i përmend të tërë.

SFIDO KUFIJTË E KREATIVITETIT BËHU PROFESIONIST

DIPLOMOHU NË PROGRAMET
HAIR ARTIST | MAKE UP ARTIST | ESTETIKË
MENAXHIM | SPA-ve DHE BIZNESIT TË BUKURISË

REGJISTROHU TANI

VITI I RI AKADEMIK 2021 - 2022



TESS | TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL KOLEGJ PROFESIONAL I LARTË

TESS është frymëzuar nga dëshira për ta bërë estetikën dhe të bukurën pjesë të jetës së përditshme, kudo. TESS është shkolla e parë, e vërtetë, e cila krijon profesionistë me njohuri të plota në programet e estetikës, hair artist, make up dhe menaxhimit në sektorin e bukurisë.

Kolegji Profesional i Lartë TESS është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 483, datë 31.07.2019 dhe është i organizuar në dy departamente:

- Departamenti i Estetikë-Nutricionit
- Departamenti i Kozmetologjisë

Kolegji Profesional i Lartë TESS është akredituar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si një Institucion i Arsimit të Lartë, në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akredimit nr. 04, datë 24/01/2020.

Programet e Kolegjit Profesional të Lartë TESS janë të licensuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si programe studimi profesionale me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike, pas arsimit të mesëm, në përfundim të të cilave do të merrni një Diplomë Profesionale me 60 ose 120 Kredite ECTS.

Adresa : Rr. "Gjeneral Nikols" Pallati Shushica, Kati 1, Tiranë, AL

tess.albania

TiranaEstheticsStyleSchool

Zbuloni më shumë në;
www.tess.al





 FRANC ZHURDA

Me aktorët e rinj kam kaluar shumë mirë dhe në bashkëpunime. Me ta, e harroj moshën, e ndjej veten të ri. Aktivizimi të mban gjallë, se çdo gjë ka kohën e saj. Është si gjella me kripë, e kripa me karar. Na ka ardhur një moshë që pjesëmarrjen në role, t'a bëjmë dinjitoze”.

E kishit imagjinuar veten që kur të vinit në moshën 80 vjeçare do të ishit përsëri në skenë e ngacmoj unë?!

“Artisti nuk njeh moshë, për mua artisti moshën kulminante e ka nga 40 e sipër sepse i plotëson të gjitha parametrat si fizike ashtu edhe mendore. Nëse do marrim moshën që kam unë tani, ndoshta e mendojmë fjalën përpara se ta nxjerrim me maturi, por parametrat fizikë nuk të lejojnë të bësh atë që ke bërë, kur ke qenë i ri. Skena ka nevojë për fëmijë, për të rinj, gjyshër dhe gjyshe. Do të marr pjesë së shpejti në filmin e Edmond Topit “Yjet e së ardhmes”, në serinë e dytë, ku kam interpretuar krah Margarita Xhepës dhe Tinka Kurtit.

LUFTAR PAJA DHE POLITIKA

“Mendoj se kam vepruar me korrektesë, dashamirësi dhe jo mendjemadhësi. I lumtur është ai artist që jep më shumë në art se në

Kudo që kam marrë pjesë me aktorët e rinj kemi patur një atmosferë shumë të mirë. Me këta të rinj e kam harruar moshën, e kam ndjerë veten të ri. Aktivizimi të mban gjallë çdo gjë ka kohën e saj. Për çdo gjë është si gjella me kripë e kripa me karar. Na ka ardhur një moshë që atë pjesëmarrje që ta bëjmë të jetë dinjitoze

politikë. S'jam nga ata njerëz që lejoj të shfrytëzohem nga politika. Edhe kur kam qenë deputet, e thosha fjalën si e mendoja. Këtë ua kam këshilluar dhe fëmijëve. Pavarësia të nxjerr në dritë. Meqë po më jepet rasti po e them: akuzojnë djalin tim për biznesmen strategjik kur në ekonominë e tregut, ka të drejtë edhe artisti të marrë pjesë në biznes, është e drejta e tij. Portalet, për mua, e devijojnë realitetin shqiptar. Ç'të drejtë ke ti që më merr nëpër gojë? Ke fakte? Më hidh në gjyq, apo akuzoje në bazë të ligjeve”.

Mërziteni kur dëgjoni të tilla fjalë?
“Shumë, sepse s’jam mësuar me spekulime. Këtë porosi i kam dhënë edhe Gazit: kur të akuzojnë, duhet të kesh këtë përgjigje: Vepropa sipas ligjeve të shtetit shqiptar dhe kush ka paqartësi t’i drejtohet studiove ligjore”.

HISTORIA E DASHURISË QË NISI NË PATOS

Me bashkëshorten Qamilen, ka një histori të bukur dashurie. Siç është shprehur ajo në një intervistë për mediat kohë më parë, jeta e tyre ka qene një estradë me grindje, të qeshura, zënka, këngë, lexime, diskutime, debate deri në kokëfortësi të njëanshme, por gjithnjë në emër të një gjëje: lumturisë së fëmijëve.

“Bashkëshorten e kam njohur në Patos, ajo ishte gjimnaziste. Qamija vjen nga një familje modeste, naftëtare me orgjinë nga Libohova. Nëna e saj punonte në Pallatin e Kulturës së Patosit ku unë isha një nga amatorët e dalluar. Sapo kisha mbaruar një shkollë 1 vjeçare për aktor (dhe këtu gjej rastin të bëj homazh për artistin e madh Andrea Malo, Pjetër Gjoka dhe Selman Vaqarrin këta kanë qenë pedagogët e mi të parë, ndërsa në praktikë ka qenë një shofer me orgjinë nga Shkodra, Ndreko Ndoja). Patosi ishte më i kualifikuar se Fieri atëkohë, se në naftë kishte inxhinierë që kishin mbaruar jashtë shtetit. Kombinati i naftës kishte një gjallëri artistike të jashtëzakonshme. Në Patos për herë të parë kam parë Ansamblin Berioska, që ishte në atë kohë në kulmin e tij.

Qamilja vinte tek mamaja e vet. E simpatozoja, por nuk guxojta t’i afrohesha. Futa mik një kolegun tim: ‘do t’i thuash nënë Xhemiles që dua vajzën e saj?’ Ai tha: ‘e zgjidh unë këtë punë’. Ishte një dashuri me shikim të parë dhe të stërparë, por nuk arrija t’i afrohesha.

Qamilja ka qenë një bashkëshorte bashkëpunuese, por edhe kritike. Gëzohej kur unë dilja mirë dhe hidhërohej kur bëja ndonjë gabim në skenë”.

PAK PËR FËMIJËT DHE

“MJALTIN E MJALTIT” TË LUFTAR PAJËS

“Fëmijët më kanë ndjekur gjithnjë, madje Gazin e kam nxjerrë në skenë që në moshën 4 vjeçare. Kam edhe djalin tjetër, Sokolin, që për



humorin e tavolinës është i jashtëzakonshëm. Ai më imiton mua në rolin e Çobo Rapushit me shokë... Djali i Sokolit, Alson, mbaroi shkollën për artin dramatik dhe tani punon tek Alfa Tv. Kështu që tradita vazhdon...

Vajza ime Nikoleta jeton në Greqi, ka mbaruar një shkollë ushtarake dhe sëbashku me bashkëshortin janë kapitena në rezervë.

Do të bëhem së shpejti edhe stërgjysh. Prindërit e mi nuk e arritën këtë ditë ndërsa unë jam më i lumturi që po e përjetoj këtë emocion. Kam një lidhje të jashtëzakonshme me nipërit dhe mbesat. Mjaliti i mjalitit është më i mirë se mjaliti”, përfundon rrëfimin e tij Luftar Paja.



TIRONA KAMPIONE

**FESTA E MADHE E
FAMILJES BARDHEBLU
NË 26 MAJ**

Një festë e madhe plot fishekzjarrë, me këngëtarë që nga ata modernët që i japin kolorit të ndryshëm festimeve e deri tek e mrekullueshmja Artjola Toska me këngët e Tiranës. Data 26 korrik do të kthehet në një festë të madhe për klubin bardheblu, ku do të marrin të 26-in zyrtarisht, e të 29-ën për tifozët. Sapo arbitri t'i bjerë bilbilit, shtëpia bardheblu "Selman Stermasi" do të kthehet në një diskotekë gjigande për të festuar me kampionët. Te Tirana kishin dashur që këto festime të bëheshin në sheshin "Skënderbej", por nuk morën dot leje nga aksioneri i dytë, bashkia Tiranë: shkak, finalja e Conference League që do të luhet në "Arenën kombëtare" në 25 maj. Te Tirana, edhe pse rrudhën buzët, nuk u mërzitën. Fundja, kanë shtëpinë e tyre. Aty do të presin me mijëra vetë që do të festojnë me kampionët, në një natë të paharrueshme



NGA RETIN TOKA

Sezoni kishte përfunduar dhe duhej harruar shpejt për të nisur puna për edicionin e ri 2021-2022. Merkato e verës kishte trokitur qysh në fillim të qershorit. Në çdo shtëpi tironse, një copëz të tavolinës e merrte ekipi më i titulluar në Shqipëri. Kush do të largohet dhe cilët do të ishin "prurjet" e reja? Askush nuk i dinte, paçka se presidenti Refik Halili kishte "pikasur" prej kohësh ata që do të plotësonin organikën e skuadrës. Boshti nuk do të ndryshohej, do të ishte po i njëjti. Mu në mes të kryeqytetit, sapo nis "Rruga e Dibrës", 200 metra në të majtë ndodhet stoike, vila "Gold".

Edhe në familjen Halili diskutimet ishin të shumta sepse në këtë sezon nuk mund të dështojë. Dikur i vetëm, por sot me dy fëmijë të mrekullueshëm në mbështetje, presidenti e ndjente veten më të fortë. "Këtë vit do të bëjmë gjëra të bukura,



Refik Halili me fëmijët, Goldi dhe Grenti

jam i bindur”, mendonte me vete Halili. Tanimë të rritur, në moshë madhore për të vepruar, për të injektuar pa kushte gjithçka kishin mësuar dhe parë në botë, Goldi dhe Grenti.

Futbolli, traditë familjare, pjesë e rëndësishme e jetës së kësaj familje tironse që ka sakrifikuar nga të ardhurat personale vetëm që të shohë në piedestal këtë klub. Ndryshe nga vitet e shkuara, këtë herë presidenti do t'i besonte familjes së tij. Nëse mirësinë ia kishin marrë për dobësi, tanimë ishte koha të tregonte se çfarë frytësh kishte korur duke bërë dashur pa dashur pjesë të futbollit edhe vajzën e tij, Goldin. Lotët dhe buzëqeshja e saj ishin në simbiozë të vazhdueshme me performancën bardheblu. Studiuar dhe rritur në Amerikë, padyshim që edhe te Tirana do të sillte aromën ndërkombëtare.

Në Shqipëri, skeptikët të turren dhe të vënë këmbën në fyt kur shohin mungesë rezultati, por kur je mirë zhduken pa lënë gjurmë, a thua se nuk kanë ekzistuar kurrë. E rritur në familje bardheblu, Goldi e dinte fare mirë këtë. Megjithatë karakteri i fortë i asaj vajze, ambicia për t'ia dalë gjithmonë mbanë mposhti çdo kritikë dhe në fund tregoi se e drejta gjithmonë triumfon. Me kalimin e kohës kuptoi që peshën që i ati mbante mbi supe, duhej ta ndante me të dhe të vëllanë. Ishte koha dhe momenti i duhur në vendin e duhur. Bashkë me Grentin, arritën të krijojnë një atmosferë që s'kishte qenë kurrë në klubin bardheblu.

Ditë-natë duke punuar për të mbajtur sa më të bashkuar të gjithë familjen dhe çdo gjë të zgjidhej brenda për brenda. Dështimi s'ishte pjesë e fjalorit.

Çdo mëngjes kishin pasur fatin të zgjoheshin dhe te vila e tyre të numëronin trofetë e këtij klubi që ka bërë historinë në futbollin shqiptar, të kësaj skuadre që në ADN ka vetëm fitoret. Nuk folën në asnjë moment, përkundrazi këtë edicion futbollistik preferuan të tregonin veprat. Nuk kishte rëndësi për ta vlerësimi. Në fund të ditës, “famëkeqët” do ta gjenin diçka për të kritikuar apo mos i pëlqyer.

LARGIMI NGA FUTBOLLI, VENDIMI I VËSHTIRË NË FAMILJEN HALILI

Grenti përshkruante i menduar cep më cep dhomën e ndjenjës. S'e kishte menduar se ajo ditë do të vinte aq shpejt. Ishte rritur me ngjyrat bardheblu, pasioni për këtë skuadër shkrihej me dëshirën për të dhënë kontributin e tij në çdo fushë, qoftë dhe në atë të blertë. Momenti më i vështirë i jetës së tij kishte ardhur. I ati dhe “Tirona” kishin më shumë nevojë

në fushën menaxheriale. “E kam vendosur, do ta lë futbollin”, ishin fjalët e Grentit. Në familje të gjithë panë njëri-tjetrin. Ishte vendim i vështirë, ndoshta shumë pak e kishin menduar. Por, njerëzit e mëdhenj kërkojnë të shohin gjithmonë në gjerësi. Në aspektin personal, Grenti kishte fituar gjithçka. E kishte veshur për disa vite fanellën bardheblu. Kishte ngritur trofeun e kampionit. Tanimë ishte momenti për të dhënë kontributin e tij në një pozicion tjetër. “Horlliqet” e një familje i dijnë vetëm ata që janë pjesë e saj. Kësisoj, i lindte detyra për të riparuar çdo problem që kishte hasur, veçanërisht prioritet Akademia e Tiranës, aty ku lindin filizat për të kontribuar dhe pasuruar arkën e klubit bardheblu. Vendimin e tij ia komunikoi edhe futbolldashësve shqiptarë. Ishte emocionues, ashtu siç Grenti dinte ta bënte. Ndër të tjera mes rreshtash kishte zgjedhur të shkruante: “Tërhiqem nga loja e futbollit si lojtari i klubit më të MADH në Shqipëri! Premtoj dhe betohem që tërhiqem nga ky klub vetëm si lojtar, ama në një të ardhme në një pozicion tjetër, nuk do tërhiqem ASNJËHERË!”

MERKATO E VERËS, AFRIME FANTASTIKE TE KAMPIONËT E SHQIPËRISË

Nëse në fushë i kushtonte më shumë vëmendje topit dhe skemave të trajnerit, jashtë saj Grenti tregonte maturinë e një djali të rritur. Çdo vendim nga presidenti Halili ishte me miratimin e vazhdueshëm të të birit. E dinte mirë se ku ishin boshllëqet e Tiranës. Nëse si lojtar i duhej të ruante shoqërinë e të ulte kokën si



Gold dhe Grent Halili

“Këtë vit do të bëjmë gjëra të bukura, jam i bindur”, mendonte me vete Halili. Tanimë të rritur, në moshë madhore për të vepruar, për të injektuar pa kushte gjithçka kishin mësuar dhe parë në botë, Goldi dhe Grenti

futbollistët e tjerë, tanimë në pozicion drejtuesi duhej të vepronte me gjakftohtësi duke ndarë pasionin nga profesioni. Shumë emra ishin përfolur në media, por në kryeqytet ende s’kishte asnjë zhvillim konkret. Skuadra e edicionit të ri do të niste fillimisht nga rinovimet. Boshti ishte shumë i rëndësishëm. Largimi i Bathës kishte krijuar hendek të madh. Por, te Tirana e kishin zgjidhur shpejt. Emri i madh ishte Vesel Limaj, mesfushor që kishte lënë përshtypje pozitive te Kukësi. Pa një, pa dy, mbërriti në kryeqytet duke u bërë afrimi i parë i ekipit më të titulluar në Shqipëri. Pas tij, pasuan dhe mjaft emra të rëndësishëm si Ëngjëll Hoti, Realf Zhivanaj, Florjan Përgjoni, Redon Xhixha, Enur Totre, Majkell Ngo, Gentian Muça. Një pjesë e mirë e tyre zunë vendin e titullarit dhe fituan besimin e trajnerit Orges Shehi si dhe të stafit teknik.

PREZANTIMET TE TIRANA, RISI NË KLUBIN BARDHEBLU

Nëse dikur mjaftonte një fotografi dhe disa rreshta për të njoftuar marrëveshjet në klubin bardheblu, tashmë ishte koha për ndryshim. Çdo gjë dhe çdokush do të kishte vëmendjen e merituar. Kësisoj, Goldi futi një risi në klub që s’ishte parë në asnjë ekip në Shqipëri. Nëse në Europë, lojtarët prezantoheshin në mënyrë spektakolare, diçka e tillë u servir edhe te Tirana. Me ide brilante, krejt origjinale Tirana dhe Goldi tërhoqën vëmendjen e tifozëve, por edhe të kundërshtarëve. Kishte shumë nga ata që shpreheshin: “Po, po për kshu ngjyra-ngjyra janë të parët. Po n’fushë kena me pa”. Të jesh pjesë e Tiranës, presioni është padyshim i madh. Dhe këtë e dijnë të gjithë, nga presidenti Halili e deri te punëtorët e fushës. Me një buzëqeshje në fytyrë, Goldi dukej se donte t’i jepte përgjigjen: “Po, aty kena me u pa”. Por, heshte sepse kujdeset në maksimum që të shmangë polemikat, keqkuptimet. Ajo s’do të ndalej me aq sepse gjatë sezonit do të kishte plot surpriza të tjera.

IMAZHI, SEKTORI I VEÇANTË TE TIRANA

Nëse përmend fjalën imazh te Tirana, emri i parë që të vjen në mendje është Izmir Doda.

Dibrani i qëndroi besnik klubit bardheblu. Erdhi para disa vitesh si i panjohur në fushën e futbollit, por tanimë me fotografitë e tij e ka çuar në dimensione të tjera skuadrën më të titulluar në Shqipëri. I vetëm për një klub kaq të madh, Izmiri s’mund t’i bënte të gjitha. Goldi, si detajiste, kuptoi se duhej staf i zgjeruar për të bërë të tjera gjëra të bukura. Nëse kundërshtarët apo rivalët e përjetshëm luftojnë për të gjetur një fushë ku të luajnë, te Tirana ka marrë kuptim fjala klub. Tanimë janë shtuar edhe disa djem të cilët përmes aparaturave të ndryshme, krijojnë video të veçanta si gjatë seancave stërvitore, ashtu edhe në ndeshjet e sezonit. Asnjë detaj nuk mund të shpëtojë më. Projektet e Goldit në kokë shkojnë paralel me trofetë e Tiranës së kryeqytetit shqiptar. “Reels”-at e ideuara prej saj padyshim kanë afruar më shumë tifozërinë me skuadrën bardheblu, por edhe i kanë dhënë ton bardhebluve në aspektin e imazhit. Shumë mbështetës, goftë edhe kundërshtarë, i shohin ato për të marrë pjesë në tendencat kulturore duke zbuluar idetë e reja të Tiranës.

ORGES SHEHI DHE SEZONI FUTBOLLISTIK

Që kur pranoi detyrën e trajnerit te Tirana e dinte se do të kishte shumë bërëryla. I mësuar të fitojë në fushë si lojtar, Shehi e ndiente se kishte ardhur momenti ta bënte edhe si drejtues skuadre. Mori përsipër një detyrë mjaft të vështirë. Por, si lojtar kampion do ta sprovonte veten. Erdhi te Tirana në mes të sezonit të shkuar. E dinte se kishte punë përpara. Do të bashkëpunonte me njeri të urtë si Refik Halili, por i dashuruar përjetësisht me familjen bardheblu. Për gjysmën e dytë të edicionit të shkuar e dinte se nuk mund të bënte premtime sepse skuadra s’ishte formuar nga ai. Megjithatë piketoi lojtarët me të cilët do të formonte grupin e titullarëve. Duke u përforcuar në merkaton e verës, arriti të

krijonte një skuadër simpatike. Taulanti (Seferi) u shndërrua në një makineri të vërtetë. Limaj u bë “doktor” i mesfushës, kurse Totre “regjisori” i saj. Ardit Toli i pandalshëm, sa në një cep të fushës, në tjetrin. Redon Xhixha, këmbëshpejtë që i humbte nga sytë kundërshtarëve, prapavija e pakalueshme. Çfarë ekipi fantastik. Lidhen me njëri-tjetrin me sy mbyllur. Shehi ka arritur ta bëjë të funksionojë si e tërë. Meritë e madhe për trajnerin durrsak që nuk përmend në asnjë moment fjalën titull për të mbajtur me këmbë në tokë ekipin. Edhe pse pas ndeshjes së dytë të fazës së dytë kishte nisur të besonte te titulli kampion, ai i dribloi mjaft bukur mediat duke ulur presionin në skuadër. Pas barazimit në fazën e dytë me Vllazninë ishte hasur me kritikën e drejtuesve, por në një klub kampion, çdo hall mbetet brenda shtëpisë dhe çdo gjë ishte zgjidhur aty për aty.

DERBI I KRYEQYTETIT, “HAKMARRJA” E FTOHTË DHE TITULLI KAMPION I TIRANËS

Tirana e kishte vrarë kampionatin, po në fundin e saj skuadra lëshoi disi. Kundërshtarët apo dhe “ekspertët” e studiove nisën nga kritikën. Kishte nga ata që besonin se bardheblutë e kishin shtyrë për të siguruar matematikisht titullin kampion në derbin kundër Partizanit. Si në çdo përballje me rivalin e përjetshëm, kontestimet janë prezente që kur nis organizimi i saj. Fillimisht u bë çështje stadiumi e më tej mungesa e tifozëve në Elbasan. Megjithatë te Tirana vëmendja kryesore ishte në fushë. Në dëshirën e çdo tifozit ishte trofeu përballë rivalit të përjetshëm. Ndeshja nisi si mos më keq për Tiranën teksa pësuan golin e parë si dhe ishin inekzistentë në fushë në 20 minutat e para. Por,

ekipi mblodhi forcat dhe bëri një përmbysje të madhe. Bardheblutë triumfuan 2-1 dhe zyrtarisht Tirana ishte kampione e Shqipërisë. Dy gëzime në një ditë. Fitorja ndaj kundërshtarit të përjetshëm si dhe trofeu i 26-të në historinë e futbollit shqiptar për skuadrën kryeqytetase.

TIRANA, DASHURIA PA KUSHTE E REFIK HALILIT

Sikurse Tirana fitoi në ndeshjen e fundit kampionatin me Partizanin, ashtu edhe Refik Halili ka gjithë hapësirën e nevojshme në fund për t’u trajtuar si presidenti kampion. Jo më kot thonë që “ëmbëlsirat” lihen për në fund. Është ky njeri i urtë tiron, siç e quajnë gjithë miqtë e tij më të afërt. Presidenti i klubit më të titulluar në Shqipëri që fjalën e idhët e ka shumë të vështirë ta nxjerrë nga goja. Shumë mund të kenë përfituar nga urtësia e tij, por është mjaftuar duke thënë: “S’ka gajle. Herët a vonë gjitha vihen në vendin e vet”. Dhe koha duket se i ka dhënë të drejtë.

Ndër të paktët që ka shpenzuar qindarkën e fundit për familjen e madhe bardheblu. Nuk është vetëm president i Tiranës, por tifoz i zjarrtë i saj. Njeriu që prej vitesh rropatet të paguajë borxhe të mbartura, të lëna nga drejtues të tjerë. Asnjëherë s’u dorëzua, gjithmonë optimist. Ia ka dalë, ka paguar miliarda lekë borxhe e dalëngadalë Tirana po del nga gropa e madhe. Tanimë me dy bashkëpunëtorë specialë, Goldin dhe Grentin, padyshim që ndihet më i qetë. Politika e përdorur këtë sezon ishte spektakolare. Jo vetëm paga, por edhe premio për të impenjuar maksimalisht lojtarët në sfida të veçanta.

Për vajzën dhe djalin u shpreh: “Ata u rritën me Tiranën. Edhe Grenti punoi mjaft kohë dhe mori eksperiencë. Përfundon më shpejt zgjidhja kur ulet djali i presidentit dhe drejtori sportiv. Në të ardhmen do të jenë gjërat më mirë, do të vazhdojmë të ecim përpara. Kam shumë besim te grupi dhe stafi”. Për të gjithë që nuk i njohin, Goldi është një vajzë mjaft ambicioze. Në rolin e administres te kampionët e Shqipërisë, ecën paralelisht me 3 maksima: “Të shohësh është të dish, të dëshirosh është të mundesh, të guxosh është të kesh”. S’mbetet gjë tjetër veçse të ngrihemi në këmbë dhe të duartrokasim: Urime, ekipit kampion!

Në të ardhmen do të jenë gjërat më mirë, do të vazhdojmë të ecim përpara. Kam shumë besim te grupi dhe stafi”. Për të gjithë që nuk i njohin, Goldi është një vajzë mjaft ambicioze



Refik dhe Gold Halili



FORMULA e majit... *ngjyra*

Më ndodh vetëm mua apo edhe juve që kur qëndroni përpara garderobës tuaj nuk jeni aspak të inspiruar?! Nuk e di pse po e nis pak si depressive këtë shkrim kur sapo jam kthyer nga një udhëtim në Madrid, qytetin më solar dhe mbi të gjitha me njerëz shumë stil. Ajo që më bëri përshtypje në Spanjë është se ndryshe nga Tirana, në Madrid nuk shihje dy njerëz të veshur njësoj, ama një gjë ishte “ligj” (I pashkruar) shumë ngjyra. Nuk është se po themi ndonjë gjë të re sepse këtë pranverë/verë do të verbohemi nga ngjyrat, por mirë është që herë pas here të kemi në garderobën tonë dhe veshje, ngjyra apo edhe të ricklojmë... se jo për gjë por me blerje çdo muaj nuk ja dalim dot... (dhe këtë ua them unë që jam njeriu që nuk e di se sa shumë shpenzojë për veshje)

XHAKETA FUSTAN

Për ditët e pranverës kur gjithçka që ju nevojitet është një xhaketë e lehtë, pse të mos e vishni në fakt xhaketën tuaj si fustan? Duket perfekt me çizme, atletet retro, etj. Me këtë rast do t'i kursenit vetes shumë kohë përpara dollapit... Më besoni.





SHAJE, SHAJE, **KUDO...**

Është periudha ideale për t'i përdorur shajet, qoftë në kokë qoftë edhe si aksesore të veshjeve. Një variant shumë interesant do të ishte ta lidhnit një shall me ngjyra rreth belit, jo vetëm që thekson format tuaja por nga ana tjetër e bën veshjen tuaj të duket akoma edhe më stil.



KOMBINIMI I GJYSHJEVE

Gjyshet tona dilnin nga shtëpia pa kombinuar çantën me këpucët, por ky rregull stili që atëherë është zbehur në popullaritet sepse askush nuk pëlqen të duket kaq i rregullt në veshje, por të eksperimentojë më së shumti me look-un e tij. Por si çdo gjë në botën e modës që rikthehet edhe ky trend do të rikthehet këtë verë...



FUQIA E ROZËS

Nuk ka gjë më të bukur dhe të ëmbël se sa të rikthehesh tek ngjyra rozë. Rozë të fortë, të lehtë ose si të doni vetëm mos harroni që në garderobën tuaj kjo ngjyrë nuk duhet të mungojë.



KAPELET E PESHKATARIT

Këtë vit do ta vendosim të gjithë fokusin tonë tek kapelet e peshkatarit. Kjo formë kapeleje është krijuar fillimisht për peshkatarët irlandezë për të mbajtur shiun nga sytë e tyre, ndërsa pjesa me lidhëse nën mjekër është përdorur për të mbrojtur qafën e trupave në vitet 1940 gjatë Luftës së Vietnamit dhe ja tani mund t'i veshin bloggerët dhe influencersit e modës.

PUPLA

Detajet e puplave janë rikthyer prej kohësh në modë, por mos u çudisni nëse i shihni edhe përgjatë këtij sezoni veror. Nuk është e nevojshme të përdorni modalitetin e plotë të puplave të Carrie Bradshaë personazhit më interesant të "Sex and the City", por një detaj ose zbukurim me pupla e bën çdo veshje aspak të mërzitshme.

SYZET OVERSIZE

"Jashtë" liste mbetën syzet e diellit për adoleshentë. Ashtu si tendencat e tjera të modës së pranverë/verë, syzet e diellit me përmasa të mëdha vijnë si nostalgji e viteve '70. Nga aviatorët e deri të nuancat retro sportive këto do të jenë aksesori që do të mbulojë fytyrën tuaj.



"INJEKTONI" VIT C

Vitamina C nuk na duhet vetëm në dimër, por edhe në verë. Që të kuptohemi këtë herë e kemi fjalën për ngjyrën portokalli që nuk duhet të mungojë në garedorëbën tuaj. Sipas bloggerëve dhe stilistëve të modës është ngjyra e pranverë/verë 2022.

FUSTAN KËMISHA


Të lehta dhe elegante, fustan këmishat janë stili klasik më i pamposhtur pranveror. Falë shkathtësisë suaj një këmishë e gjerë me mëngë të gjata mund të futet gjithashtu në xhinse ose të vishet e hapur mbi rroba banje si një mbulesë plazhi.



© COPYRIGHT

Nga KADRI VOKOPOLA

KINOFJALËKRYQ



HORIZONTALE


1. Në krye të tabelës.
3. Satelit i Jupiterit.
4. Kilmer aktor.
7. Thirrej Caput Mundi.
10. O' Neal e *Paper Moon*.
12. Është planet i kuq.
14. Kështu fillon liria.
15. Ente Urbane.
16. Parker regjisor.
17. Tri të parat në sondazh.
18. Është shahu i fundit.
19. Qendër banimi.
20. Kështu thirret Rrethi çiklistik i Francës.
26. Inicialet e Adjani.
27. Aktorja në foto.
28. Carvalho i Manuel Vázquez Montalbán.
32. Aktori në foto.
33. Luhet në festivalin e këngës në RTV.
37. Në krye të klasifikimit.
38. Sonte pa kufij.
39. Kufizojnë një forum.
40. Piktori i *Figurale Blätter*.
41. Armstrong që shkeli i pari në Hënë.
42. Fleming që krijoi James Bond.
44. Samba_ e Carlos Santana.

45. Hummels mbrojtës gjerman.
46. Franco që përfundoi *Turandot*.
49. Franceso, ish-as te Roma.
51. Kush është... është kundër.
53. Gjëndrat që preken nga sindroma Basedoë.
57. Unë... në Itali.
58. Sergio që qe regjisor.
59. Jannik tenis.
60. Mbyllin një manastir.

VERTIKALE

1. Qe muza e komedisë.
2. As ne as ju.
3. Të fundit në takim.
4. S. S. që krijoi Philo Vance.
5. Kështu fillon argumenti.
6. Kufijtë e lëvizjes.
7. Qendër kurimi.
8. _culpa, për atë që pranon fajin.
9. Kanë bërë veprën.
10. Në këtë çast.
11. I pari është ai sipas Mateut.
12. Jean që u mbiquajt Babai i Europës.
13. U shkrua nga André Gide.
14. George i *Star Ëars*.

17. Alexis, bomber kilian.
18. Magjistari i _ Park, siç thirrej Thomas Alva Edison.
21. Zellëgger aktore.
22. Ente Financiare Tiranë.
23. Samuel i *Duke pritur Godot*.
24. Universal Gcode Sender.
25. Teke larve.
29. Stone aktore.
30. Kështu fillojnë punimet.
31. Ente Zyrtare Përmet.
32. Është segment me drejtim të caktuar.
34. Ai në pasqyrë.
35. Janë trofe sportive.
36. Morisette këngëtare.
39. Është takimi që luhet për trofeun.
41. Campbell top model.
43. Është Otan për francezët.
45. Kufizojnë mjetet.
47. Gjysmë e linjës.
48. Një... gjerman.
50. Tiriac ish-tenist.
52. Unë dhe ti.
54. Fillon nga fundi.
55. Në krye të detyrës.
56. Të fundit në tender.



MOJ E BUKURA SHQIPËRI!

HORIZONTALE

1. Field_ racë qeni.
6. Gjysmë pasimi.
8. Fillojnë takimin.
9. Richard Strauss.
11. Një ushtarak në parakalim.
12. Steëart këngëtar.
14. Një lidhëz.
16. Skuadra merengue.
18. Inicialet e Pacino-s.
19. Boris Godunov.
21. Agjenci Doganore Fier.
24. Përfundojnë pingul.
25. Paul që këndon *Diana*.
26. Kaluar në krye.
27. Foto 1.
32. Foto 2.
33. Dy romake.
34. Gjysmë rakete.
36. Foto 3.
37. Jashtë... në Londër.
39. Kufizojnë ambiente.
41. Kërkojnë talent.

43. Është i babëzitur.
45. Baker i *The Mentalist*.
48. Të parat në sondazh.
49. Mund të skadojë.
51. Jetojnë edhe në Osijek.
53. Mbarojnë fare.
54. Një ishte Nanak.
55. Gjysma e normës.
57. Kastile në fund.
58. Shkroi *Jeta e Jezusit*.
61. Khachaturian kompozitor.
62. Foto 4.
66. Me të bëjnë tytë.
67. Në krye të familjes.
68. Shahu i fundit.
69. Ekstreme ekstremi.
70. Ai i Kuq u hap për hebrenjtë.

VERTIKALE

1. Këngëtare kolumbiane.
2. Flet ex cathedra.
3. Me të nxjerrin tapë.
4. Të fundit në tender.
5. Kështu fillon lodhja.
7. Në hyrje të sallës.
8. Një që premtan të bëhet kampion.
9. Magritte që qe piktor.
10. Janë vazo.
13. Ishte nëna e Perseut.
15. Kotel, në Tempullin e Jerusalemit.
16. Toronto_në NBA.
17. Nota e diapazonit.
19. Është gjaku i aristokratëve.
20. Kishte një unazë që e bënte të padukshëm.

22. Carpe_ thënie e Horacit.
23. Opera e vetme e Beethoven.
28. Ndizet për lutje.
29. Mund të jetë kuzhine.
30. Në Paris kur s'është ai.
31. Qendër mësimi.
32. Laik kur s'është ai.
35. Inicialet e Einstein.
38. Ughi violinist.
40. O'Neal e *Paper Moon*.
42. Një ekspres në binarë.
43. U vra nga Charlotte Corday.
44. Ekstreme në kufi.
45. Ekstreme në sirtar.
46. Ai i muzave ishte Helikona.
47. Unë dhe ti.
49. Ishte komandanti i jeniçerëve.
50. Film i David Ayer.
51. Një mund të jetë monstroz.
52. Gjysmë trofeu.
53. Një mund të jetë i rrallë.
55. Parafjalë prejardhjeje.
56. Qendër për roja.
59. Ente Rajonale Durrës.
60. Ndërmarrje Ekonomike Elbasan.
63. Robert Altman.
64. Në fund të vitit.
65. Fund tuneli.





HARD SUDOKU

				3				
1		9			6	8		
		2		1				
		1		4	2		5	3
3		4	7			1		2
7								8
4		6						
	8		5			4		
							9	

MESATAR SUDOKU

8								7
2		1	4	8	3			
	6					3		
		7		2				
4							3	
			9		5			
					1		9	
			5	3	4	2	6	
	1		6			4		

I LEHTË SUDOKU

	6			9			2	
		9					4	6
8			7					
5					3			
	9		1	4		5		
		1			6			8
	3			2		9		7
	1	6			9			
	5		3					



KURIOZITETE

PSE VENDI NGA KU NISËT PILOTI I KLASIFIKUAR I PARI NË PROVA QUHET POLE POSITION?

Sepse ky term pra pole (shtyllë) dhe positon (pozicion) është huazuar nga gara aëropilozimit, ku për t'i mbajtur kuajt në një linjë në start, ishte vendosur një shtyllë në të cilën lidhej litari që shërbente për t'i mbajtur kuajt në një linjë. Në fakt deri në vitet '30 të shekullit të kaluar përcaktimi i vendeve të nisjes në garat e automobilizmit bëhej me short, ndërsa provat zhvilloheshin thjesht për njohjen e pistës nga pilotët dhe kontrollin e gjendjes së makinave para garës. Çmimi i

fundit i madh ku renditja u vendos me short ishte ai i 26 marsit të vitit 1933 në Tripoli ku në vend të parë u nis Tazio Nuvolari me makinën e tij Alfa Romeo. Futja e provave kronometrike zyrtare për përcaktimin e vendeve të nisjes (që fillonte nga shtylla anës pistës, pra pole) daton 23 prill 1933 në pistën e Monakos dhe kjo për meritë të monegaskut Antony Noghès. I pari pole position në histori pra, sa për kronikë, i takoi në atë Grand Prix pilotit Achille Varzi me makinën Bugatti Tipo 51.

PSE PËR TË TREGUAR NJË AKTIVITET QË BËHET PËR DËSHIRË APO PASION THUHET PËR HOBBY?

Është e qartë që vjen nga anglishtja dhe bëhet fjalë për formën përkëdhelëse të emrit Robin, që fillimisht u përdor për të treguar një lloj kali race të vogël irlandez e më pas kalin e vogël tipik të drunjtë me të cilin zbavitën fëmijët e vegjël e që nga hobbyhorse u reduktua thjesht në hobby. E pikërisht duke pasur parasysh këtë fakt, pra zbavitjen me kalin e drunjtë apo edhe zbavitjen me kalin e vogël në karusel, termi zuri vend në fjalorin e përditshëm dhe nga shumë vende të tjera për të treguar fillimisht zbavitje e më pas edhe aktivitete që bëhen për qejf apo për të kaluar kohën.

PËRGJIGJET

PËRGJIGJE KINOFJALËKRYQ



PËRGJIGJE MOJ E BUKURA SHQIPËRI!



PËRGJIGJE HARD SUDOKU

5	7	8	2	3	9	6	1	4
1	3	9	4	7	6	8	2	5
6	4	2	8	1	5	3	7	9
8	6	1	9	4	2	7	5	3
3	9	4	7	5	8	1	6	2
7	2	5	1	6	3	9	4	8
4	5	6	3	9	7	2	8	1
9	8	7	5	2	1	4	3	6
2	1	3	6	8	4	5	9	7

PËRGJIGJE MESATAR SUDOKU

8	5	3	2	6	9	1	4	7
2	7	1	4	8	3	6	5	9
9	6	4	1	5	7	3	8	2
5	9	7	3	2	6	8	1	4
4	2	6	7	1	8	9	3	5
1	3	8	9	4	5	7	2	6
6	4	2	8	7	1	5	9	3
7	8	9	5	3	4	2	6	1
3	1	5	6	9	2	4	7	8

PËRGJIGJE I LEHTË SUDOKU

1	6	3	8	9	4	7	2	5
2	7	9	5	3	1	8	4	6
8	4	5	7	6	2	3	9	1
5	8	4	2	7	3	1	6	9
6	9	7	1	4	8	5	3	2
3	2	1	9	5	6	4	7	8
4	3	8	6	2	5	9	1	7
7	1	6	4	8	9	2	5	3
9	5	2	3	1	7	6	8	4

DASHI



Tashmë Jupiteri ka hyrë me prepotencë në shenjën tuaj dhe duke stimuluar forcën tuaj të karakterit. Jeni shumë të prirur për t'u marrë me fushën sentimentale dhe duket se keni lënë pas dore gjëra më të qenësishme të karakterit ekonomik apo profesional. Mundohuni të evitoni situata të tensionuara në raportet me kolegët pasi Marsi në shenjën ju sjell një dozë agresiviteti në momente të caktuara. Në planin profesional është Merkuri ai që rrit ndjeshëm kreativitetin tuaj.

DEMI



Në përgjithësi ju që i përkisni kësaj shenje do të jeni nën egjden e yjeve pozitivë, prandaj parashikohet një periudhë relativisht e mirë. Do të jeni shumë aktivë dhe të motivuar për të arritur objektivat tuaja, ndonëse, për shkak të Saturnit, ritmi do të lërë disi për të dëshiruar. Në planin ekonomik keni nevojë për mbështetje apo ndihmë, por hezitoni t'i drejtoheni miqve apo të afërmeve që mund t'ju ndihmojnë. Shëndeti mirë, por duhet një dietë e shëndetshme dhe ushtrimet fizike.



PESHORJA

Duket se për ju pritët një periudhë vërtet e vështirë, por ngaqë jeni të mësuar me situata deridiku të ndërlikuara, nuk ju bën edhe aq përshtypje. Nga njëra anë Plutoni agresiv e nga ana tjetër Afërdita "tekanjoze" bëjnë që ta keni të vështirë të ruani ekuilibrin, por për ju ka rëndësi të arriheni me çdo kusht synimet tuaja pa e vrarë shumë mendje për koston. Keni një anë pozitive që mësoni nga gabimet dhe nxirni mësimet e duhura. Forma e mirë psikofizike është garanci suksesi për ju.



BRICJAPI

Pritet një periudhë pozitive, duke filluar sidomos nga dhjetëditshi i dytë e më tutje dhe duke pasur mbështetje nga Plutoni që ju sjell forcë e vendosmëri. Edhe në rastet të ndonjë problemi apo përplasjeje me dikë, jeni aq karizmatikë sa të merrni përgjegjësitë pa iu dridhur syri, duke i bërë për vete edhe kundërshtarët më të vendosur. Kujdes, një ofertë joshëse duhet peshuar mirë, prandaj kërkoni ndihmën e ekspertëve tuaj të besuar para se të jepni një OK. Sa romantikë ju bën Hëna!



PESHQIT

Në përgjithësi shenja juaj do të jetë e dominuar nga yje të mirë dhe parashikimet për këtë periudhë do të jenë nga më të mirat për ju. Sikur të tregoheni më pak idealistë e një grimë më shumë pragmatistë, përfitimet tuaja në aspektin ekonomik do të jenë sigurisht më të mëdha. Nuk mjafton vetëm dëshira për të qenë i dobishëm por duhet të tregoheni të gatshëm kur kërkohet ndihma juaj. Merkuri ju destabilizon paksa, por është Afërdita që ju risjell harmoninë në planin sentimental.



GAFORRJA

Ndoshta për shkak të kontrasteve yjore apo edhe për arsye që lidhen me të shkuarën e afërme dhjetëditshi i parë i këtij muaji do të jetë disi i turbullt për ju. Megjithatë gradualisht do të kthelloheni dhe do t'i riktheheni performancës tuaj të zakonshme në planin profesional. Nuk është një periudhë shumë e favorshme në aspektin ekonomik, prandaj kujdes me shpenzimet. Mirë raportet ndërpersonale por kujdes sepse Hëna dhe Urani në shenjën bëjnë që të acaroheni për hijçgjë.



LUANI

Në përgjithësi ju që i përkisni kësaj shenje do të kaloni një periudhë relativisht të qetë në dhjetëditshin e parë, ndërsa kontrasti i Saturnit dhe Uranit në shenjën duket se do t'ju shkundë duke bërë që të dilni nga një gjendje thuajse apatie. Nga ana tjetër është Afërdita dhe Marsi që stimulojnë shumë aspektin luftarak që fshihet tek ju duke bërë që në një përplasje eventuale me dikë, të dilni fitimtarë. Financat tuaja janë në rregull, por kujdes se një investim i pastudiuar mund t'ju vërë në vështirësi.



VIJRGJËRESHA

Duket se largimi i ngadaltë i Jupiterit do t'ju lehtësojë disi, por megjithatë do t'ju duhet të vazhdoni të punoni me ngarkesë të plotë për të arritur pikësynimet tuaja. Ndoshta e kishit menduar se suksesin e kishit afër aq sa të shtrinit dorën, por në fakt do t'ju duhet të shpenzoni shumë energji e ndoshta edhe para por, në fund do t'ia dilni mbanë. Sidoqoftë impenjimet e shumta në planin profesional nuk duhet të bëjnë të harroni angazhimet e tjera. Dieta dhe ushtrimet fizike janë shëndet.

HOROSKOP BOMB

MAJ 2022



BINJAKËT

Ndonëse Merkuri, që zakonisht është planeti që ekzaltat aftësitë tuaja në planin profesional, është në një pozicion jo shumë të favorshëm për ju, do të jetë Afërdita te Dashi ylli juaj i mirë. Edhe pse idetë vazhdoni t'i keni disi të mjegulluara, vendosmëria juaj karakteristike për të bërë atë që ju thotë mendja do të japë rezultatet që prisni. Raporte të dendura në aspektin shoqëror por jeni disi të kontraktuar kur është fjala për një njohje apo një dashuri të re. Mirë shëndeti.



AKREPI

Do të jeni nën egjden e një Plutoni mjaft pozitiv, që ju bën tërheqës, magnetikë, por edhe hermetikë, duke bërë që kundërshtarët tuaj ta kenë plotësisht të pamundur të zbulojnë synimet tuaja, që është një avantazh për ju. Por nëse në planin profesional dhe ekonomik jeni të papërbalueshëm, në raportet ndërpersonale, falë një Marsi "ngatërrestar" në shenjën do të jeni disi zezekë, të pabindur e ndoshta edhe grindavecë. Kujdes me batutat, se gjuha kocka s'ka por kocka thyen.



UJORI

Do të jeni nën ndikimin e një Saturni "hijerëndë" që duket se jua rëndon lëvizjet, ju bën dyshues, të pavendosur, por që në fund të fundit të jetë një pikë referimi gjatë gjithë kësaj periudhe. Mbaje do të t'ju duket sikur jeni të vetmuar e madje edhe të izoluar, por është thjesht një përshtypje dhe sa më shpejt ta kuptoni aq më mirë do të jetë për ju. Financat tuaja janë mëse të qëndrueshme. Raportet me partnerit jo edhe aq, por do të mjaftojë një udhëtim i shkurtër me të që normaliteti të rikthehet.



SHIGJETARI

Do të jeni si gjithmonë entuziastë, optimistë e plot jetë e gjallëri, çka bën që edhe ndonjë pengesë të vogël që mund t'ju dalë ta kapërceni pa ndonjë impenjim të madh. Edhe kuadri yjor është përgjithësisht pozitiv për ju, sepse keni në anën tuaj Afërditën, e cila ju bën pasionalë dhe Jupiterin që është burim i entuziazmit tuaj. Në planin e ekonomik jeni në një pozicion komod, por a nuk ju duket se e teproni paksa me shpirtin tuaj të kursimit? Mirë jeta shoqërore dhe raportet me partnerin.

NEWS BOMB.al

ABONOHU
TANI!



REVISTA E PËRMUAJSHME
POLITIKO-KULTURORE

PËR TË BËRË ABONIMIN KONTAKTONI:

POSTA SHQIPTARE:

+355 68 50 80 753

Redaksia Newsbomb.al:

+355 69 67 32 020

abonime@newsbomb.al



newsbomb.al

199,816 FOLLOWERS



newsbomb.al

37.1 FOLLOWERS



NewsbombAl

2,909 FOLLOWERS